

Banka e Shqipërisë

# RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

6M1-2024

*\*MIRATUAR ME VENDIMIN 44, DATË 4.9.2024 TË  
KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË.*

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.


Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408


E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)



# P Ë R M B A J T J A

PARATHËNIE	7
SHËNIME	8
DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2024	10
1. POLITIKA MAKROPRUDENCIALE DHE RREZIQET SISTEMIKE	19
2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE	28
2.1 Harta e stabilitetit financiar	28
2.2 Mjedisi ekonomik i jashtëm	30
2.3 Mjedisi ekonomik në vend	34
3. LLOGARITË FINANCIARE DHE POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE	39
3.1 Pozicioni financiar i bizneseve	40
3.2 Përballeshmëria e borxhit dhe pritjet e bizneseve për të ardhmen	44
3.3 Pozicioni financiar i individëve	46
3.4 Përballeshmëria e borxhit dhe pritjet e individëve për të ardhmen	49
4. TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE	51
4.1 Tregjet e letrave me vlerë	51
4.2 Tregu ndërbankar i financimit	53
4.3 Tregu i këmbimit të monedhës	54
4.4 Tregu i pasurive të paluajtshme	55
4.5 Sistemet e pagesave	58
5. SISTEMI FINANCIAR	60
5.1 Sektori bankar	61
5.2 Sektori jobankar	91
ANEKS 1. TREGUESIT E SHËNDETIT FINANCIAR	96




## HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1.	Instrumentet dhe objektivat e politikës makroprudenciale	23
Hapësirë informuese 2.	Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit “Tregu i pasurive të paluajtshme” dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për 6M I-2024	57
Hapësirë informuese 3.	Ecuria e numrit të aplikimeve për kredi dhe analiza e normës së refuzimit nga bankat në vend për gjashtëmuorin e parë 2024	74

## PËRMBAJTJA E TABELAVE

1.	<i>Politika makroprudenciale dhe rreziqet sistemike</i>	
Tabelë 1.	Vlerat e shesave makroprudenciale të kapitalit që duhet të përmbushin bankat dhe afatet e përmbushjes	22
Tabelë 2.	Instrumentet dhe objektivat e politikës makroprudenciale	24
Tabelë 3.	Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare	33
2.	<i>Zhvillimet makroekonomike</i>	
Tabelë 4.	Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor	34
3.	<i>Llogaritë financiare dhe pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve</i>	
Tabelë 5.	Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali	45
5.	<i>Sistemi financiar</i>	
Tabelë 6.	Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së* në vite (në %)	60
Tabelë 7.	Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për qershor 2023-2024 (mld lekë)	69




## PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

<b>1.</b>	<b>Politika makroprudenciale dhe rreziqet sistematike</b>	
Grafik 1.	Hendeku i raportit "kredi për ekonominë/PBB"	20
Grafik 2.	Treguesi i paralajmërimit të hershëm plotësues	20
<b>2.</b>	<b>Zhvillimet makroekonomike</b>	
Grafik 3.	Harta e stabilitetit financiar	28
Grafik 4.	Ndryshimi vjetor në notën e rrezikut sipas sektorëve	29
Grafik 5.	Rritja vjetore e PBB-së	35
Grafik 6.	Norma e inflacionit	35
Grafik 7.	Balanca buxhetore ndaj PBB-së	35
Grafik 8.	Flukset e bilancit të pagesave dhe bilanci korrent	38
Grafik 9.	Pozicioni i investimeve ndërkombëtare sipas sektorëve	38
<b>3.</b>	<b>Llogaritë financiare dhe pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve</b>	
Grafik 10.	Pozicioni dhe financimi neto midis sektorëve	39
Grafik 11.	Pozicioni neto i bizneseve dhe individëve sipas kundërpartive	39
Grafik 12.	Mjetet (+), detyrimet (-) dhe pozicioni neto i bizneseve sipas instrumenteve	40
Grafik 13.	Mjetet (+), detyrimet (-) dhe pozicioni neto i bizneseve rezidente sipas sektorëve	41
Grafik 14.	Mjetet dhe detyrimet e bizneseve rezidente ndaj sektorit financiar	41
Grafik 15.	Rritja e kredisë së bizneseve sipas qëllimit (kontribut, p.p.)	42
Grafik 16.	Rritja e kredisë së bizneseve sipas sektorëve (kontribut, p.p.)	43
Grafik 17.	Normat e interesit për kredinë e re në Lek dhe në Euro, pa përfshirë kredinë kufi	44
Grafik 18.	Kushtet për miratimin e kredisë: (+) lehtësim; (-) shtrëngim	44
Grafik 19.	Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës	46
Grafik 20.	Mjetet dhe detyrimet e individëve rezidentë ndaj sektorit financiar	47
Grafik 21.	Kursimet e individëve rezidentë sipas instrumenteve	47
Grafik 22.	Rritja vjetore e kredisë për individët, kontribut në p.p.	48
Grafik 23.	Rritja vjetore e kredisë për konsum dhe për pasuri të paluajtshme (PP) për individët	48
Grafik 24.	Ecuria e kërkesës së individëve për kredi	49
Grafik 25.	Normat e interesit për kredinë e re për individë	49
Grafik 26.	Indekset e aftësisë paguese për 6 muajt e kaluar dhe 6 muajt e ardhshëm	50
Grafik 27.	Indeksi i planifikimit të huamarrjes dhe shpërndarja e familjeve që planifikojnë hua të re	50
<b>4.</b>	<b>Tregjet dhe sistemet e pagesave</b>	
Grafik 28.	Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)	51
Grafik 29.	Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar	52
Grafik 30.	Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar	52
Grafik 31.	Volumi i transaksioneve të kryera në tregun sekondar të LV të Qeverisë	53
Grafik 32.	Nivelet e yield-it fiks	53
Grafik 33.	Vëllimi i transaksioneve dhe normat e interesit në tregun ndërbankar	54
Grafik 34.	Kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutor	54
Grafik 35.	Indeksi Fischer i Çmimit të Banesave për Tiranën dhe për të gjithë territorin	56
Grafik 36.	Çmimi i transaksionit të shitjes në krahasim me çmimin e kërkuar	56
Grafik 37.	Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH në gjatëshmujorin e parë të viteve 2023-2024	58
Grafik 38.	Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë	59
Grafik 39.	Ecuria e pagesave për klientë në sistemin AIPS - EURO përgjatë viteve 2022-2024	59
<b>5.</b>	<b>Sistemi financiar</b>	
Grafik 40.	Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, qershor 2024	60
Grafik 41.	Ecuria e aktivitetit sipas përbërësve, kontribut në p.p	61
Grafik 42.	Struktura e bilancit të bankave në %	61
Grafik 43.	Struktura e aktiveve dhe detyrimeve në valutë, qershor 2024	62
Grafik 44.	Efekti i kursit të këmbimit në kundërvlerën në Lek të zërave kryesorë të aktivitetit dhe pasivit	62
Grafik 45.	Detyrimet ndaj jorezidentëve	63
Grafik 46.	Pozicioni neto me jorezidentët	63
Grafik 47.	Indeksi i shëndetit bankar	64
Grafik 48.	Harta e shëndetit bankar	64
Grafik 49.	Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit	65
Grafik 50.	Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit	65
Grafik 51.	Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit rregullator sipas elementeve përbërëse (në pikë përqindjeje)	66
Grafik 52.	Ecuria e levës financiare sipas përbërësve	66
Grafik 53.	Teprica e kapitalit për sektorin bankar	68



Grafik 54.	Struktura e shtesave rregullatore të kapitalit, qershor 2024	68
Grafik 55.	Përbërësit e rezultatit financiar	79
Grafik 56.	ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit	70
Grafik 57.	Tregues të përfitueshmërisë dhe marzhi neto i interesit	70
Grafik 58.	Rritja vjetore e kredisë sipas valutës	72
Grafik 59.	Ndryshimi në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse	72
Grafik 60.	Kredia e re për bizneset dhe individët sipas qëllimit të përdorimit	73
Grafik 61.	Ecuria e normave të interesit të kredisë së re	74
Grafik 62.	Ecuria e numrit të aplikimeve të marra në shqyrtim dhe norma e refuzimit të kredive	74
Grafik 63.	Norma e refuzimit të kredive - banka vendase dhe të huaja	75
Grafik 64.	Rritja vjetore e depozitave sipas afatit dhe monedhës, në monedhë origjinale	76
Grafik 65.	Rritja vjetore e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontribut, p.p.)	76
Grafik 66.	Ecuria e depozitave në Lek sipas afatit dhe sektorit (kontribut, p.p.)	77
Grafik 67.	Ecuria e depozitave në valutë sipas afatit dhe sektorit (kontribut, p.p.)	77
Grafik 68.	Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në Lek për individët	78
Grafik 69.	Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në Euro për individët	78
Grafik 70.	Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione dhe kolateral	80
Grafik 71.	Kontributi në ndryshimin tremujor të stokut të kredive me probleme	80
Grafik 72.	RKP-ja për kredinë sipas qëllimit të përdorimit	80
Grafik 73.	Treguesit e vlerësimit të rrezikut të kredisë	80
Grafik 74.	Diferenca në maturimin mesatar të mbetur midis aktive-pasive dhe kredi-depozita	82
Grafik 75.	Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve	82
Grafik 76.	Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin bankar dhe grupet	84
Grafik 77.	Ecuria e përbërësve të indeksit të mospërputhjes valutore për sektorin bankar	84
Grafik 78.	Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare	84
Grafik 79.	Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator	85
Grafik 80.	Pozicioni neto i peshuar sipas monedhave dhe afatit ndaj kapitalit rregullator, në %	86
Grafik 81.	Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave dhe spread-i i normave të interesit, në %	87
Grafik 82.	Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në p.p.	87
Grafik 83.	Projeksionet mbi treguesit kryesorë dhe treguesit e rinj makroekonomikë	88
Grafik 84.	Vlerat e RMK-së përgjatë harkut kohor ushtrimor	89
Grafik 85.	Kontributi në ndryshimin e RMK i zërave kryesorë të bilancit për skenarin e rënduar (fund 2026)	90
Grafik 86.	Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike	92
Grafik 87.	Struktura e sektorit jobankar	92
Grafik 88.	Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas subjekteve në vite	93
Grafik 89.	Shpërndarja e mjeteve, detyrimeve dhe pozicionit neto sipas subjekteve të sektorit jobankar (mars 2024)	93
Grafik 90.	Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas instrumenteve në vite	94
Grafik 91.	Ndërlidhja e sektorit jobankar me sektorin bankar, mars 2024	94




## PARATHËNIE

Raporti i Stabilitetit Financiar (më tej "raporti") publikohet dy herë në vit dhe ky është numri i 32-të i tij. Në hyrje të raportit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, e cila, sipas kërkesës së ligjit, duhet të publikohet çdo gjashtë muaj. Raporti paraqet një vlerësim të përgjithshëm të rreziqeve që mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të Republikës së Shqipërisë dhe infrastrukturën e tij, si dhe vlerëson aftësinë e sistemit financiar për t'i përthithur këto rreziqe. Dokumenti iu mundëson autoriteteve publike identifikimin në kohë të masave përkatëse për korrigjimet e nevojshme.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tregut financiar, si dhe janë shfrytëzuar analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Analiza në vijim mbulon kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe rreth 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë së veprimtarisë së tij dhe të rreziqeve që burojnë nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik të brendshëm dhe të jashtëm. Për të vlerësuar këto rreziqe, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonominë e vendeve të zhvilluara dhe ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Zhvillimet dhe rreziqet e lidhura me ekonominë vendase janë analizuar në bazë të treguesve të rritjes ekonomike, bilancit të pagesave, nivelit të përgjithshëm të çmimeve, kursit të këmbimit, si dhe treguesve fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve të veçanta, është vlerësuar gjendja financiare e sektorit të bizneseve/ndërmarrjeve dhe të individëve/familjeve, si edhe ndikimi i saj mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar. Rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të ndryshme makroekonomike është vlerësuar nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Raporti i Stabilitetit Financiar përgatitet nga Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.



## SHËNIME

Në fund të muajit qershor 2024, bankat në sektorin bankar shqiptar janë klasifikuar:

I. sipas kontributit marzhinal të secilit institucion në rrezikun sistemik në vend<sup>1</sup> duke u grupuar në:

- **Banka me rëndësi sistemike:** Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Credins sh.a., Banka Raiffeisen sh.a. dhe Banka OTP Albania sh.a. Këto banka zotërojnë rreth 64.8% të aktiveve të sektorit;
- **Banka të tjera:** Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka Tirana sh.a. Këto banka zotërojnë rreth 35.2% të aktiveve të sektorit.

II. sipas origjinës së kapitalit, duke u grupuar në:

- **Banka me kapital të huaj<sup>2</sup>:** Banka Raiffeisen sh.a. (Austri); Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. (Itali); Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi); Banka OTP Albania sh.a. (Hungari); Banka Procredit sh.a. (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari). Këto banka zotërojnë rreth 64% të aktiveve të sektorit,
- **Banka me kapital shqiptar:** Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Tirana sh.a dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. Këto banka zotërojnë rreth 36% të totalit të aktiveve të sektorit.

III. sipas shtrirjes gjeografike të rrjetit bankar. Shtrirje të rrjetit bankar jashtë vendit kanë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a. dhe Banka Credins sh.a., me filialet përkatëse në Kosovë.

Për analizën e kryer në raport, duhet të konsiderohet që:

- (1) Termat "hua" dhe "kredi" kanë të njëjtin kuptim dhe mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit; në të njëjtën mënyrë përdoren edhe termat "ndërmarrje"/"biznese" dhe "individë"/"familje";
- (2) Termi "teprica e kredisë" i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", siç është raportuar në bilancin e bankave në fund të periudhës që analizohet. Ajo përfshin tepricën e kredisë së dhënë nga

<sup>1</sup> Për më shumë informacion mbi indeksin dhe mbi përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike (BARS), lutem konsultoni dokumentin "Metodologji "Për përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike dhe shtesën përkatëse të kapitalit" të publikuar në: [https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Politika\\_makroprudenciale/Instrumentet\\_e\\_politikës\\_makroprudenciale/Akte\\_të\\_miratvara/](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikës_makroprudenciale/Akte_të_miratvara/)


<sup>2</sup> Një bankë klasifikohet si bankë me kapital të huaj, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.





sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Kjo tepricë ndikohet nga kreditë me probleme që janë larguar nga bilancet e bankave gjatë periudhës. Për këtë arsye, teprica e kredisë që analizohet në Raportin e Stabilitetit Financiar është një koncept i ndryshëm nga ai i “kredisë për ekonominë”, që trajtohet në Raportet e Politikës Monetare.

Në kredinë për ekonominë, krahas kredisë së dhënë nga bankat, përfshihet edhe kredia e dhënë nga institucionet financiare jobankare. Kredia për ekonominë përfshin vetëm kredinë për sektorin privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirja e kredive me probleme, duke qenë se këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën e tyre ekonomike; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt. Dallimi në këto koncepte të kredisë, duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të analizës përkatëse të treguesve të kredisë (normë rritjeje, raporte të cilësisë, shpërndarje sipas sektorëve, sipas monedhës etj.) në raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë.



## DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2024

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë (BSH) publikon këtë deklaratë periodike, që është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me ekonominë e jashtme dhe të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si dhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

*Banka e Shqipërisë vlerëson se në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 (më tej, "periudha"), veprimtaria e sistemit financiar vazhdoi ecurinë pozitive. Pavarësisht efektit pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit, në sektorin bankar depozitat u zgjeruan dhe ritmi i rritjes së kredisë u përshpejtua. Rreziqet e veprimtarisë u paraqitën në nivele të kontrolluara, por ecuria në rritje e ciklit financiar ka nevojë të moderohet. Në tërësi, rezistenca e veprimtarisë bankare ndaj rreziqeve ishte e mirë, në kushtet kur kapitalizimi i veprimtarisë mbeti i qëndrueshëm dhe fitimi vijoi të përmirësohej me ritme të kënaqshme.*

*Zhvillimet ekonomike gjatë periudhës ishin pozitive, ndikuar nga ecuria e mirë e konsumit dhe e investimeve, si edhe qëndrueshmëria e performancës së turizmit. Rritja ekonomike u shoqërua me rritje të punësimit e të pagave dhe ulje të normës së papunësisë. Gjendja financiare e familjeve dhe e bizneseve vlerësohet e përmirësuar gjatë periudhës. Politika fiskale ruajti prirjen konsoliduese në kushtet e rritjes së ndjeshme të të ardhurave fiskale. Presionet inflacioniste vijuan të bien dhe norma e inflacionit zbriti nën objektivin e Bankës së Shqipërisë, duke sjellë uljen prej saj të normës bazë të interesit. Rreziqet për zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend mbeten të pranishme. Ato burojnë kryesisht nga pasiguria që mbartin zhvillimet gjeopolitike, por mund të zhvillohen edhe në kushtet e një optimizmi që shoqërohet me veprime të pakujdesshme nga ana e agjentëve ekonomikë.*



*Ndaj, vlerësohet se të gjithë agjentët e ekonomisë kanë mundësinë ta shfrytëzojnë këtë periudhë të veprimtarisë për të konsoliduar bilancet e tyre financiare, për të përmirësuar kapacitetet administruese në përgjithësi dhe të rreziqeve në veçanti, si edhe për të rritur eficiencën e veprimtarisë.*

Më konkretisht, zhvillimet e periudhës treguan që:

**Aktiviteti ekonomik botëror vijoi të zgjerohej.** Zhvillimet përgjithësisht pozitive në tregun e punës, ecuria e mirë në sektorët e shërbimeve dhe lehtësimi i kushteve të financimit në tregje, ndihmuan rikuperimin e konsumit dhe të investimeve private. Presionet inflacioniste vijuan të bien, ndonëse me ritëm më të ngadaltë krahasuar me vitin e kaluar. Kushtet e financimit ishin përgjithësisht më të lehtësuara. Megjithatë, rënia e normave të interesit në tregjet e parasë dhe të kapitalit ka qenë më e ngadaltë nga pritjet, duke reflektuar qëndrueshmërinë e presioneve inflacioniste dhe shpejtësinë më të ulët të normalizimit të politikës monetare nga bankat qendrore kryesore. Në Eurozonë, ekonomia shfaq shenja modeste, por të qëndrueshme rimëkëmbjeje gjatë dy tremujorëve të parë të vitit, mbështetur kryesisht nga tregtia dhe sektorët e shërbimeve. Banka Qendrore Evropiane nisi lehtësimin monetar përmes uljes së normës bazë të interesit në muajin qershor. Zhvillimet në tregjet financiare evropiane u karakterizuan nga luhatshmëria, ndërsa dinamikat e kreditimit të bankave ishin përgjithësisht të dobëta. Në tremujorin e parë të vitit 2024, ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor u rritën me norma të kënaqshme dhe më të larta krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Presionet inflacioniste u dobësuan. Kjo ecuri solli përmirësim të balanceve fiskale dhe ulje të borxhit publik, por, në sektorin e jashtëm, llogaria korrente u përkeqësua në shumicën e vendeve, duke zhbërë pjesërisht përmirësimin e shënuar në gjysmën e dytë të vitit 2023. Cilësia e kredisë në rajon mbeti e qëndrueshme dhe raportet e kredive me probleme ishin në nivele relativisht të ulëta. Rreziqet për rajonin janë ato që shoqërojnë ekonominë evropiane dhe botërore. Ekonomia botërore pritet të vijojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme e të ngadaltë gjatë periudhës 2024-2025, dhe rritja do të kryesohet nga vendet në zhvillim. Rreziqet ndaj perspektivës së ekonomisë botërore vlerësohen përgjithësisht të balancuara. Megjithatë, niveli i pasigurisë mbetet i lartë, i ndikuar nga shpejtësia e rënies së inflacionit dhe përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike, që mund të nxisin goditje të reja ndaj zinxhirëve të prodhimit. Këtyre faktorëve më afatshkurtër u shtohet efekti i ndryshimeve strukturore me ndikim të sigurt, por jo krejtësisht të qartë, ku përfshihen ndryshimet e klimës dhe të teknologjisë.

**Ekonomia shqiptare vijoi rritjen gjatë periudhës dhe, në fund të tremujorit të parë, rritja ekonomike vjetore shënoi 3.6%.** Kjo rritje ekonomike pati një bazë të gjerë sipas sektorëve, veçanërisht nga ndërtimi, tregtia e transporti, dhe u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme. Në kahun e kërkesës, aktiviteti ekonomik u mbështet nga konsumi final dhe investimet e sektorit privat, ndërsa thellimi i deficitit tregtar ndikoi në kahun rënës të rritjes ekonomike. Tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive si rritja e punësimit, rënia e numrit të të papunëve të regjistruar, si dhe rritja e pagave në sektorin shtetëror



dhe atë privat. Norma e inflacionit shfaq një rënie të shpejtë gjatë periudhës. Kjo ecuri ka reflektuar efektin e normalizimit të politikës monetare, mbiçmimin e monedhës vendase dhe rënien e inflacionit të importuar. Në vijim, në fillim të muajit korrik, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 25 pikë bazë, në nivelin 3%. Gjatë periudhës, politika fiskale ishte konsoliduese. Objektivat për balancën buxhetore tejkaluan planifikimin në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), treguesit e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik shfaqën rënie të ndjeshme. Në krahasim me një vit më parë, deficitin i llogarisë korrente u zgjerua ndjeshëm gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, si rezultat i thellimit të deficitit tregtar në mallra. Kontribut pozitiv dha rritja e flukseve neto të valutës nga shërbimet e udhëtimit dhe nga dërgesat e emigrantëve. Nga ana tjetër, investimet e huaja direkte kanë vijuar të rriten. Stoku i pozicionit debitor të vendit ndaj jorezidentëve u zgjerua gjatë tremujorit të parë të vitit, për shkak të rritjes së detyrimeve neto të sektorit privat në formën e investimeve të huaja direkte dhe atyre të portofolit.

*Gjatë periudhës, nuk pati ndryshime të ndjeshme në pozicionin strukturor financiar të bizneseve dhe të familjeve.* Sipas të dhënave të llogarive financiare, **pozicioni i bizneseve** mbetet debitor dhe ai është thelluar. Sipas instrumenteve, ky zhvillim lidhet me rritjen e mëtejshme të detyrimeve në formën e investimeve të huaja direkte. Në terma të kundërpalëve, bizneset kanë pakësuar detyrimet neto ndaj korporatave financiare, për shkak të rritjes më të shpejtë të depozitave sesa të kredive që ato kanë në banka, dhe kanë zgjeruar detyrimet neto ndaj jorezidentëve. Kredia bankare për bizneset është rritur me ritëm të përshpejtuar gjatë periudhës, dhe rritja është raportuar si në kredinë në Lek, ashtu edhe në atë në valutë. Kjo rritje ishte më e ndjeshme nëse korrigjohet për efektin pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja për bizneset të akorduara në Lek dhe në valutë u rrit në krahasim me gjashtëmuajorin e kaluar. Pavarësisht rritjes së normës së interesit, kërkesa e bizneseve për kredi ishte më e fortë, ndërkohë që bankat kanë lehtësuar kushtet dhe termat e përgjithshme të kredisë. Sipas vrojimit të Bankës së Shqipërisë, shumica e bizneseve raportuan fitime gjatë periudhës. Ecuria e shitjeve dhe e rezultatit financiar u vlerësua pozitive, ndonëse në nivele më të ulëta krahasuar me gjashtëmuajorin paraardhës. Pritjet mbetën optimiste, me gjithë problematikat që ekzistojnë veçanërisht lidhur me rritjen e kostove të financimit dhe kostove të prodhimit e të punës. Pësia e bizneseve huamarrëse shënoi rritje gjatë periudhës. Ngarkesa me borxh, në formën e raportit të huasë ndaj kapitalit, dhe në formën e shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave të ndërmarrjes, u vlerësua në rritje për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, krahasuar me gjashtëmuajorin e mëparshëm. Bizneset presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet e qëndrueshme dhe në rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024. **Sektori i individëve** përfaqëson sektorin rezident më të rëndësishëm në financimin e korporatave financiare dhe bizneseve, dhe forma kryesore e financimit është ajo e kapitalit të investuar në ndërmarrjet vendase dhe e depozitave të vendosura në banka. Pozicioni kreditor i individëve rezidentë ndaj sektorit bankar u zgjerua lehtë gjatë periudhës, për shkak të rritjes më të madhe të depozitave në krahasim me kreditë. Në terma relativë, rritja e



kredisë, si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë, ishte më e madhe sesa rritja e depozitave. Kërkesa për kredi u mbështet nga nevoja për konsum dhe për blerje pasurish të paluajtshme, kryesisht në monedhën vendase. Normat e interesit të kredisë së re për individët mbetën pothuajse të pandryshuara gjatë periudhës. Bankat lehtësuan kushtet e përgjithshme të kredisë për individët, por sinjalizuan një shtrëngim të standardeve të kredidhënies. Ato presin që kërkesa nga individët për kredi të mbetet e qëndrueshme, ndonëse sipas vërtetimit të kryer nga Banka e Shqipërisë me familjet, këto të fundit shprehen për një kërkesë më të dobët në vijim. Rezultatet e këtij vërtetimi gjithashtu tregojnë se pësha e familjeve huamarrëse ka mbetur e qëndrueshme, ndërsa aftësia e tyre paguese sinjalizoi rënie gjatë periudhës, duke mbetur gjithsesi më e mirë se një vit më parë. Pritjet për aftësinë paguese në gjashtëmujorin e ardhshëm paraqiten më optimiste.

**Në tregjet financiare, zhvillimet ishin të qëndrueshme. Në tregun parësor të titujve** të borxhit të qeverisë, vëllimi i emetimeve ishte i krahasueshëm me vëllimin e të njëjtës periudhë një vit më parë, por gati 50% më i lartë se gjashtëmujori i mëparshëm. Në volumin e emetimeve të periudhës, emetimet afatshkurtra u dyfishuan dhe ato zunë rreth 60% të borxhit total. Gjatë periudhës, norma mesatare e ponderuar e interesit për të gjitha maturitetet e titujve të emetuar në Lek u rrit lehtë me 0.1 pikë përqindjeje (p.p.), duke arritur në nivelin 4.2%. Për titujt afatshkurtër, norma mesatare e interesit u rrit me 0.3 p.p. në nivelin 3.5%, ndërsa për titujt afatgjatë ajo ra me 0.1 p.p., në 5.1%. Oferta e investitorëve ka qenë e lartë dhe në shumicën e rasteve i mbuloi nevojat e qeverisë për huamarrje. **Tregu dytësor** i titujve të borxhit vijon të karakterizohet nga një numër dhe vëllim i ulët i transaksioneve. **Në tregun ndërbankar**, vëllimi i transaksioneve të financimit shënoi rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së vëllimit të transaksioneve njëjavore. Interesat e aplikuar nga bankat në tregun e parasë qëndruan pranë normës bazë të interesit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Në vijim të flukseve të bollshme hyrëse të valutës, **kursi i këmbimit të Lekut** vijoi të mbiçmohet ndaj valutave kryesore gjatë periudhës, por shpejtësia e mbiçmimit u ngadalësua, edhe për shkak të blerjeve të valutës nga ana e Bankës së Shqipërisë.

**Kërkesa e qëndrueshme mbështeti rritjen e çmimeve në tregun e pasurive të paluajtshme.** Nga vërtetimi i posaçëm i Bankës së Shqipërisë u konstatua që në tregun e pasurive të paluajtshme rezidenciale kërkesa e përgjithshme, duke përfshirë edhe atë nga jorzidentët, mbeti e qëndrueshme. Rritja e kredisë bankare për blerje pasurish të paluajtshme ka mbështetur qëndrueshmërinë e kërkesës. Bankat kanë shtrënguar disi standardet për këtë lloj kredie dhënë individëve. Numri i pronave të pashitura ka rënë. Në kahun e ofertës, numri dhe sipërfaqet e lejeve të ndërtimit u shfaqën në rënie në krahasim me një vit më parë, por janë pranë vlerës mesatare të viteve të fundit. Kredia bankare për ndërtim nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Kostot e ndërtimit janë rritur, kryesisht për shkak të rritjes në shpenzimet për paga dhe energji. Në vijim të këtyre zhvillimeve, vërtetimi tregoi se Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi u rrit me 16.9% në terma gjashtëmujorë dhe me 8% ndaj një viti



më parë. Rritja e vlerës së indeksit për Tiranën ishte edhe më e fortë. Çmimet e qirasë u rritën gjithashtu. Sipas raportimeve të agjentëve për transaksionet e kryera, pesha e transaksioneve me çmim shitjeje të njëjtë me atë të kërkuar nga shitësi ka rënë, ndërkohë që vihet re rritje e peshës së transaksioneve për të cilat çmimi i shitjes ishte më i ulët sesa çmimi i kërkuar nga shitësi. Agjentët ruajnë një vlerësim pozitiv në lidhje me ecurinë e tregut të banesave në periudhën afatshkurtër, dhe mbeten optimistë për ecurinë e tij në një periudhë më të gjatë.

**Infrastruktura e pagesave funksionoi normalisht dhe përballoi pa probleme rritjen e volumeve të transaksioneve.** Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhën vendase dhe në Euro, ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet. Gjatë periudhës është regjistruar rritje e vlerës dhe numrit të transaksioneve në sistemet e pagesave. Me rritje të fortë u shfaqën edhe pagesat me karta (të debitit dhe të kreditit), si edhe transfertat e kreditit në formën joleter. Aktualisht, pagesat me karta zënë peshën kryesore në numrin e përgjithshëm të pagesave të kryera.

**Zhvillimet në sistemin financiar dhe në sektorin bankar ishin pozitive.** Gjatë periudhës, pesha e aktiveve të sistemit financiar<sup>3</sup> ndaj PBB-së shënoi një rritje të lehtë me 0.2 p.p., në nivelin 94.2%. Në terma vjetorë, ky tregues u rrit me 2 p.p. pasi norma vjetore e rritjes së bilancit të sistemit financiar ishte më e lartë në krahasim me atë të rritjes së PBB-së. Në këtë rritje, sektori bankar ka kontribuar me pothuaj 1.5 p.p. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të mbizotërojë me gati 90% të totalit të aktiveve. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, ndonëse ka shënuar një rritje të lehtë për periudhën. Ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë, por nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht treguesit e ndërlidhjes në kuadër të vlerësimit periodik të rreziqeve sistemike.

**Bilanci i sektorit bankar** u zgjerua gjatë periudhës, dhe në terma vjetorë rritja ishte 7%. Në zgjerimin e aktivitetit të sektorit bankar kontribuuan së bashku, investimet në kredi, ato në tituj dhe veprimet ndërbankare. Efekti statistikor i mbiçmimit të kursit të këmbimit mbeti negativ për rreth 30 miliardë lekë, duke ndikuar në zvogëlimin e vlerës së bilancit të raportuar në Lek, por ky efekt erdhi në rënie gjatë vitit të fundit. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit ka rënë lehtë në përkatësisht 50% dhe 49%, ndërsa pozicioni neto kreditor ndaj jorezidentëve u zgjerua, duke arritur në 19% të aktiveve të bankave. Financimi i veprimtarisë së bankave vijoi të mbështetet në depozitat me pakicë dhe fondet e veta. Gjatë periudhës, indeksi i shëndetit bankar konfirmoi një gjendje të mirë dhe të qëndrueshme financiare të sektorit.

**Kredia bankare** shënoi rritje të ndjeshme gjatë periudhës. Në terma vjetorë, kredia u zgjerua me 11.1%, ndërsa në krahasim me fundin e vitit 2023, ajo u

<sup>3</sup> Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar. Baza e të dhënave për të gjitha subjektet e sistemit financiar dhe PBB-ja i përkasin tremujorit të parë të vitit 2024, me përjashtim të bankave, bilanci i të cilave i referohet tremujorit të dytë të vitit 2024.



rrit me 7.1%. Në këtë ecuri ndikoi kryesisht rritja e fortë e kredisë në Lek, rritja e kredisë afatgjatë dhe rritja e kredisë për bizneset. Edhe kredia për jorezidentët u rrit gjatë periudhës, por mbeti pranë niveleve të një viti më parë. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e kredisë do të ishte rreth 14%. Ristrukturimi i kredive dhe largimi nga bilanci i kredive të humbura vijuan gjatë periudhës. Vëllimet e ristrukturimeve u pakësuan, ndërsa ato të fshirjeve ishin të krahasueshme me periudhën e kaluar. Teprica e kredisë së pambrojtur në valutë vijoi rënien si në terma gjashtëmuorë, ashtu edhe në krahasim me një vit më parë. Rënia vërehet në vlerë absolute dhe relative, por e korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, kjo kredi do të shënonte rritje gjatë periudhës. Kontributin kryesor në këtë ecuri e dha rënia në kredinë e pambrojtur në valutë për individët, pasi kredia e pambrojtur në valutë për bizneset nuk ndryshoi. Cilësia e kësaj kredie mbetet mjaft e mirë.

**Kredia e re** e dhënë gjatë periudhës u rrit lehtë në krahasim me gjashtëmuorin e mëparshëm. Në këtë rritje kontributin e vetëm pozitiv e dha kredia për individët. Kjo kredi shkoi kryesisht për blerjen e pasurive të paluajtshme. Rritja e kredisë së re gjatë periudhës ishte ndjeshëm më e lartë se ajo e një viti më parë. Në këtë ndryshim, kontributin kryesor e dha rritja e kredisë së re në Lek, ndërkohë që rritja e kredisë së re në Euro e shprehur në Lek ishte më e vogël edhe për shkak të efektit statistikor të kursit të këmbimit. Norma e peshuar e interesit për të gjitha kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës mbeti pothuajse e pandryshuar, në nivelin 6.8%. Normat e interesit për kreditë e reja në Lek shfaqen disi më të larta se ato në Euro, ndërkohë që të dyja kanë treguar shumë pak luhatje në periudhat e fundit.

Në fund të periudhës, **depozitat** e mbajtura në sektorin bankar arritën vlerën 1,610 milionë lekë. Këto depozita u rritën gjatë periudhës me 0.4%, duke reflektuar kryesisht zgjerimin e depozitave me afat, të depozitave të individëve dhe atyre në Lek. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat ranë lehtë. Në terma vjetorë, depozitat në Lek dhe në valutë u zgjeruan me përkatësisht 8% dhe 6%, ndërsa depozitat e përgjithshme u rritën me 7%. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë do të ishte rreth 12%. Rritja vjetore e depozitave në Lek u mbështet nga zgjerimi i llogarive rrjedhëse dhe i depozitave me afat të individëve, ndërsa rritja vjetore e depozitave në valutë pasqyron edhe rritjen e depozitave me afat të bizneseve. Normat e interesit të depozitave të reja vijuan të rriten, ndërsa flukset e depozitave të reja ishin më të ulëta se ato të gjashtëmuorit të mëparshëm, por të krahasueshme me ato të së njëjtës periudhë të një viti më parë.

**Në tërësi, vlerësohet që ekonomia shqiptare dhe sistemi financiar treguan zhvillime pozitive gjatë periudhës, pavarësisht sfidave.** Rritja ekonomike mbeti e qëndrueshme pavarësisht ngadalësimit të rritjes së të ardhurave nga turizmi. Në tregun e punës ka vijuar rritja e pagave dhe e punësimit, dhe norma e papunësisë ka shënuar rënie të lehtë. Performanca fiskale evidentoi prirjen e fortë konsoliduese dhe njëkohësisht nevojën për përmirësim të shkallës së realizimit të investimeve publike. Norma e inflacionit vijoi rënien, ndërkohë që



mbiçmimi i kursit të këmbimit ndihmoi në balancimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Gjendja financiare e sektorit bankar dhe e sistemit financiar u paraqit e mirë dhe fitimi u rrit, ndonëse me ritme më të ngadalësuar. Këto zhvillime pozitive ekonomike dhe financiare konfirmohen edhe nga treguesit e Hartës së Stabilitetit, e cila reflekton rreziqe më të ulëta dhe relativisht të kontrolluara pothuaj për të gjithë aktorët e ekonomisë. Nga ana tjetër, zhvillimet ekonomike ndërkombëtare kanë qenë pozitive, por pasiguria e lartë që buron prej tensioneve gjeopolitike i mban ato të ndrydhura. Në vrojtimin periodik që kryhet me bankat, ky faktor është evidentuar prej tyre si burimi kryesor i rrezikut, i ndjekur prej ndjeshmërisë nga sulmet potenciale kibernetike.

Në terma të rreziqeve më specifike për veprimtarinë e sektorit bankar vlerësohet se:

***Përshpejtimi i kreditimit është shoqëruar me një rritje të lehtë të stokut të kredive me probleme, ndonëse raporti i kredive me probleme (RKP) ka mbetur në nivele të ulëta.*** Stoku i kredive me probleme u rrit gjatë periudhës me rreth 6%, duke u ngjitur në nivelin 37 miliardë lekë. Kjo rritje u vu re kryesisht në portofolin e kredisë në monedhën vendase, në kredinë afatshkurtër dhe në kredinë për bizneset. Në krahasim me një vit më parë, vlera e stokut të kredive me probleme nuk ka ndryshuar. Nga ana tjetër, për shkak të rritjes më të shpejtë të tepricës totale të kredisë, RKP-ja zbriti në 4.7% në fund të periudhës, duke shënuar një përmirësim të lehtë të cilësisë së kredisë. Ulje të RKP-së kanë shënuar edhe kredia për investime në pasuri të paluajtshme, kredia për konsum dhe kredia e pambrojtur nga kursi i këmbimit. Në fund të periudhës, portofolet e kredisë me vlerën më të lartë të RKP-së ishin kredia afatmesme (6.5%), ajo për biznese (5.9%), kredia për tregti (5.4%) dhe kredia në Lek (5.3%). Në krahasim me një vit më parë, cilësia e kredisë shënon përmirësim më të dukshëm dhe RKP-ja ka rënë me 0.5 p.p. Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta. Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme zbriti gjatë periudhës me 0.4 p.p., në nivelin 67%. Kundrejt një viti më parë, ky tregues është rritur me 0.3 p.p.

***Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivele të mira.*** Në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, bankat kanë një vëllim disi më të ulët të aktiveve likuide në raport me aktivet e përgjithshme dhe detyrimet afatshkurtra, por këta tregues vijojnë të qëndrojnë dukshëm mbi kufijtë minimalë rregullatorë. Gjatë periudhës, bankat kanë raportuar zgjerim të hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet deri në 3 muaj. Diferenca midis afatit mesatar të maturimit të aktiveve dhe të detyrimeve është rritur lehtë. Prej disa gjashtëmuajorësh, sektori bankar nuk ka raportuar linja financimi nga grupet bankare zotëruese.

***Rreziqet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të tregut kanë qenë të kontrolluara.*** Gjatë periudhës, pozicioni i hapur valutor neto i sektorit bankar që sinjalizon ekspozimin ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit, rezultoi “në blerje”, në nivelin 4.6% e kapitalit rregullator. Kjo ishte vlera më e ulët e treguesit





gjatë vitit të fundit dhe ajo është dukshëm nën kufirin maksimal rregullator prej 30%. Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur nga treguesi i mospërputhjes valutore, ka regjistruar një rritje të lehtë gjatë periudhës si rezultat i zgjerimit të kredisë për rezidentët në valutë, por mbetet pranë nivelit të minimumit historik. Treguesi që mat ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të normës së interesit ka shënuar rritje gjatë periudhës, megjithatë mbetet ndjeshëm nën kufirin e sipërm rregullator. Sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit për pozicionet në Lek, ato me normë interesi të ndryshueshme dhe për maturitetin afatgjatë. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit mbetet i kufizuar.

***Megjithë rreziqet e pranishme, rezistenca e sektorit bankar ndaj tyre, në terma të kapitalizimit dhe përfitueshmërisë së veprimtarisë vlerësohet e mirë.*** Më konkretisht, në fund të periudhës, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar rezultoi 19.3%. Gjatë periudhës, ky tregues shënoi rënie, kryesisht për shkak të rritjes së shpejtë të aktiveve të ponderuara me rrezik, por në krahasim me një vit më parë, ky tregues u rrit me 0.3 p.p. Aktualisht, bankave iu kërkohet të përmbushin disa kërkesa për nivelet e kapitalit, ku përfshihen shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe ato për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar (MREL). Me qëllim forcimin e pozitave të kapitalit, gjatë periudhës bankat kanë injektuar kapital, kanë rritur fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur. Sektori bankar në tërësi arriti t'i përmbushte kërkesat rregullatore për kapital të periudhës sipas kalendarit të përcaktuar dhe të regjistronte një tepricë kapitali pozitive. Fitimi i sektorit bankar në fund të qershorit ishte pozitiv për 18.6 miliardë lekë. Ky rezultat ishte rreth 26% më i lartë në krahasim me një vit më parë, por norma e rritjes së fitimit është më e ulët se ajo e vitit 2023. Në këtë ecuri, ndikimin kryesor pozitiv e dhanë të ardhurat neto nga interesat. Rritje kanë shënuar edhe të ardhurat jo nga interesat, që kanë reflektuar një ecuri më të mirë të investimeve në instrumentet financiare dhe të ardhura më të larta nga komisionet. Paralelisht me rritjen e të ardhurave, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve paraqet rritje të shpenzimeve të veprimtarisë dhe rritje të lehtë të shpenzimeve për provigjione. Përmirësimi i rezultatit financiar është reflektuar në një shpërndarje më të mirë të vlerave të Kthimit nga Aktivitet (RoA) midis bankave.

***Rezistencën e mirë të sektorit bankar ndaj rreziqeve e evidentojnë edhe ushtrimet e provës së rezistencës.*** Rezultatet e ushtrimit për vlerësimin e aftësisë paguese të sektorit bankar ndaj skenarëve të supozuar për periudhën 2024-2026, tregojnë se ai paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike të supozuara. Ndjeshmëria e sektorit bankar është përmirësuar në krahasim me një vit më parë, pasi numri i bankave që do të kishin nevojë për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit dhe vlera e nevojshme e kapitalit, në skenarët më pak të favorshëm kanë rënë.

***Pavarësisht zhvillimeve përgjithësisht pozitive, vëmendja mbikëqyrëse do të jetë maksimale për të siguruar që performanca e sektorit bankar të mbetet***



**pozitive dhe e qëndrueshme.** Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë analizon rregullisht efektet e të gjitha politikave të saj, dhe kombinon posaçërisht proceset e mbikëqyrjes mikroprudenciale, të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të mbikëqyrjes makroprudenciale. Kjo e fundit përfshin një sërë rregullash, analizash dhe instrumentesh përmes të cilave Banka e Shqipërisë identifikon, monitoron dhe trajton rreziqet me natyrë sistemike. Analizat në kuadër të zbatimit të politikës makroprudenciale kanë evidentuar gjendjen e mirë financiare të sektorit bankar, ekspozimin e tij përgjithësisht të kontrolluar ndaj rreziqeve sistemike, por edhe nevojën për të marrë masa parandaluese. Këto masa lidhen kryesisht me nevojën për të moderuar shpejtësinë e ciklit financiar (të rritjes së kreditimit) dhe për të rritur rezistencën e bankave ndaj ekspozimeve me rrezik.

Me këtë qëllim, në fund të muajit qershor, Banka e Shqipërisë shpalli rritjen e normës kundërciklike të kapitalit (KUNC) me 25 pikë bazë, në nivelin 0.25%. Bankave iu komunikua mundësia e rritjeve të tjera në nivelin e këtij instrumenti, nëse kredia e përgjithshme ose ajo në segmente të veçanta të saj, vijon të rritet me ritme të shpejta. Një prej segmenteve të kredisë me rritjen më të shpejtë gjatë viteve të fundit është kredia për blerjen e pasurive të paluajtshme. Për shkak të kërkesave të sektorit bankar për mbulimin e kësaj lloji kredie me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme, kjo lloji kredie dhe kolaterali mbështesin në mënyrë të ndërsjellë kahun e ndryshimit të vlerave të njëritjetrit, duke përforcuar ekspozimin e sektorit bankar ndaj zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme. Për këto arsye, kjo kategori kredie ka nevojë të vlerësohet në mënyrë të kujdesshme për të parandaluar apo trajtuar zhvillime që rezultojnë të paqëndrueshme. Me këtë qëllim, në zbatim të rregullores së posaçme të miratuar në tetor të vitit 2023, janë mbledhur dhe po analizohen raportimet e para të bankave për standardet që ato kanë zbatuar në këtë lloji kredie. Pas një procesi të nevojshëm të sigurimit të cilësisë dhe të konsistencës, treguesit që po mblidhen nga bankat do të mbështesin zbatimin e instrumenteve makroprudenciale për të kontrolluar rrezikun që buron nga këto ekspozime.



## 1. POLITIKA MAKROPRUDENCIALE DHE RREZIQET SISTEMIKE

Për të mbrojtur stabilitetin financiar, rëndësi parësore ka identifikimi dhe administrimi i rreziqeve sistemike në veprimtarinë e sistemit financiar. Për shkak të rolit të saj si autoritet monetar dhe autoritet mbikëqyrës i sektorit bankar, i cili mbizotëron në sistemin financiar, Banka e Shqipërisë jep një kontribut parësor në trajtimin e rreziqeve sistemike, nëpërmjet kombinimit të politikave të saj dhe posaçërisht nëpërmjet zbatimit të politikës makroprudenciale. Kjo e fundit përfshin një sërë rregullash, analizash dhe instrumentesh përmes të cilave Banka e Shqipërisë identifikon, monitoron dhe trajton rreziqet me natyrë sistemike. Rreziqet sistemike analizohen çdo gjashtë muaj nëpërmjet monitorimit të treguesve të hartës makroprudenciale. Këta tregues organizohen në grupe sipas katër objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale, në mënyrë që të kontrollohen zhvillimet në drejtim të kreditimit të shpejtë, stresit të likuiditetit, rrezikut sistematik që buron nga përqendrimet dhe ndërlidhjet, si edhe atij që buron nga madhësia apo kompleksiteti i institucioneve financiare (bankave).

***Gjatë periudhës, treguesit e hartës makroprudenciale kanë evidentuar gjendjen e mirë financiare të sektorit bankar, ekspozimin e tij përgjithësisht të kontrolluar ndaj rreziqeve sistemike, por edhe nevojën për të marrë masa parandaluese.*** Për shembull, treguesit që monitorohen në kuadër të objektivit të dytë (rrezikut të likuiditetit) tregojnë që hendeku afatshkurtër midis aktiveve dhe pasiveve të bankave në raport me aktivet e përgjithshme mbetet i lartë, por gjatë dy viteve të fundit, vërehet një ulje e vlerës mesatare të këtij hendeku. Në të njëjtën kohë, raporti aktive/likuide/pasive afatshkurtra mbetet i lartë dhe dukshëm mbi kufirin minimal të lejuar nga kuadri rregullator<sup>4</sup>. Gjithashtu, treguesit që monitorohen në kuadër të objektivit të tretë (rrezikut të përqendrimeve dhe të ndërlidhjes), konfirmojnë që nivelet e ndërlidhjes në veprimtarinë bankare kanë mbetur të qëndrueshme dhe relativisht të ulëta. Nivelet e përdorimit dhe të përqendrimit të valutës në veprimtarinë e sektorit bankar mbeten të konsiderueshme, ndonëse vlerat e kredisë në valutë të pambrojtur nga kursi i këmbimit kanë vijuar të bien në mënyrë graduale. Këto zhvillime janë detajuar dhe janë konfirmuar edhe në analizën që publikohet çdo gjashtë muaj “Mbi ecurinë e treguesve që monitoron Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të uljes së euroizimit”<sup>5</sup>. Për fundin e vitit 2023 (analiza e publikuar në shkurt 2024) dhe për fundin e gjashtëmuajorit të parë 2024 (analiza e publikuar në

<sup>4</sup> Shiko “Hapësirë informuese nr. 1”


<sup>5</sup> Ky raport publikohet në zbatim të Memorandimit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, nënshkruar më 18.4.2017 dhe publikuar këtu: [https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi\\_gksf\\_9384\\_1.pdf](https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf)




gusht 2024), arrihet në konkluzionin që ecuria e treguesve vlerësohet të ketë qenë në kahun e duhur, ndonëse ndryshimet e regjistruara janë të diferencuara mes treguesve. Kjo ecuri nxjerr në pah larminë e faktorëve ekonomikë e socialë që ndikojnë ecurinë e treguesve të niveleve të euroizimit të ekonomisë dhe sistemit financiar, si edhe evidenton nevojën për të ruajtur një fokus afatgjatë dhe për të bashkërenduar masat për uljen e euroizimit në sistemin financiar dhe në ekonominë reale.

Nga ana tjetër, treguesit e objektivit të parë që monitoron ecurinë e ciklit financiar, kanë evidentuar përshejtimin e rritjes së kredisë në tërësi, dhe në mënyrë të veçantë të segmenteve të caktuara të saj siç janë ai për blerjen e pasurive të paluajtshme dhe ai i kredisë për konsum. Nga njëra anë, periudha të tilla shoqërohen me performancë të mirë financiare të agjentëve të ekonomisë reale dhe të institucioneve financiare, dhe Shqipëria ka nevojë të rrisë nivelet e ndërmjetësimit financiar, për të ardhur më pranë treguesve mesatarë të rajonit dhe më tej, të Bashkimit Evropian, ndërsa nga ana tjetër, këto periudha mund të sjellin edhe fillimin e rreziqeve të lidhura me rënien e standardeve të kreditimit, rritjen e përqendrimit të kredisë në sektorë ose tregje të caktuara, rritjen e niveleve të borxhit të bizneseve dhe individëve përtej niveleve të shëndetshme, rritjen e stokut të kredive me probleme etj. Nëse nuk kontrollohen, këto situata mund ta bëjnë ekonominë dhe sistemin financiar më të ndjeshëm ndaj goditjeve të ndryshme, duke cenuar stabilitetin financiar të vendit. Për këto arsye, nevojitet përdorimi i instrumenteve makroprudenciale që veprojnë në mënyrë kundërciklike, parandalojnë përhapjen e pakontrolluar të këtyre rreziqeve dhe rrisin rezistencën e bankave ndaj mundësisë së materializimit të tyre.

Grafik 1. Hendeku i raportit kredi për ekonominë/PBB



Grafik 2. Treguesi i paralajmërimit të hershëm plotësues



*Për këto arsye, në fund të muajit qershor, Banka e Shqipërisë shpalli rritjen e normës kundërciklike të kapitalit (KUNC) me 25 pikë bazë, në nivelin 0.25%<sup>6</sup>. Kjo vendimmarrje u mbështet në tregues të posaçëm, si ai i hendekut të raportit të kredisë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ose treguesi parësor, dhe ai i paralajmërimit të hershëm plotësues. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se përdorimi i këtyre treguesve që plotësojnë njëri-tjetrin, është i nevojshëm për të kapur dhe reaguar më shpejt ndaj zhvillimeve të shpejta në ciklin financiar. Në analizën e publikuar që shoqëronte vendimin e mësipërm, Banka e Shqipërisë theksoi mundësinë e rritjeve të tjera të KUNC-it nëse ritmet e rritjes së kredisë së përgjithshme dhe të segmenteve të caktuara të saj do të mbeten të larta.*

*Krahas monitorimit më të afërt të ciklit financiar, ka vijuar puna për vlerësimin e ekspozimit të sektorit bankar ndaj tregut të pasurive të paluajtshme. Gjatë periudhës, të gjitha bankat që operojnë në vend raportuan për herë të parë, në mënyrë të standardizuar, mbi të dhënat e kërkuara nga rregullorja nr. 44/2023 "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për pasuri të paluajtshme"<sup>7</sup>. Raportimi përqendrohet tek kreditë e reja të dhëna gjatë tremujorit të parë të vitit dhe po i nënshtrohet një procesi të domosdoshëm të kontrollit të cilësisë dhe të përmirësimit, i cili do të kërkojë edhe të paktën një raportim tjetër tremujor për të siguruar konsistencën e nevojshme nëpërmjet krahasueshmërisë. Të dhënat për kreditë e reja do të vijojnë të raportohen në fund të çdo tremujori, ndërsa të dhënat për kreditë ekzistuese ose për stokun e kredisë do të raportohen në bazë vjetore, duke filluar nga muaji shtator i vitit 2024. Këto të dhëna do të përdoren nga Banka e Shqipërisë për të ndërtuar treguesit më përfaqësues të standardeve të kredidhënies dhe investimeve të bankave në prona të paluajtshme (rezidenciale dhe tregtare), si treguesit e huasë ndaj të ardhurave, huasë ndaj vlerës së pronës, shërbimit të huasë ndaj të ardhurave të kredimarrësit etj. Në të ardhmen, këta tregues do të mbështesin politikën e Bankës së Shqipërisë në zbatimin e instrumenteve makroprudenciale me objektiv kredimarrësin.*

*Paralelisht, gjatë periudhës ka vijuar zbatimi i kërkesave të tjera të parashikuara në rregulloren nr.41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"<sup>8</sup> (Rregullorja 41/2019), si edhe raportimet tremujore të bankave mbi masën e përmbushjes së këtyre kërkesave. Duke nisur nga viti 2020, bankat kanë filluar të përmbushin me shtesa vjetore prej 0.5 p.p. kërkesën për shtesën konservuese të kapitalit (KONS), si edhe për shtesën e kapitalit për bankat me rëndësi sistematike (SIST), që shpallet një herë në vit, në fund të muajit*

<sup>6</sup> Vendimi i Guvernatorit nr. 2852, datë 28.6.2024, «Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit». Sipas kuadrit rregullator, bankat duhet të marrin masa për ta plotësuar këtë shtesë të kapitalit brenda datës 30 qershor 2025.

<sup>7</sup> Publikuar në: [https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Politika\\_makroprudenciale/Instrumentet\\_e\\_politikes\\_makroprudenciale/Akte\\_te\\_miratuara/Rregullore\\_44\\_2023\\_Per\\_raportimin\\_e\\_te\\_dhenave\\_identifikimin\\_dhe\\_monitorimin\\_e\\_treguesve\\_mbi\\_kredidhënien\\_dhe\\_investimet\\_per\\_prona\\_te\\_paluajtshme.html](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Akte_te_miratuara/Rregullore_44_2023_Per_raportimin_e_te_dhenave_identifikimin_dhe_monitorimin_e_treguesve_mbi_kredidhënien_dhe_investimet_per_prona_te_paluajtshme.html)

<sup>8</sup> Për më shumë informacion mund të drejtoheni në adresën: [https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Politika\\_makroprudenciale/Instrumentet\\_e\\_politikes\\_makroprudenciale/Instrumentet\\_dhe\\_Vendimet/](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Instrumentet_dhe_Vendimet/)




mars. Sipas vendimeve të shpallura deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, kërkesa e kombinuar e shtesave të kapitalit që zbatohet ndaj bankave për qëllime makroprudenciale lëviz nga një vlerë minimale prej 2.75% për një bankë josisemike, deri në një vlerë maksimale prej 4.25% për bankën me shtesën më të lartë për rëndësinë sistemike dhe afatet për përbushjen e këtyre kërkesave janë si në tabelën e mëposhtme. Në tërësi, sektori bankar, i ndihmuar nga një pozicion i mirë fillestar i kapitalizimit, ka qenë i aftë deri tani t'i përbushë këto kërkesa. Banka e Shqipërisë vlerëson që zbatimi i tyre, i ndërthurur me zbatimin e kërkesave të reja të lidhura me funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme<sup>9</sup>, kërkon që bankat të ruajnë vëmendjen ndaj fuqizimit të pozicionit të kapitalit, si nëpërmjet emetimeve të detyrimeve të pranuar ashtu edhe duke kapitalizuar fitimet e periudhës.

Tabelë 1. Vlerat e shtesave makroprudenciale të kapitalit që duhet të përbushin bankat dhe afatet e përbushjes

Nr.	SHMAK	Klasifikimi i bankës		Afati i përbushjes	Baza ligjore	Emërtimi i shtesës
		BARS (bankë më rëndësi sistemike)	Jo BARS			
1	SIST	Banka Kombëtare Tregtare sh.a. - 1.50% Banka Credins sh.a. - 1.00% Banka Raiffeisen sh.a. - 1.00% Banka OTP Albania sh.a. - 0.50%	Nuk zbatohet	1 janar 2025	Vendimi i Guvernatorit 1481/2024	Shtesa e kapitalit për rëndësinë sistemike
2	KONS	2.50%	2.50%	Në vazhdim	Rregullorja 41/2019	Shtesa konservuese e kapitalit
3	SPEKUNC	0.25%	0.25%	30 qershor 2025	Vendimi i Guvernatorit 2825/2024	Shtesa kundërciklike e kapitalit për Shqipërinë
4	STRUK	Nuk zbatohet	Nuk zbatohet		Rregullorja 41/2019	Shtesa e kapitalit për rrezikun sistemik
5 = 1+2+3	SHKOMAK	KONS (2.5%) + SIST (nga 0.5% deri në 1.5%) + SPEKUNC (0.25%)	KONS (2.5%) + SPEKUNC (0.25%)			Shtesat e kombinuara të kapitalit

<sup>9</sup> Kërkesat e rregullores nr.78/2020 "Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar".



## HAPËSIRË INFORMUESE 1. INSTRUMENTET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS MAKROPRUDENCIALE

Politika makroprudenciale ka si qëllim arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar nëpërmjet: (a) parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve në sistemin financiar, dhe (b) forcimit të rezistencës së institucioneve dhe agjentëve financiarë. Duke qenë se stabiliteti financiar, si objektivi kryesor i një politike, është një koncept shumë i përgjithshëm dhe jo lehtësisht i matshëm, zbatimi dhe analiza e politikës makroprudenciale synojnë arritjen e disa objektivave të ndërmjetëm, të cilët orientohen rreth zbutjes së rreziqeve kryesore që kërcënojnë stabilitetin financiar. Për Shqipërinë, këta objektiva, së bashku me instrumentet që mund të përdoren për arritjen e tyre, treguesit që shërbejnë për analizat dhe matjen e ndikimit të këtyre instrumenteve dhe kuadrin e përgjithshëm të politikës makroprudenciale, duke përfshirë organizimin institucional, procesin e vendimmarrjes dhe komunikimin e tij në publik, përshkruhen në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale\*. Strategjia paraqet një kuadër të përgjithshëm të politikës makroprudenciale, duke cilësuar që përzgjedhja e instrumenteve, e treguesve dhe e modeleve analitike do të bëhet në përshtatje me rreziqet, strukturën e sistemit financiar, bazën ligjore, të dhënat e disponueshme dhe kapacitetet e subjekteve ndaj të cilave zbatohen këto politika. Duke paraqitur një listë joshteruese të instrumenteve të mundshme makroprudenciale, Strategjia nënvizon që një instrument mund të përdoret për arritjen e më shumë se një objektivi të ndërmjetëm dhe për arritjen e secilit objektivi, instrumentet mund të përdoren më vete ose të kombinuara. Që nga koha e miratimit të Strategjisë, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë disa masa për kufizimin e përdorimit të monedhave të huaja dhe mbështetjen e përdorimit të monedhës vendase, në kuadër të “politikës së deeuroizimit”\*\*, ka miratuar dhe vënë në zbatim Rregulloren 41/2019 “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, ka miratuar dhe ka filluar mbledhjen e të dhënave sipas Rregullores 44/2023 “Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për prona të paluajtshme”, si edhe ka miratuar ose rishikuar një numër rregulloresh të tjera të natyrës kryesisht mbikëqyrëse, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kontribuojnë në arritjen e disa prej objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale.


Ashtu siç paraqitet në tabelë\*\*\*, të gjitha instrumentet që përdoren për të arritur objektivin e parë të politikës makroprudenciale – ngadalësimin ose kufizimin e rritjes së tepërt të kredisë dhe levës financiare – synojnë: a) rritjen e kapacitetit të bankave për të përthithur humbjet; b) uljen e sasisë së humbjeve të bankave në rast falimentimi; c) uljen e probabilitetit të falimentimit të huamarrësit ose një kombinim të këtyre objektivave. Rritja e kapacitetit të bankave për të përthithur humbjet, si rregull, arrihet duke iu kërkuar bankave të mbajnë më shumë kapital për çdo kredi që ato japin, që do të thotë se ato duhet të mbajnë shtesa kapitali që, në varësi të rrezikut për të cilin kërkohen, mund të klasifikohen si shtesa kundërciklike (KUNC), shtesa për rrezikun sistemik strukturor (STRUK) ose shtesa konservuese të kapitalit (KONS). Paralelisht ose në vend të kërkesave për shtesat e kapitalit, për të njëjtin objektivi të ndërmjetëm, autoritetet makroprudenciale mund të përdorin instrumente që zbatohen ndaj huamarrësit dhe që kanë për qëllim a) të ulin kërkesën për kredi, duke pakësuar numrin e huamarrësve që plotësojnë kushtet për marrjen e kredisë, si edhe b) të ulin probabilitetin e falimentimit të huamarrësit. Për shembull, vendosja e një kufiri të sipërm mbi raportin “shërbim i borxhit ndaj të ardhurave” për çdo klient që aplikon për kredi, do të largonte klientët me një vlerë më të lartë të këtij raporti sesa kufiri i caktuar nga banka, ose do të rezultonte në një rishikim të vlerës së kredisë, në mënyrë që kostoja e shërbimit të kredisë të jetë e përballeshme për huamarrësin. Në rastin e parë, masa do të ndikonte në uljen e rrezikut të kredisë për bankën, ndërsa



*në rastin e dytë, rezultati i masës do të ishte një ulje e rrezikut të falimentimit për huamarrësin, pasi ai ka të ardhura të mjaftueshme për të shlyer kredinë.*

Tabelë 2: Instrumentet dhe objektivat e politikës makroprudenciale

Instrumenti (a)	Rritja e rezistencës (b)	Zbutja e akumulimit të dobësive/rrezikut (c)	Akti rregullativ i BSH (d)
<b>Objektivi 1: Instrumentet bazë për të trajtuar rritjen e tepërt të kredisë dhe levës financiare</b>			
Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC)	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet	Ngadalëson rritjen e kredisë, duke rritur kostot e financimit	Rregullore 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"
Vendosja e kufijve të sipërm mbi raportin "kredi-ndaj-huasë", "kredi-ndaj-të ardhurave", "shërbim i borxhit-ndaj-të ardhurave"	Ul sasinë e humbjeve të bankave në rast dështimi; Ul probabilitetin e dështimit të huamarrësit	Kufizim i drejtpërdrejtë i kredisë	Rregullore 44/2023 "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për prona të paluajtshme"
Kërkesa sektoriale	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet; Pakëson humbjet potenciale; Pakëson kredinë në sektorin e rregulluar	Ndikim i mundshëm në ciklin financiar nëpërmjet rritjes së kostove të financimit	
Shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik strukturor (STRUK)	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet		Rregullore 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"
Shtesa konservuese e fondeve të veta (KONS)	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet		Rregullore 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"
Raporti i levës financiare	Pakëson huamarrjen: mbron ndaj gabimit në shtesat e kapitalit të mbështetura mbi rrezikun		Rregullore 63/2020 "Për raportin e levës financiare të bankave"
<b>Objektivi 2: Instrumentet bazë për të trajtuar mospërputhjen e tepërt midis maturiteteve dhe mungesën e likuiditetit në treg</b>			
Raporti neto i financimit të qëndrueshëm të bankave	Rrit qëndrueshmërinë e bazës së financimit për të kufizuar daljet e papritura	Efekt i mundshëm zbutës ndaj ciklit financiar nëse kërkesat janë të detyrueshme	Rregullore 70/2020 "Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave"
Kërkesa të tjera për qëndrueshmërinë e financimit (p.sh. kufizim i raportit kredi/depozita)			
Raporti i mbulimit me likuiditet	Rrit stokun e aktiveve likuide që mund të përdoren për të mbuluar daljet e papritura		Rregullore 27/2019 "Për raportin e mbulimit me likuiditet"
Kërkesa të tjera për likuiditetin			Rregullore 71/2009 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit"





**Objektivi 3: Instrumentet bazë për të trajtuar përqendrimin e ekspozimeve**

Kërkesat sektoriale për kapital	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet	Ndikim i mundshëm në ciklin financiar nëpërmjet rritjes së kostove të financimit	
Shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik strukturor (STRUK)	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet		Regullore 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"
Kufizimi i ekspozimeve të mëdha	Zbut rrezikun e kundërpartisë, përqendrimit dhe përhapjes	Kufizim i drejtpërdrejtë i sasisë së kredisë	Regullore 10/2014 "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"
Shtesa konservuese e fondeve të veta (KONS)	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet	Ndikim i mundshëm në ciklin financiar nëpërmjet rritjes së kostove të financimit	Regullore 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"

**Objektivi 4: Instrumentet bazë për të trajtuar kontributin në rrezikun sistematik të institucioneve financiare**

Shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistematike në nivel global (G-SII)	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet	Ndikim i mundshëm në ciklin financiar nëpërmjet rritjes së kostove të financimit	
Shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistematike në vend (O-SII/SIST)			Regullore 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"
Shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik strukturor (STRUK)			Regullore 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"
Kërkesa të tjera likuiditeti për BARS	Rrit qëndrueshmërinë e bazës së financimit dhe/ose stokun e aktiveve likuide	Përcillet nëpërmjet rritjes së kostove të financimit	

Burimi për (a), (b), (c): Manuali i Bordit Evropian për Rrezikun Sistematik mbi operacionalizimin e politikës makroprudenciale në sektorin bankar, 2018.

Instrumentet që përdoren për të arritur objektivin e dytë – kufizimin e mospërputhjes së maturimeve dhe të mungesës së likuiditetit – kanë formën e kufijve rregullativë mbi raportet midis mjeteve (kredisë) dhe detyrimeve (depozitave dhe financimit nëpërmjet borxhit), sipas përkufizimeve të caktuara nga rregullorja. Pavarësisht se përfshihen në instrumentet makroprudenciale, pjesa më e madhe e këtyre masave janë përdorur për një kohë të gjatë nga autoritetet mbikëqyrëse për të administruar rrezikun e likuiditetit në sistemin financiar. Për Shqipërinë, këto kufizime parashikohen në rregulloret e viteve 2019-2020 për raportin e mbulimit me likuiditet dhe raportin neto të financimit të qëndrueshëm, si edhe në një rregullore më të hershme për administrimin e rrezikut të likuiditetit.

Për të kufizuar përqendrimin e ekspozimeve në një sektor apo kategori të caktuar klientësh – objektivi i tretë – mund të përdoren instrumente të kapitalit, të cilat rrisin qëndrueshmërinë dhe kapacitetet e bankave për përthithjen e humbjeve, ose kufizime rregullative në formën e kufijve sasiorë mbi një ekspozim të caktuar. Në Shqipëri, këta kufij zbatohen mbi ekspozimet e mëdha të bankës



ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur ndërmjet tyre ose me bankën, për qëllim të administrimit të rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre. Nga instrumentet e kapitalit, si mjet për kufizimin e përqendrimit të ekspozimeve, aktualisht Banka e Shqipërisë zbaton vetëm shtesën konservuese të kapitalit (KONS), e cila i shërben në përgjithësi forcimit të kapacitetit të bankave për përthithjen e humbjeve nga mospagimi i kredive. Kërkesat sektoriale për kapital dhe shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik strukturor (STRUK) mund të përdoren në të ardhmen si mënyra për të kontrolluar ose zbutur një rrezik të caktuar (p.sh. nivelin e lartë të përdorimit të valutës), ose ekspozimin ndaj një sektori të veçantë (p.sh. sektorit të ndërtimit/tregut të pasurive të paluajtshme).

Objekti i katërt që lidhet me kufizimin e preferencave të keqorientuara, kryesisht në drejtim të institucioneve me rëndësi sistematike, në përgjithësi adresohet me kërkesa të kapitalit të natyrës së përgjithshme (për të gjitha bankat) ose të veçantë (për banka individuale). Shtesa e kapitalit për rëndësinë sistematike (SIST) është një shtesë kapitali që iu kërkohej bankave të identifikuar si banka me rëndësi sistematike, në nivel botëror ose lokal, dhe kjo shtesë ka për qëllim të forcojë kapacitetet e këtyre bankave për përthithjen e humbjeve. Nëse një bankë sistematike, në terma relativë ndaj portofolit të saj të kreditë, mban më shumë kapital se një bankë josistematike, për të njëjtën goditje ndaj sistemit financiar, banka sistematike është relativisht më e aftë të përthithë humbjen e ekspozimeve të veta. Kjo rezistencë më e lartë e bankës sistematike do të ulte rrezikun e falimentimit të saj, duke pakësuar në këtë mënyrë edhe rrezikun që bankat e tjera të sektorit të dëmtohen nga falimentimi i bankës sistematike. Shtesat e kapitalit për rëndësinë sistematike zbatohen së bashku me shtesat e tjera të lidhura me funksionet mbikëqyrëse dhe makroprudenciale, dhe janë në përpjesëtim të drejtë me notën e rëndësisë sistematike të bankës përkatëse. Kjo do të thotë që, sa më e rëndësishme të jetë një bankë në një juridiksion të caktuar, aq më e madhe duhet të jetë kërkesa për shtesën e kapitalit që i kërkohej bankës për shkak të rëndësisë së saj sistematike.

\* "Strategjia e Politikës Makroprudenciale", e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr. 38, datë 2.8.2017 dhe publikuar këtu: [https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Politika\\_makroprudenciale/Strategjia\\_makroprudenciale/](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Strategjia_makroprudenciale/)

\*\* Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me nr. 9, datë 7.2.2018, "Për miratimin e politikës "Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e bankave dhe të institucioneve financiare jobankare që rregullohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë", publikuar këtu: [https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Paketa\\_e\\_deeuroizimit/](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Paketa_e_deeuroizimit/)

\*\*\* Shkurtime për emërtimet e instrumenteve në tabelë dhe në tekst iu referohen përkufizimeve të rregullores 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit".



**Kuadri i zbatimit të politikës makroprudenciale ka nevojë të përmirësohet vazhdimisht.** Këtë nevojë e diktojnë zhvillimet në veprimtarinë bankare e financiare, por edhe ato të standardeve ndërkombëtare të fushës. Në këtë kontekst, me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e paketave analitike dhe metodologjike të funksionit makroprudencial, gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, u krye rishikimi i metodologjisë "Mbi mënyrën e llogaritjes dhe të ndryshimit të rëndësisë sistemike të bankave dhe të shtesës përkatëse makroprudenciale të kapitalit"<sup>10</sup>. Rishikimi i Metodologjisë<sup>11</sup> kishte për qëllim rritjen e shkallës së kujdesit të Bankës së Shqipërisë gjatë procesit të identifikimit të bankave me rëndësi sistemike, si edhe përfshirjen në këtë dokument të trajtimit të ndryshimeve strukturore në sektorin bankar të lidhura me bashkimin, ndarjen dhe ngjarje të tjera që ndikojnë në mënyrë të menjëhershme notën e rëndësisë sistemike të bankave. Gjithashtu, ka vijuar puna për operacionalizimin e shtesës së kapitalit për rrezikun sistematik (STRUK), duke synuar përfshirjen e ndryshimeve që kanë ndodhur në standardet ndërkombëtare për objektivin dhe mënyrën e përdorimit të këtij instrumenti. Duke analizuar përvojën e vendeve të tjera në përdorimin e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC), po vlerësohet mundësia e rishikimit të aspekteve të caktuara të përdorimit të tij, duke përfshirë edhe zbatimin e një vlere pozitive për nivelin neutral të instrumentit.

Ndërlidhja e fortë dhe e shëndetshme midis sistemit financiar dhe ekonomisë reale, është bazë për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, por krahas ofrimit të mundësive për zhvillim, kjo ndërlidhje shoqërohet me rreziqe për institucionet financiare dhe aktorët e tjerë që veprojnë në këtë mjedis, të cilat kanë nevojë të monitorohen dhe të analizohen rregullisht. Duke u fokusuar në veprimtarinë e sektorit bankar, përmes të dhënave të tregjeve, raportimeve, vrojtimeve, ushtrimeve të provës së rezistencës etj., ky raport synon të bëjë një vlerësim të zhvillimeve që kanë ndikuar veprimtarinë e sektorit bankar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024.

<sup>10</sup> Publikuar në: [https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Politika\\_makroprudenciale/Instrumentet\\_e\\_politikes\\_makroprudenciale/Akte\\_te\\_miratuara/Rregullore\\_41\\_2019\\_Per\\_shtesat\\_makroprudenciale\\_te\\_kapitalit.html](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Akte_te_miratuara/Rregullore_41_2019_Per_shtesat_makroprudenciale_te_kapitalit.html)

<sup>11</sup> I realizuar sipas dokumentit të miratuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, nr.prot.828, datë 1.2.2024.



## 2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

### 2.1 HARTA E STABILITETIT FINANCIAR

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, rreziqet e monitoruara nga Harta e Stabilitetit Financiar kanë qenë në nivele të përmbajtura dhe shfaqen përgjithësisht në zbutje.

Krahasuar me një vit më parë, kjo ecuri është diktuar nga treguesit e aktivitetit të agjentëve të ekonomisë, ndërkohë që niveli i përgjithshëm i rreziqeve nga zhvillimet ekonomike të brendshme dhe të jashtme paraqitet më i lartë.

Edhe rreziqet e veprimitarisë bankare vlerësohen të kontrolluara dhe përgjithësisht në zbutje, ndikuar nga përmirësimi i përfitueshmërisë dhe nivelet e mira të likuiditetit dhe kapitalizimit.


Harta e stabilitetit financiar tregon një nivel përgjithësisht të përmbajtur dhe në rënie të një pjese të rreziqeve nga mjedisi makroekonomik. Në krahasim me një vit më parë, vërehet një prirje në zbutje e nivelit të vlerësuar të rrezikut nga sektori i "bizneseve" dhe "qeverisë", ndërkohë që rreziku nga sektori i "individëve" mbetet "i ulët" dhe nuk ka ndryshuar gjatë periudhës. Rreziqet lidhur me veprimtarinë e sektorit bankar kanë rezultuar gjithashtu në rënie, veçanërisht për kategoritë "kapitalizimi dhe përfitueshmëria" dhe "likuiditeti".

#### RREZIQET NË MJEDISIN E PËRGJITHSHËM EKONOMIK


Rreziku që buron nga ekonomia e brendshme, sipas treguesve që paraqesin situatën deri në fund të tremujorit të parë të 2024-ës, ka rezultuar në nivelin "mesatar" dhe është rritur lehtë krahasuar me një vit më parë. Kjo ecuri ka reflektuar luhatjen e nëntreguesve përbërës të këtij dimensionit. Rënia e normës së inflacionit gjatë periudhës, forcimi i kursit të këmbimit dhe rënia e nivelit të borxhit të jashtëm në raport me PBB-në, duke e ulur notën e agreguar të rrezikut, kanë balancuar pjesërisht rritjen e rrezikut të lidhur me rritjen e nevojave për financim të jashtëm dhe përkeqësimin e treguesit të hendekut të prodhimit.

Pavarësisht rritjes së lehtë krahasuar me një vit më parë, rreziku nga mjedisi i jashtëm vijon të vlerësohet si "mesatar" dhe nuk ka ndryshuar gjatë periudhës. Prirja rritëse e këtij rreziku ndaj një viti më parë është diktuar nga rritja e çmimeve të naftës dhe niveli ende i lartë i normave afatshkurtra të interesit në tregjet ndërkombëtare. Nga ana tjetër, përmirësimi i ecurisë ekonomike të partnerëve kryesorë tregtarë të vendit tonë dhe rënia e normave të papunësisë në vendet që janë burimi kryesor i dërgesave të emigrantëve shqiptarë kanë kontribuar në zbutjen e tij.

Grafik 3. Harta e stabilitetit financiar




\*Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut. Burimi: Banka e Shqipërisë.



## RREZIQET E LIDHURA ME VEPRIMTARINË E AGJENTËVE TË EKONOMISË REALE<sup>12</sup>

Rreziku nga sektori i "individëve" ka mbetur "i ulët" dhe i pandryshuar krahasuar me një vit më parë, ndërsa rreziku nga aktiviteti i "bizneseve" dhe "qeverisë" është zbutur. Niveli i përgjithshëm i rrezikut nga sektori i individëve ka mbetur pothuajse i njëjtë me një vit më parë, pasi një rritje e vogël e tij për shkak të zhvillimeve në tregun e banesave dhe në dërgesat e emigrantëve, është balancuar nga përmirësimi i treguesit të huamarrjes së individëve. Për sektorin e bizneseve, niveli i rrezikut ka rezultuar "i ulët" dhe në rënie në terma vjetorë, pasi rritja e tij nga përkeqësimi i pritjeve të bizneseve, është zbutur nga përmirësimi i treguesve të nivelit dhe cilësisë së huamarrjes së bizneseve. Niveli i përgjithshëm i rrezikut nga sektori i "qeverisë" vlerësohet gjithashtu "i ulët" dhe i pandryshuar, falë tkurrjes së peshës së borxhit publik ndaj PBB-së, që ka balancuar rrezikun lidhur me ecurinë e deficitit buxhetor gjatë periudhës.



## RREZIQET E LIDHURA ME VEPRIMTARINË E SEKTORIT BANKAR

Rreziku nga kapitalizimi dhe përfitueshmëria vlerësohet në nivelin "i ulët" dhe në rënie krahasuar me një vit më parë. Kjo rënie është diktuar kryesisht nga rritja e të ardhurave të sektorit bankar dhe përmirësimi i treguesve të kapitalit. Rreziku nga likuiditeti dhe financimi ka rezultuar në nivelin "mesatar" dhe në rënie, ndikuar nga efekti zbutës i rritjes së depozitave të individëve dhe përmirësimi i treguesit të likuiditetit afatshkurtër. Rreziku që lidhet me strukturën e sektorit bankar ka mbetur në nivelin "mesatar" dhe i pandryshuar gjatë periudhës, falë përmirësimit të treguesve të përqendrimit të kredisë.

<sup>12</sup> Vlerësimet janë kryer bazuar në vlerat më të fundit zyrtare të publikuara, T1-2024.



## 2.2 MJEDISI EKONOMIK I JASHTËM

Aktiviteti ekonomik botëror ka vijuar të zgjerohet gjatë periudhës. Zhvillimet përgjithësisht pozitive në tregun e punës, ecuria e mirë në sektorët e shërbimeve dhe lehtësimi i kushteve të financimit në tregje, ndihmuan rikuperimin e konsumit dhe të investimeve private gjatë periudhës.

Presionet inflacioniste kanë vijuar të bien, por me ritëm më të ngadaltë krahasuar me vitin e kaluar.

Kushtet e financimit kanë qenë përgjithësisht më të lehtësuara. Megjithatë, rënia e normave të interesit në tregjet e parasë dhe të kapitalit ka qenë më e ngadaltë nga pritjet, duke reflektuar qëndrueshmërinë e presioneve inflacioniste dhe shpejtësinë më të ulët të normalizimit të politikës monetare nga bankat qendrore kryesore.

Ekonomia botërore pritet të vijojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme, por të ngadaltë gjatë periudhës 2024-2025, dhe rritja do të kryesohet nga rajonet në zhvillim.

Rreziqet ndaj perspektivës së ekonomisë botërore vlerësohen përgjithësisht të balancuara. Megjithatë, niveli i pasigurisë mbetet i lartë, i ndikuar nga shpejtësia e rënies së inflacionit dhe përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike që mund të nxisin goditje të reja ndaj zinxhirëve të prodhimit. Këtyre faktorëve më afatshkurtër u shtohet efekti i ndryshimeve strukturore të lidhura me ndryshimet e klimës dhe teknologjinë.

Ekonomia botërore u zgjerua me një ritëm modest, por të qëndrueshëm, gjatë gjysmës së parë të vitit 2024. Gjatë periudhës, zhvillimet përgjithësisht pozitive në tregun e punës, ecuria e mirë e sektorëve të shërbimeve dhe lehtësimi i kushteve të financimit në tregje, ndihmuan rikuperimin e konsumit dhe të investimeve private. Zinxhirët botërorë të prodhimit dhe shpërndarjes vijuan të normalizohen, por shqetësimet lidhur me përshkallëzimin e konfliktit në Lindjen e Mesme dhe të ardhmen e politikave tregtare, kanë ardhur në rritje. Pasiguria që shoqëron zhvillimet gjeopolitike mbetet e lartë, duke rrezikuar perspektivën e aktivitetit ekonomik global. Ecuria e treguesve makroekonomikë përforcon pritjet për një rritje modeste në pjesën e dytë të vitit dhe përshpejtimin e saj në vitin e ardhshëm.

Pas performancës së mirë të vitit të kaluar, rritja ekonomike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) është ngadalësuar në tremujorin e parë, si rezultat i ngadalësimit të konsumit dhe tregtisë neto, ndërkohë që ekonomia e Evropës ka shfaqur shenja të qëndrueshme rimëkëmbjeje, mbështetur kryesisht nga rigjallërimi i aktivitetit në sektorët e shërbimeve.

Inflacioni global ka vijuar të bjerë, por me ritëm më të ngadaltë krahasuar me vitin e kaluar. Në rajonet e zhvilluara, ecuria e inflacionit ka shfaqur dinamika të ndryshme sektoriale, pasi presionet inflacioniste kanë qenë më të qëndrueshme në sektorët e shërbimeve krahasuar me ato të mallrave, nën ndikimin edhe të rritjes së kostos së punës në disa rajone. Si rezultat, ndonëse kanë ndaluar rritjen e normave të interesit që në fund të vitit të kaluar, bankat qendrore kanë shtyrë në kohë vendimet për normalizimin e politikës monetare, duke theksuar angazhimin e tyre për të rikthyer inflacionin në objektivat e synuar, në mënyrë të qëndrueshme.

Në tregjet financiare, kushtet e financimit kanë qenë përgjithësisht më të lehtësuara gjatë periudhës, duke reflektuar pritjet mbi lehtësimin e politikës monetare dhe perspektivën ekonomike të rajoneve të ndryshme. Megjithatë, pasiguria mbi ecurinë e ardhshme të inflacionit ka mbetur e pranishme dhe hezitimi i bankave qendrore drejt lehtësimit të shpejtë të politikës monetare ka zbehur pritjet e tregut për rënien e shpejtë të normave të interesit. Për këto arsye, në tregjet e zhvilluara, *yield*-et e titujve afatgjatë të borxhit kanë rënë në mënyrë të ngadaltë, ndërsa në tregjet në zhvillim ato kanë mbetur relativisht të qëndrueshme, duke rritur presionin mbi politikën e ardhshme fiskale. Në tregjet e kapitalit, fitimet e kënaqshme të korporatave në SHBA dhe në Evropë kanë çuar në rënie të luhatshmërisë dhe rritje të vlerave. Në tregjet në zhvillim, kushtet e financimit kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme, por presionet për zhvlerësim të monedhave janë shtuar dhe në disa tregje janë regjistruar edhe dalje të kapitalit. Në tregjet e këmbimit të monedhave, dinamikat janë diktuar nga divergjencat në shpejtësinë e normalizimit të politikës monetare të bankave qendrore. Monedha Euro, përgjithësisht, është nënçmuar ndaj Dollarit amerikan



dhe Paundit anglez, duke u stabilizuar në fund të periudhës, ndërkohë që ajo është mbiçmuar lehtë ndaj monedhave të tjera kryesore si Jeni japonez, Franga zvicerane dhe atyre të vendeve të mëdha në zhvillim.

**Në tregjet e lëndëve të para, çmimet e naftës kanë shënuar rritje gjatë muajve të verës,** duke reflektuar pritjet për reduktimin e sasive të prodhimit nga vendet e OPEC+ dhe rritjen e shqetësimeve mbi përshkallëzimin e tensioneve gjeopolitike në Lindjen e Mesme. Nga ana tjetër, çmimet e gazit natyror në Evropë kanë rënë për shkak të ndërprerjes së varësisë nga gazi rus dhe stabilizimit të furnizimit nga burime alternative. Çmimet e ushqimeve dhe lëndëve të para joenergjetike gjithashtu kanë vijuar të ndjekin trajektore rënëse gjatë periudhës.

**Parashikimet e ekspertëve sugjerojnë që ekonomia botërore do të vijojë të zgjerohet në mënyrë të qëndrueshme, por të ngadalhtë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024 dhe 2025-ës.**<sup>13</sup> Sipas FMN-së, rritja ekonomike e rajoneve të zhvilluara do të konvergojë mesatarisht në nivelin 1.7% - 1.8%, ku ekonomia e SHBA-së pritet të ngadalësohet, ndikuar nga dobësimi i konsumit të brendshëm, ndërkohë që ekonomia e Eurozonës parashikohet të rimëkëmbet gradualisht, mbështetur nga forcimi i kërkesës dhe investimeve. Ekonomitë në zhvillim parashikohet të rriten në mënyrë të qëndrueshme, mbështetur kryesisht nga zgjerimi i mëtejshëm i aktivitetit në vendet e mëdha si Kina dhe India. Inflacioni global pritet që të vijojë rënien<sup>14</sup>. Në vendet e zhvilluara, shpejtësia e rënies së inflacionit parashikohet të ngadalësohet gjatë këtij viti dhe vitit të ardhshëm, për shkak të presioneve ende të larta në sektorët e shërbimeve. Gjithsesi, ftohja graduale e tregut të punës, e kombinuar dhe me një rënie të pritshme të çmimeve të lëndëve të para energjetike, pritet të ulin normat e inflacionit pranë vlerave të synuara nga bankat qendrore brenda vitit të ardhshëm.

**Rreziqet ndaj perspektivës së ekonomisë botërore vlerësohen përgjithësisht të balancuara.** Gjithsesi, pasiguria mbetet e lartë dhe e ndikuar nga rreziqe afatshkurtra që lidhen kryesisht me ecurinë e ardhshme të inflacionit, veçanërisht në sektorët e shërbimeve dhe shtyrjen përtej pritjeve të normalizimit të politikës monetare, çka mund të sjellë rreziqe financiare e fiskale, dhe lëvizje të pafavorshme të kapitalit. Në afatin e mesëm, përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike, ndryshime të mundshme në tarifatat dhe barrierat tregtare pas zgjedhjeve politike në SHBA, dhe ngjarjet e lidhura me ndryshimin e klimës, mund të gjenerojnë goditje të reja ndaj zinxhirëve botërorë të prodhimit dhe shpërndarjes.

<sup>13</sup> Në përditësimin më të fundit, FMN-ja parashikon që aktiviteti i ekonomisë botërore do të zgjerohet me 3.2% për vitin 2024 dhe 3.3% për vitin 2025.

<sup>14</sup> FMN-ja parashikon që inflacioni në shkallë botërore do të bjerë mesatarisht nga niveli 6.8% në vitin 2023, në 5.9% dhe 4.4%, respektivisht në vitet 2024 dhe 2025.



## EUROZONA

*Ekonomia e Eurozonës ka shfaqur shenja modeste por të qëndrueshme rimëkëmbjeje gjatë gjysmës së parë të vitit, mbështetur kryesisht nga tregtia dhe sektorët e shërbimeve.*

*Normat e inflacionit kanë vijuar të bien, por me ritëm më të ngadaltë, duke pasqyruar zbehjen e efektit të shtrëngimit monetar dhe të bazës krahasuese.*

*Banka Qendrore Evropiane ka nisur lehtësimin monetar përmes uljes së normës bazë në qershor, por ka mbetur e orientuar drejt arritjes së objektivit të inflacionit prej 2%.*

*Tregjet financiare evropiane janë karakterizuar nga luhatshmëria, ndërsa kreditimi nga bankat ka mbetur përgjithësisht i dobët.*

*Me gjithë pasiguritë, rritja ekonomike e Eurozonës pritet të rigjallërohet gradualisht gjatë këtij viti, ndërsa presionet inflacioniste pritet të lehtësohen. Norma e inflacionit parashikohet të rikthehet në objektivin e BQE-së në vitin 2025.*

Pas një periudhe stanjacioni, ekonomia e Eurozonës ka shfaqur shenja rikuperimi në gjysmën e parë të vitit 2024. Aktiviteti u zgjerua me 0.3% në tremujorin e parë të vitit dhe me 0.5% në terma vjetorë, mbështetur kryesisht nga ecuria pozitive e eksporteve neto, ndërkohë që kërkesa e brendshme dha kontribut negativ. Vlerësimet paraprake tregojnë se ekonomia e Eurozonës ka vijuar të rritet dhe në tremujorin e dytë, por me ritëm më të ulët. Rritja është drejtuar kryesisht nga sektori i shërbimeve, ndërkohë që rikuperimi i prodhimit industrial dhe investimeve ka vijuar të mbetet i dobët, ndikuar nga kostot ende të larta të financimit dhe prania e pasigurive. Ekspertët parashikojnë që ekonomia e Eurozonës do të vijojë të rimëkëmbet gjatë pjesës së dytë të vitit, mbështetur kryesisht nga forcimi i konsumit të brendshëm si rezultat i rënies së inflacionit dhe rritjes së të ardhurave reale. Nga ana tjetër, eksportet pritet të mbështeten nga rigjallërimi i kërkesës së jashtme, ndërsa lehtësimi i mëtejshëm monetar nga ana e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) pritet të zbusë më tej presionet në tregjet financiare.

Pavarësisht luhatjeve të vogla, norma vjetore e inflacionit të Eurozonës ka vijuar të bjerë në mënyrë të qëndrueshme. Ajo shënoi 2.6% në muajin maj dhe 2.5% në qershor. Gjatë tremujorit të parë të vitit, dinamikat e inflacionit u diktuan kryesisht nga ecuria e çmimeve të energjisë dhe të shërbimeve, ndërkohë që inflacioni i ushqimeve ka vijuar të bjerë. Në fund të tremujorit të dytë, në krahasim me një vit më parë, shumica e përbërësve të inflacionit kanë mbetur të pandryshuar, duke reflektuar zbutjen e presioneve dhe zbehjen e efektit të bazës krahasuese. Në tregun e punës, zhvillimet kanë qenë pozitive dhe të qëndrueshme. Niveli i punësimit është rritur dhe rritja më e fortë është regjistruar në sektorin e shërbimeve. Norma mesatare e papunësisë në muajin qershor shënoi 6.5%. Së bashku me vlerën e muajit maj, kjo është një nga vlerat më të ulëta historike që nga fillimi i përdorimit të monedhës së përbashkët Euro.

Në tregjet financiare evropiane, zhvillimet janë diktuar nga pritjet mbi ecurinë e inflacionit dhe shpejtësinë e lehtësimit të politikës monetare të BQE-së. Në vijim të dobësimit të presioneve inflacioniste, BQE-ja ka ulur normën bazë të interesit me 25 pikë bazë (0.25%) në mbledhjen e datës 6 qershor, por ka deklaruar se politika e saj do të mbetet e orientuar drejt arritjes së objektivit afatmesëm të inflacionit në nivelin 2%. Këto qëndrime janë reflektuar në rënien e normave afatshkurtra në tremujorin e dytë, ndërkohë që kushtet financiare në tregje më afatgjata kanë qenë më të luhatshme.

Dinamikat e kreditimit të bizneseve dhe individëve kanë mbetur përgjithësisht të dobëta, gjatë periudhës. Vijimi i efekteve të shtrëngimit monetar gjatë vitit të kaluar, ka mbajtur të larta normat e kredisë për bizneset dhe familjet. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, standardet e kreditimit të familjeve janë lehtësuar disi, duke sjellë rritje të kërkesës së tyre për kredi për herë të parë që nga fillimi i vitit 2022, ndërkohë që kërkesa e bizneseve ka vijuar të paraqitet në rënie.





Sipas parashikimeve më të fundit të publikuara nga BQE-ja, aktiviteti ekonomik në Eurozonë pritet të mbetet në fazën e rikuperimit gjatë gjithë vitit 2024, pavarësisht pasigurive në rritje. Kjo ecuri do të mbështetet nga rritja e të ardhurave të disponueshme, si rezultat i rritjes së qëndrueshme të pagave dhe dobësimit të presioneve inflacioniste, ndërkohë që eksportet evropiane pritet të rigjallërohen me forcimin e kërkesës së jashtme. Këto parashikime mbeten të rrethuara nga një nivel i lartë pasigurie, lidhur me tensionet tregtare dhe gjeopolitike në rritje, të cilat mund të pengojnë rigjallërimin e prodhimit dhe të investimeve. Normat e inflacionit pritet të luhaten rreth niveleve aktuale dhe në pjesën e dytë të vitit dhe të rikthehen afër (dhe nën) nivelit 2% në vitin 2025. Deri atëherë, BQE-ja ka deklaruar se mbetet e angazhuar në misionin e saj për të rikthyer inflacionin brenda objektivit të synuar, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin ekonomik dhe financiar të Eurozonës.

Tabelë 3. Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)			Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)	
	2024*	T1'24	T2'24	Mar'24	Qer'24	Mars'24	Qer'24	T4'23	T1'24
SHBA	2.6	1.4	2.8	3.5	3.0	3.8	4.1	121.6	122.3
Eurozonë	0.9	0.5	0.6	2.4	2.5	6.6	6.4	88.2	88.7
Gjermani	0.2	-0.1	-0.1	2.3	2.5	3.3	3.3	63.6	63.4
Francë	0.9	1.5	1.1	2.4	2.5	7.4	7.4	109.9	110.8
Itali	0.7	0.6	0.9	1.2	0.9	7.1	6.8	137.3	137.7
Greqi	:	2.1	:	3.4	2.5	10.7	10.6	161.9	159.8

Burimi: BQE, Eurostat, \*-vlerësim i FMN-së (Korrik 2023), Zyra Amerikane e Analizave Ekonomike (US Bureau of Statistical analysis); Zyra Amerikane e Statistikave të Punës (U.S. Bureau of Labor Statistics); ": mungesë informacioni.

## BALLKANI PERËNDIMOR

Ekonomia e vendeve të Ballkanit Perëndimor u rrit mesatarisht me 3.9% gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, krahasuar me një vit më parë (nga 3.2% në tremujorin paraardhës). Të gjitha vendet regjistruan rritje pozitive të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe normat më të larta u raportuan nga Kosova dhe Serbia. Rritja në këto vende u mbështet kryesisht nga forcimi i kërkesës së brendshme, ndërkohë që tregtia pati përgjithësisht kontribut negativ. Zgjerimi i aktivitetit kontribuoi në rritjen e të ardhurave buxhetore dhe përmirësimin e bilanceve fiskale në gjithë vendet e rajonit, me përjashtim të Maqedonisë së Veriut. Kjo ecuri ka krijuar hapësirë për ulje të mëtejshme të borxhit në raport me PBB-në gjatë tremujorit të parë 2024, dhe kjo rënie ishte më e theksuar në rastin e Shqipërisë dhe Serbisë. Në linjë me ecurinë ekonomike, punësimi shënoi rritje në shumicën e vendeve të rajonit dhe norma e papunësisë ra në vlerat më të ulëta historike, ndonëse ajo mbetet dukshëm mbi nivelet e BE-së.

Në sektorin e jashtëm, në ndryshim nga prirja pozitive e nisur që në 2022, llogaria korrente në shumicën e vendeve të rajonit është përkeqësuar gjatë periudhës, si rezultat i thellimit të deficit tregtar, rënies së dërgesave të emigrantëve dhe, në ndonjë rast, edhe dobësisë së eksportit të shërbimeve. Nga ana tjetër, investimet direkte mbetën të qëndrueshme dhe shënuan rritje në disa prej vendeve.

Në tremujorin e parë 2024, ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë rritur me norma të kënaqshme dhe më të larta krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Kjo ecuri ka sjellë përmirësim të bilanceve fiskale dhe ulje të borxhit publik.

Në sektorin e jashtëm, llogaria korrente është përkeqësuar në shumicën e vendeve.

Shtrengimi i politikës monetare gjatë vitit të kaluar ka dhënë efektet e veta në rënie të mëtejshme të normave të inflacionit.

Cilësia e kredisë në rajon ka mbetur e qëndrueshme dhe raportet e kredive me probleme janë në nivele relativisht të ulëta.



Presionet inflacioniste kanë vijuar të zbuten në të gjithë rajonin dhe norma mesatare e inflacionit vjetor u ngadalësua në 4.1% në tremujorin e parë 2024, duke u luhatur nga 2% në Bosnjë, në 5.4% në Malin e Zi. Inflacioni ka vijuar të ngadalësohet në Shqipëri dhe Serbi, duke u dhënë mundësi bankave qendrore të lehtësojnë në mënyrë të kujdesshme politikën monetare nëpërmjet uljes së normës së interesit.

Zhvillimet në sektorin bankar kanë qenë pozitive dhe aktiviteti kreditues ka vijuar të zgjerohet me ritëm të përsheptuar në shumicën e vendeve. Frenimi i shtrëngimit monetar të bankave qendrore ka nxitur lehtësimin e kushteve dhe rritjen e ofertës së kredisë bankare ndaj sektorit të individëve dhe atij të bizneseve në të gjithë rajonin. Raporti i kredive me probleme mbetet në nivele të ulëta dhe ka shënuar rënie në një pjesë të vendeve. Pavarësisht pritjeve, rritja e normave të interesit gjatë vitit të kaluar nuk ka shfaqur ndonjë ndikim të dukshëm negativ në cilësinë e kredisë.

Tabelë 4. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)			Papunësia (në %)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në%)	
	T4'23	T1'24	2024p	T4'23	T1'24	T1'24	T2'24*	T1'24	T2'24*
Bosnje-Hercegovinë	1.7	2.7	2.3	12.7	13.5	7.7	9.4	3.6	:
Maqedoni e Veriut	0.9	1.2	2.9	13.2	12.9	6.1	6.8	3.1	:
Mali i Zi	4.3	4.4	3.4	12.4	12.0	10.8	13.4	4.9	4.6
Kosovë	4.0	5.6	:	:	:	12.9	12.5	2.0	2.1
Serbi	3.8	4.7	3.5	9.1	9.4	0.8	2.6	3.2	:
Shqipëri**	3.8	3.6	3.3	11.2	:	6.6	11.1	4.6	4.7

Burimi: Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse, INSTAT. Shpjegime: 'p'- parashikimi i ECFIN në Korrik, 2024 ': mungesë informacioni; '\*\*' të dhënat të muajit maj, 2024, "\*\*\*" të dhënat të muajit qershor 2024.

Gjatë periudhës, ekonomia shqiptare vijoi të rritet me ritme pozitive dhe në fund të tremujorit të parë rritja ekonomike vjetore shënoi 3.6%.

Kjo rritje ka pasur një bazë të gjerë sipas sektorëve, veçanërisht nga ndërtimi, tregtia e transporti, dhe është mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme.

Në kahun e kërkesës, aktiviteti ekonomik u mbështet nga konsumi final dhe investimet e sektorit privat, ndërsa thellimi i deficitit tregtar ka ndikuar në kahun rënës të rritjes ekonomike.


Tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive si rritja e punësimit dhe rritja e pagave në sektorin shtetëror dhe atë privat.

## 2.3 MJEDISI EKONOMIK NË VEND

### SEKTORI REAL DHE TREGU I PUNËS


Në fund të tremujorit të parë të vitit, norma e rritjes vjetore të ekonomisë ishte rreth 3.6%. Kjo normë ishte pak më e lartë se ajo prej 3.5% e regjistruar në fund të vitit 2023. Rritja ekonomike ka ardhur nga sektori i prodhimit dhe nga sektori i shërbimeve. Të dhënat e periudhës tregojnë që kontributin kryesor në rritje e kanë dhënë aktivitetet e "ndërtimit", "administrimit publik, arsimit dhe shëndetësisë", dhe "tregtisë, transportit, akomodimit dhe shërbimit ushqimor"<sup>15</sup>. Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, me kontribut kryesor nga investimet e sektorit privat dhe konsumi final i popullatës. Kërkesa e qëndrueshme u materializua në thellim të deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave, si pasojë e rritjes së deficitit të mallrave, duke bërë që eksportet neto të japin një ndikim frenues mbi rritjen

<sup>15</sup> Këta sektorë kontribuuan përkatësisht me rreth 1.19 p.p., 0.92 p.p. dhe 0.76 p.p. në terma vjetorë.






ekonomike. Treguesi i ndjesisë ekonomike, ndonëse regjistron vlera mbi mesataren e tij historike, shënoi rënie në muajin qershor, i ndikuar kryesisht nga ecuria e treguesve të tregtisë, të shërbimeve dhe të ndërtimit. Ndonëse në një masë më të vogël, rënie shënoi edhe treguesi i besimit të industrisë dhe ai i konsumatorëve.

**Zhvillimet në tregun e punës gjatë tremujorit të parë të vitit ishin pozitive.** Numri i punëkërkuësve të papunë u rrit lehtë në krahasim me fundin e vitit 2023, por u pakësua me 3% ose rreth 2.6 mijë vetë në krahasim me një vit më parë. Numri i përgjithshëm i të punësuarve gjatë së njëjtës periudhë u rrit me 1% ose 8 mijë vetë në krahasim me një vit më parë, dhe rritja lidhet me një rritje të pothuajse së njëjtës masë të numrit të të punësuarve në sektorin privat. Raportimi më i fundit mbi normën e papunësisë i përket fundit të vitit 2023 dhe vlera përkatëse ishte 10.7%.



**Rritja e pagave ka vijuar në sektorin shtetëror dhe në atë privat.** Në terma vjetorë, norma mesatare e rritjes së pagës mesatare mujore bruto arriti në rreth 14% gjatë tremujorit të parë të vitit, duke reflektuar rritjen e pagave në sektorin privat (rreth 13%) dhe në sektorin publik (rreth 16%). Në sektorin privat, rritja e pagave është shtrirë në të gjithë sektorët, por mbetet më e theksuar në sektorin e shërbimeve. Rritja me bazë të gjerë e pagave përbën një premisë pozitive për zhvillimet e pritshme në sektorin financiar, duke qenë se përmirëson aftësinë paguese të kredimarrësve dhe raportet e kushteve të marrjes së kredisë, si atë të të ardhurave ndaj borxhit dhe atë të shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave.



## ZHVILLIMET MONETARE DHE FISKALE

Gjashtëmujori i parë i vitit u karakterizua nga rënie e shpejtë e normës së inflacionit. Kjo ecuri ka reflektuar efektin e normalizimit të politikës monetare, mbicmimin e monedhës vendase dhe rënien e inflacionit të importuar. Në fillim të muajit korrik, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 25 pikë bazë, në nivelin 3%.

Gjatë periudhës, politika fiskale ka qenë konsoliduese. Objektivat për balancën buxhetore tejkaloan planifikimin në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024. Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale - deficitit buxhetor dhe borxhi publik - kanë shfaqur rënie të ndjeshme gjatë periudhës.

Deficiti i llogarisë korrente u zgjerua gjatë gjysmës së parë të vitit, si rezultat i thellimit të deficitit tregtar në mallra. Kontribut pozitiv dhanë rritja e flukseve neto të valutës nga shërbimet e udhëtimit, dhe nga dërgesat e emigrantëve.

Rritja e investimeve të huaja direkte, e shoqëruar me daljen neto të investimeve të portofolit, nuk ishte e mjaftueshme për të mbuluar rritjen e deficitit korrent, dhe gjatë periudhës u regjistrua ikurrije e mjeteve të rezervës.

Stoku i pozicionit debitor të vendit ndaj jorezidentëve u zgjerua gjatë tremujorit të parë 2024, për shkak të rritjes së detyrimeve neto të sektorit privat në formën e investimeve të huaja direkte dhe të portofolit.

Gjatë periudhës, inflacioni shënoi rënie të vazhdueshme. Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit 2023 ka ndihmuar në rënien graduale por të vazhdueshme të presioneve inflacioniste, duke mos e cenuar perspektivën e rritjes së ekonomisë të vendit. Norma mesatare e inflacionit vjetor zbriti në nivelin 2.1% në tremujorin e dytë të vitit, kundrejt 4.6% një vit më parë. Kjo ecuri e çmimeve u diktua nga një ulje e shpejtë e inflacionit të artikujve ushqimorë, duke pasqyruar – në masën më të madhe – rënien e inflacionit të importuar, si dhe prirjen forcuese të kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e rritjes së aktivitetit ekonomik në vend, shoqëruar me zhvillimet pozitive në tregun e punës dhe të pagave, kanë kontribuar në mbështetjen e presioneve të brendshme inflacioniste. Për këto arsye, në muajin korrik, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje, në nivelin 3.0%. Megjithatë presionet inflacioniste duken përgjithësisht në rënie, qëndrimi i politikës monetare do të mbetet i kushtëzuar nga ecuria e të dhënave ekonomike, financiare dhe e faktorëve të rrezikut.

Gjatë periudhës, politika fiskale ka qenë konsoliduese. Gjendja e tepricës buxhetore tejkalo planifikimin në fund të periudhës, në kushtet kur të ardhurat ishin më të larta dhe shpenzimet më të ulëta sesa plani respektiv. Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale - deficitit buxhetor dhe borxhi publik në total – shfaqën rënie të ndjeshme<sup>16</sup>. Në fund të muajit qershor 2024, balanca buxhetore regjistroi një tepricë pozitive (suficit) prej rreth 51 miliardë lekësh, kundrejt një suficitit prej 46 miliardë lekësh një vit më parë. Zgjerimi i suficitit fiskal në terma vjetorë ka ardhur për shkak të rritjes së të ardhurave, kryesisht nga tatimet dhe doganat, me rreth 23 miliardë lekë ose me 7%. Nga ana tjetër, shpenzimet u rritën me rreth 18 miliardë lekë ose me rreth 6%, dhe u orientuan drejt shpenzimeve korrente për fondet speciale dhe ato për paga. Deficiti buxhetor është financuar më shumë nga huamarrja e brendshme sesa ajo e huaj. Rritja e tepricës pozitive të balancës buxhetore, ka ruajtur prirjen konsoliduese të politikës fiskale dhe ndikimin pozitiv mbi kontrollin e inflacionit.

## SEKTORI I JASHTËM

Gjysma e parë e vitit është karakterizuar nga një thellim i ndjeshëm i deficitit korrent në krahasim me një vit më parë, kryesisht për shkak të rritjes së fortë të deficitit të mallrave gjatë tremujorit të parë. Deficiti korrent i periudhës arriti në 580 milionë euro dhe kjo vlerë ishte 50% më e lartë nga ajo e regjistruar gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Pothuajse i gjithë përqësimi lidhet me rritjen e fortë të deficitit korrent dhe atij të tregtisë së mallrave gjatë tremujorit të parë të vitit. Rritja e importeve të mallrave me rreth 15%, përballë një rënieje me 4% të eksporteve, rezultoi në një rritje të deficitit tregtar nga 2,100 milionë në 2,600 milionë euro ose me 23%. Rritja e importeve të mallrave lidhet me rritjen e

<sup>16</sup> Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave, borxhi publik në fund të qershorit 2024 zbriti në nivelin 56%, i cili është niveli më i ulët që nga viti 2010. Njëkohësisht, balanca primare buxhetore regjistroi vlera pozitive.



importeve të grupeve “mjete transporti”, “ushqime” dhe “metale bazë”. Tregtia e shërbimeve, e dominuar nga shërbimet e udhëtimit ose turizmi ndërkufitar, të ardhurat nga emigrantët dhe të ardhurat e tjera parësore dhe dytësore, kanë regjistruar përmirësime të bilanceve të tyre dhe kanë kontribuar në zbutjen e deficitit korrent me rreth 280 milionë euro. Të ardhurat nga emigrantët gjatë periudhës arritën në 510 milionë euro, duke u rritur me 15% ndaj një viti më parë, ndërkohë që importet dhe eksportet e shërbimeve të udhëtimit shënuan përkatësisht 1,210 dhe 1,950 milionë euro, me një rritje vjetore prej rreth 25%.

**Mbulimi i deficitit korrent me hyrje nga llogaria financiare ka rënë ndjeshëm në krahasim me një vit më parë**, si rezultat i ecurisë së investimeve të portofolit, ndërkohë që investimet e huaja direkte janë rritur. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë vendase, e matur si shumë e bilancit të llogarisë korrente me bilancin e llogarisë kapitale të regjistruar gjatë periudhës, është trefishuar në krahasim me një vit më parë, duke arritur në 710 milionë euro nga 240 milionë euro, për shkak të rritjes së fortë të kërkesës neto për mallra nga jashtë. Në të njëjtën kohë, flukset hyrëse neto në llogarinë financiare nuk janë zgjeruar me ritme të ngjashme me thellimin e deficitit korrent, çka ka rezultuar në një rënie të rezervës valutore me rreth 400 milionë euro. Deri në fund të gjysmës së parë të vitit, rezerva valutore shënonte rreth 5,520 milionë euro, dhe ishte e mjaftueshme për mbulimin e 6.4 muaj importesh në mallra dhe shërbime. Detyrimet në formën e investimeve të huaja direkte kanë vijuar të rriten dhe flukset neto – të cilat gjatë periudhës arritën në 620 milionë euro - ishin rreth 9% më të larta në krahasim me një vit më parë. Këto investime ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme, në sektorin e ndërmjetësimit financiar, atë të hidrokarbureve dhe energjetikës dhe atë të komunikacionit. Nga ana tjetër, financimi neto i deficitit korrent nëpërmjet investimeve të portofolit gjatë periudhës kishte kah të kundërt nga ai i gjysmës së parë të vitit të kaluar, gjatë të cilit u emetua eurobondi i qeverisë së përgjithshme. Gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2024, në llogarinë financiare janë regjistruar përkatësisht rritje dhe rënie prej 100 dhe 110 milionë eurosh në mjetet e bankave vendase në formën e letrave me vlerë të investuara jashtë, si edhe një tkurrje me 130 milionë euro e detyrimeve ndaj jorezidentëve në formën e ekspozimit të letrave me vlerë të borxhit, si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes së bankave rezidente në eurobondin e qeverisë së përgjithshme.


**Pozicioni i jashtëm i vendit mbetet debitor dhe vlera e tij u zgjerua kryesisht për shkak të rritjes së detyrimeve neto të sektorit privat.** Në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, mjetet dhe detyrimet financiare të vendit ndaj jorezidentëve ishin përkatësisht 12.4 dhe 22.4 miliardë euro, dhe pozicioni debitor neto u zgjerua me rreth 12% në terma vjetorë<sup>17</sup>. Ky thellim i pozicionit debitor lidhet me rritjen në detyrimet e lidhura me investimet e portofolit dhe ato të lidhura me investimet e huaja direkte. Këto të fundit arritën në 13.7 miliardë euro deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, një nivel ky rreth 21% më i lartë në

<sup>17</sup> Krahasuar me një tremujor më parë, pozicioni i investimeve ndërkombëtare neto regjistron një zgjerim të pozicionit negativ prej rreth 408 milionë euro, ose rreth 4%.




krahasim me një vit më parë. Borxhi i jashtëm i vendit u zgjerua lehtë gjatë tremujorit të parë dhe në fund të periudhës shënonte rreth 10.4 miliardë euro. Peshën kryesore në stokun e borxhit të jashtëm, prej rreth 48%, vijon ta mbajë sektori i qeverisë së përgjithshme me një borxh prej 3.5 miliardë eurosh në formë huaje dhe një borxh prej 1.4 miliardë eurosh në formën e titujve të borxhit. Sektori i korporatave depozituese ka një borxh të jashtëm prej rreth 2 miliardë eurosh, të përfaqësuar kryesisht nga depozitat e jorezidentëve në sistemin financiar vendas, ndërsa borxhi i sektorëve të tjerë dhe borxhi në formën e huave ndërkompani të rrjedhura nga marrëdhëniet e investimit direkt llogaritet në përkatësisht 1.6 dhe 1.7 miliardë euro gjatë tremujorit të parë të vitit.

Grafik 8. Flukset e bilancit të pagesave dhe bilanci korrent




Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Grafik 9. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare sipas sektorëve




Burimi: Banka e Shqipërisë.



### 3. LLOGARITË FINANCIARE DHE POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE


Shqipëria mbetet një vend me pozicion neto debitor ose huamarrës në raport me pjesën tjetër të botës. Detyrimet e vendit ndaj jorezidentëve - në formën e kredisë, borxhit shtetëror, investimeve të huaja direkte dhe depozitave të jorezidentëve në bankat vendase - janë më të mëdha në krahasim me pretendimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve (kredi e dhënë për jorezidentët, investime dhe depozita jashtë etj.). Deri në fund të vitit 2022, ky pozicion llogaritej në rreth 900 miliardë lekë. Pjesën dërrmuese të detyrimeve ndaj jorezidentëve e mban sektori i bizneseve, me një stok detyrimesh prej 1,020 miliardë lekësh, i ndjekur nga sektori i qeverisë së përgjithshme me detyrime që arrijnë në rreth 540 miliardë lekë. Nga ana tjetër, sektori i korporatave financiare paraqitet si huadhënës neto ndaj jorezidentëve me pretendime neto që, deri në fund të vitit 2022, arrinin në 600 miliardë lekë. Financimi midis sektorëve rezidentë mbulohet nga sektori i individëve/ekonomive familjare, i cili financon kryesisht bizneset me kapital dhe sektorin e korporatave financiare me depozita, nga sektori i korporatave financiare që financon bizneset dhe individët me kredi dhe qeverinë e përgjithshme, duke investuar në letra me vlerë, dhe nga sektori i qeverisë së përgjithshme, i cili ka një pretendim të vogël neto në raport me bizneset vendase. Të dhënat e disponueshme për gjysmën e parë të vitit 2024 flasin për rritje të detyrimeve të bizneseve ndaj jorezidentëve, për shkak të rritjes së stokut të investimeve të huaja direkte, një thellim të konsiderueshëm të detyrimeve neto të bizneseve ndaj sektorit financiar në terma të kredive dhe depozitave, dhe një rritje të lehtë të pozicionit kreditor neto të familjeve ndaj sektorit financiar.

Grafik 10. Pozicioni dhe financimi neto midis sektorëve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Pozicioni neto i bizneseve dhe individëve sipas kundërpative



Burimi: Banka e Shqipërisë.



### 3.1 POZICIONI FINANCIAR I BIZNESEVE

Sipas të dhënave të llogarive financiare, pozicioni i bizneseve është debitor dhe ai është thelluar gjatë gjysmës së parë të vitit 2024.

Sipas instrumenteve, ky zhvillim lidhet me rritjen e mëtejshme të detyrimeve në formën e investimeve të huaja direkte dhe të kredisë bankare. Në terma të kundërpartive, bizneset kanë rritur detyrimet neto ndaj korporatave financiare, për shkak të rritjes më të shpejtë të kredisë sesa të depozitave që ata kanë në banka.

Kredia bankare për bizneset, si në Lek, edhe në valutë, është rritur me ritëm të përshpejtuar gjatë periudhës. Kredia në valutë do të shfaqte një rritje më të ndjeshme nëse korrigjohet për efektin pakësues të mbicimitit të kursit të këmbimit.

Norma mesatare e interesit për kreditë e reja të bizneseve u rrit lehtë në krahasim me fundin e gjashtëmuajorit të kaluar.

Kërkesa e bizneseve për kredi u rrit ndjeshëm gjatë gjashtëmuajorit të parë, ndërkohë që kushtet e përgjithshme për miratimin e kredisë nga bankat u lehtësuan disi gjatë tremujorit të dytë të vitit.


Detyrimet më të larta neto të sektorit të bizneseve vijojnë të lidhen me financimin nga sektori i familjeve dhe ai i jorezidentëve, ndërsa forma kryesore e detyrimeve mbetet ajo e kapitalit, e ndjekur nga kreditë nga institucionet financiare. Pjesa dërrmuese e mjeteve financiare të bizneseve përfaqësohet nga llogari të arkëtueshme ose pretendime të bizneseve ndaj bizneseve të tjera dhe ndaj sektorit të qeverisë, ndërsa detyrimet mbizotërohen nga kapitali i investuar në ndërmarrjet vendase nga familjet rezidente dhe nga investitorët e huaj, si edhe nga llogaritë e pagueshme midis ndërmarrjeve. Zgjerimi i pozicionit debitor të bizneseve gjatë 10 viteve të fundit ka ardhur nga rritja e shpejtë e detyrimeve në formën e kapitalit të investuar nga sektori i familjeve dhe ai i jorezidentëve. Këta dy zëra janë rritur me nga 500 dhe 300 miliardë lekë midis viteve 2013-2022 dhe, në fund të vitit 2022, shënonin përkatësisht 1,000 dhe 1,020 miliardë lekë.

Gjatë periudhës, bizneset kanë zgjeruar në mënyrë të ndjeshme pozicionin e tyre debitor ndaj jorezidentëve, si edhe hendekun negativ midis depozitave dhe kredisë bankare<sup>18</sup>. Në raport me sektorin e jorezidentëve, pozicioni neto i bizneseve vendase u thellua me rreth 20% në terma vjetorë deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, duke pasqyruar rritjen në të njëjtën masë në stokun e investimeve të huaja direkte. Pozicioni debitor i bizneseve ndaj sektorit bankar, i matur si diferenca midis depozitave (mjete) dhe kredive (detyrime), deri në fund të gjysmës së parë të vitit, u thellua me rreth 30% në krahasim me nivelin e fundvitit 2023, dhe me 15% ndaj një viti më parë. Kjo ecuri lidhet me faktin që, në krahasim me një vit më parë, depozitat dhe kreditë e bizneseve shënuan rritje pozitive, por rritja nominale e kredisë ishte rreth 2 herë

më e madhe se ajo e depozitave. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, depozitat afatshkurtra të bizneseve u tkurrën me rreth 11 miliardë lekë, ose me 3%, ndërkohë që kredia për bizneset vendase u zgjerua me 30 miliardë lekë, ose me 6%.

**Detyrimet neto të bizneseve vendase ndaj jorezidentëve kanë vijuar të rriten si pasojë e rritjes së shpejtë të stokut të investimeve të huaja direkte.** Këto investime përfaqësojnë pothuajse të gjithë vlerën e detyrimeve neto të bizneseve vendase ndaj jorezidentëve dhe, në fund të tremujorit të parë të vitit, stoku i investimeve të huaja direkte ishte 14 miliardë euro, ndërsa bilanci neto i investimeve direkte<sup>19</sup> ishte 12 miliardë euro. Edhe ecuria e borxhit të jashtëm të bizneseve vendase, në të

Grafik 12. Mjetet (+), detyrimet (-) dhe pozicioni neto i bizneseve sipas instrumenteve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>18</sup> Në mungesë të tablosë së plotë të llogarive financiare për vitin 2023, analiza mbështetet mbi treguesit e sektorit të jashtëm deri në fund të tremujorit të tretë dhe treguesit e aktivitetit bankar deri në fund të muajit dhjetor 2023.


<sup>19</sup> Investime të huaja direkte (detyrime) minus investimet direkte jashtë (mjetet).






cilin nuk përfshihet kapitali i përfshirë në investimin direkt, ka vijuar të ndikohet nga zhvillimet në stokun e huave ndërkompani<sup>20</sup> të lindura nga marrëdhënia e investimit direkt. Në fund të muajit mars 2024, ky borxh arriti në 2.5 miliardë euro, nga të cilat 1.7 miliardë euro ishin detyrime në formën e huave midis kompanive vendase dhe të huaja. Sektori i bizneseve mban rreth ¼ e borxhit të jashtëm të vendit që aktualisht shënon vlerën 10.4 miliardë euro. Rritja e detyrimeve ndërkufitare që kanë formën e investimeve të huaja direkte (investime kapitale) përfaqëson një zhvillim pozitiv për qëndrueshmërinë financiare të bizneseve dhe të vendit. Kjo lidhet me faktet se këto investime kanë natyrë afatgjatë, kanë kosto më të lartë tërheqjeje dhe janë më pak të ndjeshme ndaj goditjeve afatshkurtra me natyrë spekulative në krahasim me investimet e portofolit apo ato në instrumente të tjera financiare. Deri në fund të tremujorit të parë, sektorët me stokun më të madh të investimeve të huaja ishin sektori i energjisë, gazit dhe avullit (3.4 miliardë euro), dhe ai i industrisë nxjerrëse (2.3 miliardë euro). Sektori i aktiviteteve në pasuri të paluajtshme është karakterizuar nga një rritje e shpejtë e investimeve të huaja direkte gjatë viteve të fundit. Në fund të periudhës, këto investime shënonin 1.7 miliardë euro, duke tejkalluar lehtë stokun prej 1.6 miliardë eurosh të investuar nga jorezidentët në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit.

Grafik 13. Mjetet (+), detyrimet (-) dhe pozicioni neto i bizneseve rezidente sipas sektorëve




Grafik 14. Mjetet dhe detyrimet e bizneseve rezidente ndaj sektorit financiar




Diferenca negative midis depozitave dhe kredive të bizneseve rezidente me bankat u thellua ndjeshëm gjatë gjysmës së parë të vitit, si pasojë e zgjerimit shumë më të shpejtë të kredisë në krahasim me depozitat e bizneseve të cilat shënuan tkurrje. Gjatë viteve 2020-2023, depozitat e bizneseve janë zgjeruar më shpejt sesa kredia, dhe kjo ecuri ka rezultuar në ngushtimin me rreth 50 miliardë lekë, ose me mbi 20%, të hendekut depozita-kredi për këtë periudhë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, kjo prirje u zëvendësua nga një rritje e fortë e kredisë, e shoqëruar me tkurrje të depozitave afatshkurtra të bizneseve, e cila rezultoi në një rikthim të hendekut në vlerat e viteve 2018-

<sup>20</sup> Kredi nga ndërmarrja/subjekti nga ka origjinën investimi i huaj direkt.




2019. Raporti kredi/depozita për bizneset ka ardhur duke u përmirësuar, dhe në fund të muajit qershor 2024, ai shënonte 1.7 herë nga 2.3 herë në fund të vitit 2017. Në pretendimet e bizneseve ndaj sektorit bankar dhe sistemit financiar në përgjithësi përfshihen, përveç depozitave, edhe tregues të tjerë si kapitali i investuar nga bizneset në subjektet financiare, pretendimet në formën e borxhit të varur të emetuar nga bankat dhe pjesëmarrja në sipërmarrjet e investimeve kolektive<sup>21</sup>. Nga ana tjetër, detyrimet e bizneseve ndaj subjekteve financiare janë të përafërta në vlerë me kredinë e marrë nga bizneset, pasi vlera e detyrimeve të tjera të ndryshme nga kredia është e papërfillshme. Për këtë arsye, pozicioni neto i sektorit të bizneseve në raport me sektorin financiar (ose diferenca midis mjeteve dhe detyrimeve) është shumë i vogël dhe ka ardhur duke u ngushtuar gjatë viteve 2017-2022. Pra, në tërësi, varësia e bizneseve vendase ndaj sektorit financiar është e kufizuar dhe ka ardhur në rënie. Megjithatë, këto janë të dhëna të agreguara që mbulojnë të gjitha ndërmarrjet dhe të gjitha subjektet financiare vendase, ndërsa pozicioni i bizneseve apo sektorëve të caktuar për ekspozimet ndaj sektorit financiar mund të jetë shumë i ndryshëm nga këto vlera.




Kredia bankare për bizneset rezidente u zgjerua me 6% gjatë periudhës dhe me 11% në krahasim me një vit më parë. Kontributin në këtë rritje e dha si kredia në Lek, ashtu edhe ajo në valutë. Në terma vjetorë, portofoli i kredisë për bizneset në Lek u zgjerua me 17%, ai i kredisë në valutë u rrit me 8%, ndërsa kredia në valutë në monedhë origjinale u zgjerua me 14%. Në zgjerimin e portofolit të kredisë për bizneset ka ndikuar rritja e kredisë për sektorët e transportit, të industrisë përpunuese, të aktiviteteve të pasurive të paluajtshme dhe shërbimeve të akomodimit. Stoku i kredive të biznesit, të klasifikuara sipas qëllimit të përdorimit, dominohet nga kreditë për blerje pasurish të paluajtshme

<sup>21</sup> Fondet e investimit.



me një peshë prej 38%, ndjekur nga kredia kufi me 24%, kredia për blerje pajisjesh me 20% dhe ajo për kapital qarkullues me 15%. Treguesit e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit pasqyrojnë rritje të fortë në kredinë për pasuri të paluajtshme dhe pakësim të kredisë për blerje pajisjesh. Kjo ecuri është ndikuar nga riklasifikimi i një pjese të portofolit të kredisë nga sektori bankar midis këtyre dy kategorive. Ky efekt statistikor do të shfaqet në ndryshimet vjetore të treguesve përkatës të kredisë deri në tremujorin e tretë të vitit 2024.




Norma mesatare e interesit të kredisë së re për sektorin e bizneseve ka shënuar rritje gjatë periudhës dhe kjo rritje është ndikuar nga rritja e normës së interesit për kredinë e re në Lek dhe në Euro. Norma mesatare e përgjithshme për të gjitha kreditë e reja për bizneset në muajin qershor ishte rreth 7% ose disi më e lartë në krahasim me 6 muaj më parë. Normat më të larta të kredisë së re për bizneset janë regjistruar në kreditë me normë të ndryshueshme dhe me periudhë fiksimi të normës së interesit për më shumë se një vit të akorduara në monedhën vendase, të cilat janë luhatur në intervalin 7%-7.5% gjatë gjysmës së parë të vitit. Nga ana tjetër, kreditë e reja në Lek me normë interesi të fiksuar për një periudhë më pak se një vit, kanë shënuar norma midis 6% dhe 6.5%, duke paraqitur një normë më të ulët sesa kreditë e reja në Euro dhe kreditë e tjera në monedhën Lek.

Sipas vërtimit me bankat<sup>22</sup>, kërkesa e bizneseve për kredi është rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë periudhës. Balanca neto e treguesit përkatës paraqet vlerën më të lartë në segmentin e bizneseve të mëdha, në krahasim me bizneset e vogla dhe të mesme, dhe në kredinë për likuiditet në krahasim me kredinë për investime fikse. Pritjet për kërkesën e përgjithshme për kredi nga sektori i biznesit mbeten optimiste për tremujorët e ardhshëm. Standardet e

<sup>22</sup> "Vërtimi i aktivitetit kreditues" i publikuar në: [https://www.bankofalbania.org/Politika\\_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi\\_i\\_aktivitetit\\_kreditues/](https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/)




Grafik 17. Normat e interesit për kredinë e re në Lek dhe në Euro, pa përfshirë kredinë kufi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Kushtet për miratimin e kredisë: (+) lehtësim; (-) shtrëngim



Burimi: Banka e Shqipërisë.

kredisë bankare kanë mbetur pothuajse të pandryshuara gjatë kësaj periudhe. Në kahun e lehtësimit të standardeve kanë ndikuar kostot e lidhura me kapitalin dhe likuiditetin e bankave, ndërsa në kahun shtrëngues kanë ndikuar rreziku i perceptuar nga bankat për industrinë ose ndërmarrjen huamarrëse dhe për kolateralin e kredisë. Pas tre tremujorësh pa ndryshime, kushtet e përgjithshme për miratimin e kredisë u lehtësuan disi gjatë tremujorit të dytë të vitit. Lehtësimi lidhet kryesisht me marzhet mbi kreditë mesatare, ndërkohë që kushtet e tjera, përfshirë madhësinë e kredisë, paraqesin një shtrëngim të lehtë.

### 3.2 PËRBALLUESHMËRIA E BORXHIT DHE PRITJET E BIZNESEVE PËR TË ARDHMEN


Sipas vrojtimit të BSH-së, shumica e bizneseve kanë raportuar fitime gjatë periudhës. Ecuria e shitjeve dhe e rezultatit financiar vlerësohen pozitive, ndonëse në nivele më të ulëta se gjashtëmujorin paraardhës. Pritjet mbeten optimiste, me gjithë problematikat që ekzistojnë, veçanërisht lidhur me rritjen e kostove të financimit dhe kostove të prodhimit e të punës.

Pesha e bizneseve huamarrëse ka shënuar rritje gjatë periudhës. Ngarkesa me borxh, në formën e raportit të huasë ndaj kapitalit, dhe në formën e shërbimit të tij ndaj të ardhurave të ndërmarrjes, vlerësohet në rritje për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm.

Bizneset presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet e qëndrueshme dhe në rritje gjatë gjysmës së dytë 2024.

Sipas vrojtimit "Mbi gjendjen financiare dhe ngarkesën me borxh të ndërmarrjeve", rreth 95% e ndërmarrjeve të vrojtura kanë raportuar fitim gjatë periudhës. Tek këto ndërmarrje ka dominuar grupi i ndërmarrjeve të mesme. Ecuria e shitjeve vlerësohet pozitive gjatë periudhës, veçanërisht në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe bizneseve të ndërtimit dhe shërbimeve, por në rënie krahasuar me periudhën e kaluar. Për gjysmën e dytë të vitit 2024, të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha) presin rritje të mëtejshme të shitjeve dhe të rezultatit financiar, dhe këto pritje janë më optimiste krahasuar me periudhën paraardhëse, por nën vlerat e një viti më parë. Përsa iu përket sfidave të aktivitetit, ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme veçojnë "konkurrencën" dhe "kostot e prodhimit dhe të punës", ndërsa ndërmarrjet e mëdha i lidhin vështirësitë kryesore me "rritjen e kostove të financimit" dhe me "përshtatshmërinë e legjislacionit në fuqi".

Pesha e ndërmarrjeve që kanë hua për të paguar ka rezultuar në rritje. Rreth 37% e ndërmarrjeve deklarojnë se kanë aktualisht hua për të paguar. Kjo peshë është rritur me 1 p.p. krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por ka rënë në po të njëjtën masë ndaj një viti më parë, gjë që është e pritshme




në kushtet e kostove të rritura të financimit në vend. Rreth 87% e ndërmarrjeve e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes, por ndërmarrjet e vogla vijojnë të shfaqin kërkesë më të lartë për financim.

Raporti “hua/kapital” ka shënuar rritje për totalin e ndërmarrjeve të vrojtuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Rreth 81% e ndërmarrjeve raportojnë se vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e kapitalit të ndërmarrjes, 12% deklarojnë se është pothuaj e njëjtë me vlerën e kapitalit dhe 7% deklarojnë që kjo vlerë e tejkalon atë të kapitalit, çka rezulton në një raport mesatar hua/kapital prej 78%. Ky raport është rritur krahasuar me periudhën paraardhëse, veçanërisht për ndërmarrjet e mesme, pasi rreth 21% e tyre shprehen se huaja është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh ka shënuar rritje për të gjitha degët e ekonomisë me përjashtim të sektorit të “shërbimeve”, ku raporti hua/kapital ka mbetur i pandryshuar nga periudha e kaluar. Ky sektor ka edhe vlerën më të lartë të huasë ndaj kapitalit, me 22% të ndërmarrjeve që kanë deklaruar se vlera e huasë është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit.

Tabelë 5. Pësia e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve

	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6M1 2022	21%	21%	25%	22%
6MII 2022	22%	29%	26%	25%
6M1 2023	10%	20%	24%	18%
6MII 2023	15%	15%	18%	15%
6M1 2024	20%	22%	18%	18%

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Rreth 81% e ndërmarrjeve raportojnë se pagesa e huasë nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, dhe kjo peshë ka rënë krahasuar me periudhën e kaluar. Përgjigjet e pjesës tjetër rezultojnë në balancë neto pozitive dhe në rritje, gjë që tregon për rritje të këtij shpenzimi gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Ky



rezultat është konstatuar tek të tre grupet e ndërmarrjeve, por shfaqet më i theksuar tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Rreth 82% e ndërmarrjeve nuk presin ndryshim të kostos së huasë në gjysmën e dytë të vitit 2024, 15% presin rritje të mëtejshme dhe 3% presin që kjo kosto të bjerë. Pritshmëritë për rritje kanë rezultuar më të larta tek ndërmarrjet e mëdha dhe ato të mesme. Kostoja e shërbimit të huasë arrin në 20% të të ardhurave për 76% të ndërmarrjeve, dhe në 20%-50% të të ardhurave për 21% të tyre. Huaja me koston më të lartë në terma të të ardhurave vlerësohet tek ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha.

Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmuajorin e ardhshëm, ndërmarrjet janë përgjigjur se kërkesa për kredi pritet të mbetet në kahun pozitiv dhe disi në rritje, krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar. Kështu, rreth 41% e tyre deklarojnë se “nuk ka asnjë mundësi” që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme, dhe kjo peshë ka rënë për grupin e ndërmarrjeve të mesme e të mëdha, ndërsa ka mbetur e pandryshuar për ato të vogla. Ndërkohë që pesha e atyre që pohojnë në shkallë të ndryshme sigurie (“ka pak mundësi”, “shumë mundësi” apo “është e sigurt”) që të kërkojnë një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2024, ka shënuar rritje, duke sinjalizuar rigjallërim të kërkesës së bizneseve për kredi.

### 3.3 POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE

Duke përjashtuar sektorin e jorezidentëve, sektori i individëve mbetet financuesi kryesor i korporatave financiare dhe bizneseve, dhe forma kryesore e financimit është ajo e kapitalit të investuar në ndërmarrjet vendase dhe e depozitave të vendosura në banka. Deri në fund të vitit 2022, sektori i individëve kishte mjete, detyrime dhe një pozicion neto financiar të barabartë përkatësisht me 2,640, 360 dhe 2,280 miliardë lekë. Mbi 50% e mjeteve financiare të individëve, ose rreth 1,420 miliardë lekë, kanë formën e depozitave dhe pretendimeve të tjera<sup>23</sup> ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare. Stoku i pretendimeve në formën e kapitalit të investuar nga individët në ndërmarrjet vendase deri në fund të vitit 2022 ishte rreth 1,050 miliardë lekë. Në raport me kursimet në formë monedhash dhe depozitash, kreditë e familjeve janë 4.5 herë më të vogla, dhe ky raport ka qenë i qëndrueshëm gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Sektori financiar është njëkohësisht kreditori dhe debitori kryesor i sektorit të familjeve.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, pozicioni neto kreditor i individëve rezidentë ndaj sektorit bankar është zgjeruar me rreth 5 miliardë lekë, në nivelin 947 miliardë lekë. Kjo ecuri ka reflektuar rritjen më të madhe të depozitave në krahasim me rritjen e kredisë. Në fund të muajit qershor, depozitat dhe kreditë e individëve rezidentë në banka shënonin përkatësisht 1,240 miliardë dhe 290 miliardë lekë dhe shtesat përkatëse gjatë periudhës ishin 23 dhe 19 miliardë lekë. Në terma relativë, kredia për individët është

Sektori i individëve përfaqëson sektorin rezident më të rëndësishëm në financimin e korporatave financiare dhe bizneseve, dhe forma kryesore e financimit është ajo e kapitalit të investuar në ndërmarrjet vendase dhe e depozitave në banka.

Pozicioni kreditor i individëve rezidentë ndaj sektorit bankar u zgjerua lehtë gjatë periudhës, për shkak të rritjes më të madhe të depozitave në krahasim me kreditë. Norma e rritjes sëkredisë, si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmuajorë, ishte më e madhe sesa ajo e rritjes së depozitave.

Kërkesa për kredi është mbështetur në nevojën për konsum dhe për blerje pasurish të paluajitshme, kryesisht në monedhën vendase. Normat e interesit të kredisë së re në lekë për individët janë rritur lehtë gjatë periudhës.



Bankat kanë lehtësuar kushtet e përgjithshme të kredisë për individët, duke u fokusuar në madhësinë dhe në maturitetin maksimal të saj. Nga ana tjetër, ato kanë shtrënguar disi standardet e kredisë dhe presin që kjo prirje të vazhdojë për pjesën e mbetur të vitit. Kërkesa nga individët për kredi pritet të mbetet e qëndrueshme.

<sup>23</sup> Për shembull pjesëmarrje në aksionet e fondeve të investimit.



zgjjeruar më shpejt sesa depozitat e individëve, si në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të kaluar, ashtu edhe ndaj një viti më parë. Kursimet e individëve rezidentë në formën e depozitave bankare u rritën me 2% gjatë gjysmës së parë të vitit dhe me 6% ndaj një viti më parë, ndërkohë që ndryshimet përkatëse në stokun e kredisë ishin 7% dhe 12%.


**Depozitat në banka mbizotërojnë në kursimet e individëve dhe rritja e tyre gjatë periudhës ka dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e pozicionit kreditor të individëve.** Rreth 84% e kontributit në zgjerimin e stokut të depozitave të individëve lidhet me depozitat në monedhën Lek. Investimet në titujt e qeverisë në formën e bonove të thesarit kanë shënuar rënie krahasuar me fundin e vitit 2023, ndërkohë që investimet në obligacionet qeveritare, në fondet private të investimit dhe të pensioneve dhanë kontribut pozitiv në zgjerimin e pozicionit financiar të individëve.



**Gjatë periudhës, kredia për individët rezidentë u rrit me ritme më të shpejta në krahasim me dy gjashtëmujorët e mëparshëm, dhe rritja vjetore e kësaj kredie shënoi 12%.** Kontributin kryesor në rritjen vjetore të kësaj kredie e dha zgjerimi me rreth 14% i tepicës së kredisë së marrë nga individët për blerje banesash, ndërkohë që edhe kredia për blerjen e mallrave jo të qëndrueshëm ka regjistruar një rritje të konsiderueshme prej 26% në krahasim me një vit më parë. Struktura e portofolit të kredisë së marrë nga individët rezidentë nuk ka shënuar ndryshime të rëndësishme gjatë viteve të fundit; peshën kryesore, ose rreth 2/3 e këtij portofoli vijojnë ta mbajnë kreditë për blerje banesash, të ndjekura nga kreditë për mallra jo të qëndrueshme dhe ato për mallra të qëndrueshme. Mbiçmimi i kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj monedhës Euro që ka vazhduar edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, ka ndikuar në ngadalësimin e ritmit të rritjes deri në tkurrjen e stokut të kredisë për blerje banesash dhe për konsum në monedhën Euro, dhe në rritjen e fortë të stokut të kredive për banesa dhe për konsum në monedhën Lek. Rritja në stokun e kredive për konsum lidhet me rritjen e fortë të kredisë për mallra jo


të qëndrueshme, ku përfshihen kryesisht kreditë për shërbime dhe mallra që konsumohen për një periudhë më të shkurtër se një vit. Kredia për mallra të qëndrueshme përfaqëson rreth 10% të kredisë së përgjithshme për individët rezidentë dhe në fund të gjysmës së parë të vitit, kjo kredi regjistroi një tkurrje prej rreth 3% ndaj nivelit të një viti më parë.

Grafik 22. Rritja vjetore e kredisë për individët, kontribut në p.p.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 23. Rritja vjetore e kredisë për konsum dhe për pasuri të paluajtshme (PP) për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Në fund të periudhës, norma e peshuar e interesit për kredinë e re për individët<sup>24</sup> u paraqit thajse e pandryshuar krahasuar me normën e regjistruar në fund të vitit 2023, dhe shënonte vlerën 8.4%.** Gjatë periudhës, ajo ka shfaqur prirje për rënie gjatë tremujorit të parë dhe rritje të lehtë gjatë tremujorit të dytë. Normat më të larta të interesit, individët vijojnë t'i paguajnë për kredinë për konsum në Lek, për të cilën në fund të periudhës bankat kanë raportuar një normë prej rreth 9.4%. Nga mesi i vitit 2023, normat e kredisë së re për individët pasqyrojnë një prirje në rritje për kredinë për konsum në Euro dhe një prirje të lehtë rënësë të normës së interesit të kredive për blerjen e pasurive të paluajtshme në monedhën vendase. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, kjo e fundit është luhatur rreth vlerave 4-5% dhe përfaqëson nivelin më të ulët të normave të interesit për kreditë e marra nga individët në bankat vendase.


Gjatë periudhës u vu re një rritje e kërkesës për kredi nga individët, më e theksuar në segmentin e kredisë për financimin e blerjes së pasurive të paluajtshme. Sipas bankave, faktorët që kanë vepruar në kahun frenues të kërkesës së individëve për kredi kanë qenë niveli i përgjithshëm i normave të interesit, përdorimi i burimeve alternative të financimit, besimi konsumator dhe zhvillimet aktuale dhe të pritura në tregun e banesave. Pritjet e bankave për kërkesën e individëve gjatë pjesës së dytë të vitit janë optimiste, dhe ky parashikim vlen për të dyja kategoritë kryesore të kredisë për individët, që janë kredia për konsum dhe kredia për blerjen e pasurive të paluajtshme.

<sup>24</sup> Duke përfshirë kredinë kufi dhe kartat e kreditit.






Grafik 24. Ecuria e kërkesës së individëve për kredi



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 25. Normat e interesit për kredinë e re për individë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Bankat lehtësuan kushtet dhe termat e përgjithshme të kredisë për individët, por paralelisht shtrënguan standardet e saj. Ato kanë rritur shumën maksimale të kredisë apo afatin maksimal të maturimit, por kanë shtrënguar disi kërkesat për kolateral dhe kanë rritur marzhet për kreditë më me rrezik. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë drejtim janë vlerësimet e bankave për ecurinë e tregut të banesave dhe për aftësinë paguese të huamarrësve. Edhe për periudhën në vazhdim, bankat sinjalizojnë shtrëngim të standardeve, veçanërisht në segmentin e kredive për konsum.

### 3.4 PËRBALLUESHMËRIA E BORXHIT DHE PRITJET E INDIVIDËVE PËR TË ARDHMEN

Gjatë periudhës, niveli i huamarrjes së familjeve u paraqit i qëndrueshëm, ndërsa aftësia paguese e tyre është dobësuar lehtësisht. Rezultatet e vërtetimit “Mbi gjendjen financiare dhe ngarkesën me borxh të familjeve”<sup>25</sup> për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, tregojnë që rreth 24% e familjeve kishin të paktën një hua për të paguar në momentin e intervistimit. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe një vit më parë, duke qëndruar nën mesataren historike të treguesit prej 27%. Rreth 74% e familjeve deklarojnë se pagesa e huasë zë “më pak se 30% të të ardhurave mujore”<sup>26</sup> dhe ky tregues ka rënë me 9 p.p. në terma gjashtëmujorë, por ka mbetur rreth 5 p.p. më i lartë se një vit më parë. Të njëjtat ndryshime në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë paraqet edhe pesha e familjeve për të cilat “pagesa e huasë” tejkalon 30% të “të ardhurave”. Kjo ecuri sugjeron që, në krahasim

Rezultatet e vërtetimit tregojnë se peshë e familjeve huamarrëse ka mbetur e qëndrueshme, ndërsa aftësia e tyre paguese ka shfaqur sinjale rënësive gjatë periudhës.


Peshë e familjeve që kanë një hua për të paguar nuk ka ndryshuar në dy gjashtëmujorët e fundit.

Aftësia paguese e familjeve vlerësohet se është dobësuar në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, por paraqitet më e mirë se një vit më parë. Pritjet për aftësinë paguese në gjashtëmujorin e ardhshëm paraqiten më optimiste.

Familjet presin që kërkesa e tyre për kredi të vijë në rënie në pjesën e dytë të vitit 2024.


<sup>25</sup> Vërtetimi është gjashtëmujor dhe për 6M1-2024 është kryer mbi një kampion prej 1200 familjesh, ku shkalla e përgjigjes ka rezultuar 88%. Kampioni i familjeve përzgjidhet, intervistohet dhe rishikohet në mënyrë periodike nga Instituti i Statistikave, në bazë të regjistrave që përdoren nga agjencia për anketat pranë familjeve.

<sup>26</sup> “Deri në 10% të të ardhurave” për 27% të familjeve huamarrëse, “10-30% të të ardhurave” për 47% të familjeve, dhe “mbi 30% të të ardhurave” për 26% të familjeve.




me gjashtëmuajorin e kaluar, ngarkesa e familjeve me borxh është rritur, por në krahasim me një vit më parë situata është më e mirë. Rreth 58% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese “nuk ka ndryshuar” gjatë periudhës, ndërsa pjesa tjetër raportojnë përkeqësim të saj krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar, por duke mbetur mbi nivelin e një viti më parë. Indeksi i pritjeve mbi aftësinë paguese për gjysmën e dytë të vitit 2024 paraqet një prirje të kundërt dhe, ndonëse me vlerë negative, sinjalizon pritje më optimiste të familjeve krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar dhe me një vit më parë.

Grafik 26. Indekset e aftësisë paguese për 6 muajt e kaluar dhe 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 27. Indeksi i planifikimit të huamarrjes dhe shpërndarja e familjeve që planifikojnë hua të re



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Familjet presin një ngadalësim të mëtejshëm të kërkesës së tyre për kredi, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024.** Rreth 60% e atyre që janë përgjigjur kanë deklaruar se “nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm”. Pështja e atyre që deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie<sup>27</sup> mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re, ka rënë me 3 p.p. krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar, dhe me 1 p.p. krahasuar me një vit më parë. Rënia në terma vjetorë e vlerës së indeksit të planifikimit të huamarrjes sugjeron një ngadalësim të pritshëm të kërkesës së individëve për kredi në gjysmën e dytë të vitit 2024.

<sup>27</sup> Alternativat e dhëna janë: “ka pak mundësi”, “ka shumë mundësi” dhe “është e sigurt”.



## 4. TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE

### 4.1 TREGJET E LETRAVE ME VLERË

*Tregu parësor i titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare gjatë periudhës u karakterizua nga rritje e vëllimit të emetimeve, kryesisht atyre afatshkurtra, dhe norma mesatare interesi relativisht të qëndrueshme.* Në këtë treg u emetuan 240 miliardë lekë borxh nga ana e qeverisë, dhe i gjithë emetimi ishte në monedhën vendase. Rreth 60% e emetimeve ishin në tituj të borxhit afatshkurtër që mbizotërohen nga ato me afat 12 muaj. Në emetimet e titujve afatgjatë, peshën kryesore e zënë obligacionet me maturim 2-vjeçar (40% e borxhit afatgjatë). Vlera e emetimeve të periudhës ishte rreth 7% më shumë në krahasim me vëllimin e emetuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, dhe rreth 50% më e lartë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Gjatë periudhës, për herë të parë janë regjistruar blerje të letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare në Lek nga subjekte jorezidente. Në fund të gjysmës së parë të vitit, portofoli i jorezidentëve në Lek ishte rreth 6 miliardë lekë ose sa rreth 1% e borxhit të përgjithshëm të qeverisë në formën e letrave me vlerë të emetuara në monedhën vendase. Norma mesatare e ponderuar e interesit për të gjitha maturitetet e titujve të emetuar në Lek u rrit lehtë me 0.1 p.p. në nivelin 4.2%. Borxhi i marrë nëpërmjet emetimit në tituj afatshkurtër, u dyfishua gjatë periudhës, duke iu afruar vlerës së emetuar në të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë, pas rënies që regjistroi në gjashtëmujorin paraardhës.

*Emetimet në tituj afatshkurtër ishin 140 miliardë lekë ose 66% më shumë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.* Pothuaj e gjithë vlera e emetimit (97%) ishte në tituj me maturim 12 muaj. Në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, vëllimi i emetuar ishte lehtësisht më i ulët. Kërkesa e investitorëve për tituj borxhi me maturim afatshkurtër në rreth 95% të rasteve ka përmbushur nevojat për huamarrje të qeverisë.

*Vëllimi i titujve afatgjatë të emetuar gjatë periudhës ishte rreth 100 miliardë lekë, ose 35% dhe 29% më i lartë në krahasim me dy gjashtëmujorët e kaluar.*

Me përjashtim të titujve me maturitet 10 vjet, për titujt e tjerë afatgjatë u regjistrua rritje e vëllimit të emetuar. Titujt me emetimin më të lartë gjatë periudhës ishin ato me maturim 2 vjet, vëllimi i të cilave u dyfishua në 40 miliardë lekë. Në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë, emetimi për obligacionet 2-vjeçare u rrit me 52%. Vëllimi i emetuar i titujve me maturim 3 dhe 5 vjet ishte rreth 15 dhe 20 miliardë lekë, ose 11% dhe 18% më shumë në krahasim me emetimin në


*Në tregun parësor të titujve të borxhit të qeverisë, vëllimi i emetimeve ishte 50% më i lartë krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, por i krahasueshëm me vëllimin e një viti më parë. Në vëllimin e emetimeve të periudhës, emetimet afatshkurtra u dyfishuan dhe ato zinin rreth 60% të borxhit total.*

*Në linjë me rritjen e normës bazë në nëntor të vitit 2023, normat e interesit shënuan rritje të lehtë për një pjesë të titujve, duke rezultuar në rritje të lehtë të kostos së borxhit të qeverisë.*

*Gjatë periudhës, norma mesatare e ponderuar e interesit për të gjitha maturitetet e titujve të emetuar në Lek u rrit lehtë me 0.1 p.p. duke arritur në nivelin 4.2%. Për titujt afatshkurtër, norma mesatare e interesit u rrit me 0.3 p.p. në nivelin 3.5%, ndërsa për titujt afatgjatë ajo ra me 0.1 p.p. në 5.1%.*

*Oferta e investitorëve ka qenë e lartë dhe në shumicën e rasteve i ka mbuluar nevojat e qeverisë për huamarrje.*

Grafik 28. Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)




Burimi: Banka e Shqipërisë.




gjashtëmuajorin e kaluar dhe me përkatësisht 4% dhe 9% më shumë në krahasim me vëllimin e emetuar një vit më parë. Vëllimi i titujve me maturim 7 vjet ishte rreth 15 miliardë lekë dhe u rrit me rreth 60% në krahasim me dy gjashtëmuajorët e kaluar. Emetimi i obligacioneve 10-vjeçare u përgjysmua në krahasim me gjashtëmuajorin e kaluar, por ishte rreth 20% më i lartë në krahasim me një vit më parë. Titujt me emetim 15 vjet zënë rreth 3% të vëllimit të borxhit afatgjatë dhe gjatë periudhës u dyfishuan në 3.6 miliardë lekë. Vëllimi i obligacioneve 15-vjeçare në krahasim me një vit më parë ishte rreth 7% më i ulët.

Grafik 29. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 30. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.




Norma mesatare e ponderuar e interesit për titujt afatshkurtër për gjashtëmuajorin e parë të vitit është rritur në 3.5%, nga niveli prej 3.2% në gjashtëmuajorin e kaluar. Në krahasim me një vit më parë, norma e interesit ishte rreth 0.6 p.p. më e ulët. Për vetë peshën dominuese, ecuria e normës mesatare të interesit është përcaktuar nga norma e interesit për titujt me maturim 12-mujor. Kjo normë shënonte 3.4% në fillim të vitit dhe ka ardhur në rritje graduale, duke regjistruar nivelin më të lartë prej 3.7% në emetimet e muajve mars, prill dhe maj, për t'u ulur sërish gradualisht, deri sa në muajin qershor regjistroi vlerën më të ulët të gjashtëmuajorit prej 3.3%.

Gjatë periudhës, norma mesatare e ponderuar e interesit për titujt afatgjatë ishte 5.1%, nga mesatarisht 5.2% dy gjashtëmuajorët e mëparshëm. Normat mesatare të interesit për titujt me maturim 2 vjet, 5 vjet dhe 7 vjet shënuan rritje të lehtë me 0.2-0.3 p.p. në nivelet përkatësisht 4.2%, 5.3% dhe 5.8%. Norma mesatare e interesit për titujt me maturim 3 vjet ra me 0.1 p.p. në 4.7%, ndërsa normat mesatare të interesit për titujt me maturim 10 dhe 15 vjet qëndruan pranë niveleve të gjashtëmuajorit të kaluar, duke shënuar përkatësisht 6.6% dhe 7.7%. Kërkesa e pjesëmarrësve për tituj afatgjatë në tregun primar ka përbushur rreth 90% të ofertës, duke qenë më e lartë se e gjashtëmuajorit të mëparshëm, ku u përbush rreth 70% e vëllimit të ofruar.



Vëllimet e tregimit në tregun dytësor të titujve mbeten të ulëta dhe mbizotërohen nga tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare. Transaksionet e titujve mes bankave për portofolin e tyre zënë rreth  $\frac{3}{4}$  e transaksioneve të përgjithshme në këtë treg, ku përfshihen edhe transaksionet mes bankave për klientët e tyre. Tregtimi në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE, vijon të mbetet i ulët dhe i përqendruar në tregtimin e letrave me vlerë të qeverisë. Megjithatë, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit, në ALSE u tregtuan edhe obligacione private, në vlerën 0.06 miliardë lekë, ose sa dyfishi i vlerës së tregtuar në gjashtëmuajorin e kaluar dhe kjo zinte rreth 6% të tregimit në tituj në ALSE. Megjithëse një vlerë e ulët, tregtimi i titujve privatë në bursë, jep një sinjal optimist për zhvillimin e ardhshëm të tregut të kapitaleve, drejt instrumenteve joqeveritare. Me qëllim zhvillimin e tregut të kapitaleve, prej disa vitesh funksionon modeli i zhvilluesve të tregut (*market-makers*), të cilët ofrojnë kuotime ditore të titujve referencë (*benchmark*) me maturitet 3- dhe 5-vjeçar. Kuotimi me bazë ditore i titujve referencë mundëson llogaritjen e kurbës së *yield*-it që shërben si referencë për titujt e tjerë të borxhit në treg dhe mundëson llogaritjen e çmimit të tyre.

Kurba e *yield*-it për titujt referencë paraqitet me pjerrësi normale (me *yield*-e më të ulëta për titujt më afatshkurtër dhe më të larta për titujt më afatgjatë). Në krahasim me fundin e gjashtëmuajorit të kaluar, kurba është zhvendosur për poshtë, si reflektim i normave më të ulëta të kthimit për të gjitha maturitetet. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, kurba e *yield*-it paraqitet disi më e pjerrët. Krahas kërkesës për një normë kthimi më të lartë për maturitetet afatgjata, lëvizjet në kurbën e *yield*-eve mund të reflektojnë edhe strukturën e emetimeve gjatë periudhës.




## 4.2 TREGU NDËRBANKAR I FINANCIMIT

Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve të financimit në tregun ndërbankar shënoi rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së vëllimit të transaksioneve 1-javore.

Interesat e aplikuara nga bankat në tregun e parësë kanë qëndruar pranë normës bazë prej 3.25% gjatë periudhës, duke reflektuar vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Tregu ndërbankar ka regjistruar rritje të vëllimit të transaksioneve dhe norma mesatare të interesit të ankoruara pranë normës bazë të interesit. Vëllimi i transaksioneve u rrit me 60% në krahasim me gjashtëmuajorin e kaluar, por ishte 30% më i ulët në krahasim me të njëjtin gjashtëmuajor një vit më parë. Normat e interesit në tregun ndërbankar vijojnë të luhaten pranë nivelit të normës bazë të interesit. Gjatë gjysmës së parë të vitit, norma bazë e interesit e shpallur nga Banka e Shqipërisë ka qëndruar e pandryshuar në nivelin 3.25%, dhe kjo u reflektua në norma më të larta ndërbankare në krahasim me dy gjashtëmuajorët e kaluar, kur norma bazë e interesit ishte më e ulët<sup>28</sup>.

Grafik 33. Vëllimi i transaksioneve dhe normat e interesit në tregun ndërbankar



Rritja e vëllimit të transaksioneve ndërbankare lidhet me rritjen me rreth 80% në transaksionet 1-javore, të cilat përbëjnë 90% të vëllimit të huamarrjes ndërbankare. Gjatë periudhës, transaksionet 1-javore shënuan rreth 940 miliardë lekë. Në krahasim me një vit më parë, vëllimi i transaksioneve 1-javore ishte 31% më i ulët. Transaksionet 1-ditore të kryera gjatë këtij gjashtëmuajori u rritën lehtë (5%) në nivelin rreth 110 miliardë lekë, por në krahasim me 1 vit më parë vëllimi i tyre u dyfishua. Transaksionet 1-ditore zinin 10% të volumit të përgjithshëm të transaksioneve të kryera gjatë periudhës. Pjesa tjetër e transaksioneve përfaqësohet nga ato 2-ditore, 3-ditore, 2-javore, mujore dhe tremujore, të cilat së bashku zënë rreth 2% të transaksioneve ndërbankare. Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacione të rregullta, duke injektuar likuiditet përmes marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me afat njëjavor, që përfaqësojnë dhe instrumentin e saj kryesor.


## 4.3 TREGU I KËMBIMIT TË MONEDHËS

Kursi i këmbimit të Lekut ka vijuar të mbiçmohet ndaj valutave kryesore, por shpejtësia e mbiçmimit gjatë gjysmës së parë të vitit ishte më e vogël në krahasim me vitin e kaluar.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të zhvillojë ankande për blerjen e Euros, duke i shërbyer objektivit për rritjen e rezervës valutore dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit gjatë muajve të fundit të gjashtëmuajorit.

Në vijim të rritjes së ndjeshme në flukset hyrëse valutore të bilancit të pagesave, gjysma e parë e vitit vijoi të karakterizohej nga mbiçmimi i Lekut ndaj valutave kryesore, por ritmi i mbiçmimit u ngadalësua. Gjatë muajve të parë të vitit, kursi i këmbimit u shfaq relativisht i qëndrueshëm, por presionet mbiçmuese të Lekut që nisën të evidentohen gjatë muajit mars vijuan edhe në muajt në vazhdim, në linjë me sjelljen sezonale të kursit të këmbimit. Në muajin qershor, kursi mesatar i këmbimit të Euros shënoi nivelin më të ulët historik prej 100.4 lekësh për 1 euro dhe kjo vlerë përfaqësoi një mbiçmim të Lekut me gati 4% kundrejt gjashtë muajve më parë. Norma vjetore e mbiçmimit të Lekut zbriti në 6% në fund të qershorit, nga 11% dhe 10% gjashtë muaj dhe një vit më parë. Gjatë 2 muajve të fundit të periudhës, kursi i këmbimit është paraqitur


<sup>28</sup> Gjatë vitit 2023, norma bazë e interesit u rrit në muajt mars dhe nëntor me nga 25 pikë bazë (0.25 pikë përqindjeje).



më i qëndrueshëm, ndikuar edhe nga blerjet e valutës në treg nga Banka e Shqipërisë.

Leku u forcua edhe ndaj Dollarit amerikan, duke reflektuar zhvillimet në tregun e brendshëm dhe ato në tregun ndërkombëtar të këmbimit mes valutave. Në muajin qershor, 1 dollar amerikan këmbëhej me mesatarisht 93.2 lekë, duke pasqyruar një mbiçmim të Lekut me 3% kundrejt gjashtë muajve më parë dhe me 6% në krahasim me një vit më parë. Edhe ndaj USD-së, mbiçmimi i Lekut ishte më i ngadaltë sesa ndryshimi mesatar i regjistruar gjatë vitit 2023.

Grafik 34. Kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### 4.4 TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Analiza e zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme (rezidenciale) kryhet mbi bazën e të dhënave të vrojtimit për gjendjen e tregut të pasurive të paluajtshme dhe ecurinë e çmimit të banesave, të dhënave të raportuara nga bankat dhe të dhënave të tjera administrative.

Tregu i pasurive të paluajtshme rezidenciale ka vijuar të përballet me një **kërkesë të qëndrueshme**. Sipas vrojtimit, agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme raportojnë për ecuri të mirë të vëllimit të shitjeve dhe rënie të numrit të pronave të pashitura. Kërkesa e jorezidentëve ka rezultuar e lartë, duke zënë rreth 27% të blerjeve gjatë periudhës. Po ashtu, bankat raportojnë<sup>29</sup> se kërkesa e individëve për financimin e blerjes së banesave është paraqitur në rritje gjatë periudhës.

Spektori bankar ka vijuar të mbështesë me financim blerjen e pasurive të paluajtshme rezidenciale nga individët. Në fund të gjashtëmujorit, teprica e kredisë për këtë segment shënoi vlerën 180 miliardë lekë, duke u rritur me 7% dhe 13% në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Kushtet dhe termat e kreditimit të bankave për blerjen e banesave shfaqën një shtrëngim të lehtë në formën e normave më të larta të interesit dhe kërkesave më të larta për kolateral. Cilësia e kredisë së marrë për këtë qëllim mbetet e mirë, dhe raporti i kredive me probleme u ul në 1.7%, nga rreth 2% dhe 2.2% një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Në fund të periudhës, stoku i kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme ishte 360 miliardë lekë ose shumë pak më i lartë në krahasim me nivelin e raportuar gjashtë muaj më parë. Rreth 48% e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme mbahet nga sektori i individëve. Stoku i kredisë për pasuri të paluajtshme dhënë biznesit rezident arriti në 170 miliardë lekë në

*Nga vrojtimi i posaçëm i Bankës së Shqipërisë u konstatua që në tregun e pasurive të paluajtshme rezidenciale, kërkesa e përgjithshme mbeti e qëndrueshme.*

*Edhe kërkesa nga jorezidentët ka rezultuar e krahasueshme me periudhën e kaluar.*

*Rritja e kredisë bankare për blerje pasurish të paluajtshme ka mbështetur qëndrueshmërinë e kërkesës. Bankat kanë shtrënguar disi standardet për këtë lloj kredie dhënë individëve.*

*Numri i pronave të pashitura ka rënë.*

*Në tërësi, rritja e ofertës së njërive të banimit, e shprehur në formën e lejeve të reja të ndërtimit, paraqitet disi më e zbutur në krahasim me një vit më parë, por vlerësohet e qëndrueshme në vitet e fundit. Kredia bankare për ndërtim nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës.*

*Kostot e ndërtimit janë rritur, kryesisht për shkak të rritjes në shpenzimet për paga dhe energji.*

*Vrojtimi tregon se Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi u rrit me 16.9% në terma gjashtëmujorë dhe me 8% ndaj një viti më parë. Rritja e vlerës së indeksit për Tiranën ishte edhe më e fortë. Edhe çmimet e qirasë janë rritur. Sipas raportimeve të agjentëve për transaksionet e kryera, pesha e transaksioneve me çmim shitjeje të njëjtë me atë të kërkuar nga shitësi ka rënë.*

*Agjentët ruajnë një vlerësim pozitiv në lidhje me ecurinë e tregut të banesave në periudhën afatshkurtër, dhe mbeten optimistë për ecurinë e tij në një periudhë më afatgjatë.*

<sup>29</sup> Për më shumë detaje konsultoni dokumentin "Vrojtimi i Aktivitetit Kreditives" në adresën [https://www.bankofalbania.org/Politika\\_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi\\_i\\_aktivitetit\\_kreditives/](https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditives/)





fund të periudhës, duke u rritur me 10% krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Në ndryshim nga kredia për sektorin e individëve, 66% e së cilës përbëhet nga kredia në Lek, rreth 60% e kredisë së marrë nga bizneset për blerjen e pasurive të paluajtshme përfaqësohet nga kredia në monedhë të huaj.


**Treguesit e ofertës për ndërtesa banimi sugjerojnë një ngadalësim të rritjes së saj.** Sipas të dhënave të INSTAT, numri i lejeve për ndërtesa banimi gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 ishte 235 nga një mesatare tremujore prej 323 lejesh e raportuar për vitin 2023. Gjithashtu, lejet e ndërtimit të shprehura në sipërfaqe banimi tregojnë një rënie të sipërfaqeve të reja të ndërtimit. Në një afat të mesëm, pesha e sipërfaqes së ndërtesave për banim, dhe ajo e rezidencave të banimit me tre ose më shumë kate, ka mbetur në nivele të larta dhe të qëndrueshme. Kostot e ndërtimit të matura nga Indeksi i Kushtimit në Ndërtim vijuan të rriten. Ndryshimi vjetor në indeksin e përgjithshëm ishte 3.4%, ndërkohë që zërat me rritjen më të lartë ishin shpenzimet për energji (+7.5%), shpenzimet për paga (+4.4%), shpenzimet e transportit (+3.7%) dhe kosto të tjera (+2.7%).

Kredia për sektorin e ndërtimit u rrit me 3.3% gjatë gjashtëmujorit dhe 4.6% ndaj një viti më parë, duke arritur në 75 miliardë lekë në fund të muajit qershor, por vërehet që pesha e kredisë për ndërtim ndaj tepricës së kredisë së bizneseve ka mbetur thuajse e pandryshuar nga periudhat e mëparshme, duke zënë rreth 17% në fund të periudhës.

**Sipas vrojtit, agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme dhe përfaqësues të kompanive të ndërtimit, kanë raportuar çmime shitjeje më të larta në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.** Sipas indeksit Fischer<sup>30</sup>, çmimi mesatar i banesave të shitura gjatë periudhës është rritur me 16.9% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 8% një vit më parë. Indeksi i çmimeve për shitjet në Tiranë regjistroi një rritje



<sup>30</sup> Ky indeks ndërtohet mbi bazën e një vrojtimi specifik. Analiza për këtë vrojtim publikohet e plotë në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë ([www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)).





prej 23.5% ndaj periudhës paraardhëse dhe 11% ndaj nivelit të një viti më parë. Në të njëjtën kohë, vërehet se gjatë periudhës është ulur pesha e transaksioneve ku çmimi i blerjes së pronës për shitjet e kryera është i njëjtë me çmimin e kërkuar nga shitësi. Paralelisht, vërehet se është rritur pesha e transaksioneve të realizuara me një çmim deri në 20% më të ulët se çmimi i kërkuar nga shitësi.

**Çmimet e qirasë sipas agjentëve kanë shënuar rritje gjatë periudhës.** Ky informacion mbi kërkesën dhe çmimet e qirasë vjen kryesisht nga agjentët që kryejnë aktivitet në zonën e kryeqytetit. Sipas tyre, kërkesa e përgjithshme për marrje me qira raportohet më e lartë nga kërkesa gjatë gjatshëmujorit të mëparshëm. Vlerësimet e subjekteve për gjendjen e tregut dhe çmimet në tregun e banesave mbeten përgjithësisht pozitive për afatin e shkurtër dhe afatin më të gjatë.

## HAPËSIRË INFORMUESE 2. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT "TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME" DHE ECURIA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË BANESAVE PËR 6M I-2024

Informacioni mbi ecurinë e çmimeve dhe vlerësimin e situatës nga ana e agjentëve në tregun e pasurive të paluajtshme merret nëpërmjet vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 subjekte, që kanë si aktivitet kryesor tregtimin e pronave të paluajtshme. Subjektet e zgjedhura janë agjentë të zyrave të tregimit të pasurive të paluajtshme dhe shoqëri ndërtimi shitjet e të cilave përfaqësojnë rreth 75%-80% të xhiros së të gjithë popullatës. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar. Krahas informacionit për ecurinë e Indeksit Fischer të çmimit të banesave të shitura në rang vendi, të përmendur më sipër në këtë raport, informacioni nga vrojtimi tregon që:

Vlerësimi i përgjithshëm i agjentëve për situatën e përgjithshme të tregut u raportua si lehtësisht më pozitiv në krahasim me periudhën e kaluar. Në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjatshëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve ishte pozitive, 10%, me përgjigje veçanërisht optimiste për zonën e qyteteve bregdetare, ku vlera e balancës ishte dukshëm më pozitive sesa mesatarja afatgjatë. I njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje rezultoi ndjeshëm më pozitiv gjatë periudhës, me një balancë neto rreth 48%.

Numri i banesave të reja të regjistruara nga agjentët paraqitet i njëjtë me periudhën paraardhëse. Balanca neto e atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të numrit të tyre, ishte pothuajse neutrale. Numri i pronave të pashitura, si për banesa, ashtu edhe për godinat tregtare, ka vijuar të shënojë rënie për disa gjatshëmujorë radhazi.

Koha mesatare e shitjes së banesave në rang vendi ra lehtë në 10.5 muaj nga 10.9 muaj në vrojtimin e mëparshëm. Në rastin e Tiranës, koha mesatare e shitjes u rrit lehtë, në 9.7 nga 8.3 muaj. Koha mesatare për shitjet në zonat bregdetare u ul ndjeshëm në 5.9 nga 10.9 muaj, ndërsa për zonat e tjera kohëzgjatja e shitjes ishte pak më e ulët sesa në gjatshëmujorin e kaluar, duke rënë në 12.9 nga 13.6 muaj.

Financimi nëpërmjet kredisë bankare ka vijuar të figurojë në një pjesë të mirë të shitjeve të pronave. Sipas agjentëve, ashtu si periudhën e kaluar, rreth 53%



e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Nga këto, në 65% të rasteve, kredia ka mbuluar deri në 60% të vlerës.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të viti 2024, rreth 27% të banesave të shitura janë raportuar të blera nga shtetas jorezidentë. Nga këta, rreth 61% rezultojnë shtetas të vendeve të BE-së. Në tërësi, pesha e transaksioneve në të cilat blerësit janë jorezidentë ka rifilluar të rritet pas prirjes rënëse të konstatuar që prej vitit 2020.

Pritjet për të ardhmen paraqiten pozitive. Agjentët kanë pritje pozitive për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër dhe për periudhën më të gjatë (deri në dy vjet).


## 4.5 SISTEMET E PAGESAVE

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase dhe në Euro, ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet.

Gjatë periudhës është regjistruar rritje e vlerës dhe numrit të transaksioneve në sistemet e pagesave. Me rritje të fortë paraqiten edhe pagesat me karta debiti dhe krediti, si edhe transfertat e kreditit në formën joleter. Aktualisht, pagesat me karta zënë peshën kryesore në numrin e përgjithshëm të pagesave të kryera.

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë financiare dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan gjatë periudhës rreth 80 mijë pagesa, me një vlerë prej 7,550 miliardë lekësh. Numri i transaksioneve ka shënuar një rritje prej 14%, ndërsa vlera e tyre u rrit me 3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Paralelisht, në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës janë kleruar 750 mijë pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 136 mijë lekësh. Ndër vite ka vijuar rritja e numrit të transaksioneve dhe rënia e vlerës mesatare për transaksion, e cila tregon edhe një përdorim më të lartë të sistemit AECH nga publiku në tërësi. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar një rritje, si në numër ashtu edhe në vlerë, dhe këto ndryshime ishin përkatësisht 15% dhe 8%.



Grafik 37. Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH në gjashtëmujorin e parë të viteve 2023-2024




Burimi: Banka e Shqipërisë.



Periudha është karakterizuar nga një rritje e ndjeshme e numrit dhe vlerës së pagesave të kryera nëpërmjet sistemit AIPS – EURO. Deri në fund të muajit qershor 2024, në këtë sistem janë shlyer rreth 150 mijë pagesa me një vlerë prej 2,350 milionë eurosh. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, aktiviteti i sistemit AIPS-EURO ka regjistruar një rritje të ndjeshme, si në numër ashtu edhe në vlerë, me përkatësisht 35% dhe 26%. Sistemi AIPS-EURO është një mekanizëm shtesë për Bankën e Shqipërisë që jo vetëm mundëson uljen e kostos së subjekteve që kryejnë transaksione pagesash në Euro, por edhe ndihmon në monitorimin e këtij segmenti të tregut dhe në formalizimin e ekonomisë.




Kartat e debitit dhe të kreditit përfaqësojnë mjetin kryesor të përdorur nga klientët e bankave në kryerjen e pagesave dhe shkalla e përdorimit të tyre ka vijuar të zgjerohet. Gjatë periudhës, për klientët (individë dhe biznese) janë kryer rreth 22.5 milionë pagesa me një vlerë totale prej 3,070 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje të numrit të transaksioneve me 20%, si dhe një rritje në vlerë me 6% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023. Pagesat me karta zënë 64% të numrit total të pagesave. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, numri dhe vlera e pagesave me karta ishin 25% dhe 14% më të larta. Megjithatë, vlera e tyre mbetet ende në nivele më të ulëta krahasuar me vlerën e transaksioneve të transfertave në formë letër dhe joleter. Paralelisht, gjatë periudhës është regjistruar një rritje me rreth 20% e numrit dhe e vlerës së transfertave të kreditit në formë joleter (*internet banking, mobile banking*).



## 5. SISTEMI FINANCIAR

Grafik 40. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, qershor 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, INSTAT.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, pesha e aktiveve të sistemit financiar<sup>31</sup> ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) shënoi një rritje të lehtë me 0.2 p.p., në nivelin 94.2%. Në terma vjetorë, ky tregues u rrit me 2 p.p., dhe kjo lidhet me faktin që norma vjetore e rritjes së bilancit të sistemit financiar ishte më e lartë në krahasim me atë të rritjes së PBB-së. Në këtë rritje, sektori bankar ka kontribuar me pothuaj 1.5 p.p. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të mbizotërojë me gati 90% të totalit të aktiveve. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, ndonëse ka shënuar një rritje të lehtë për periudhën, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe e qëndrueshme. Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht treguesit e ndërlidhjes, në kuadër të vlerësimit periodik të rreziqeve sistemike.

Tabelë 6. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së\* në vite (në %)

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Banka e Shqipërisë			Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare			Ndërmjetësimi financiar
	Sektori bankar	IFJB	SHKK dhe Unioni	Shoqëri sigurimi	Fonde pensioni	Fonde investimi	
2011	86.1	2.6	0.8	1.5	0.0		91.0
2012	89.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	95.4
2013	91.4	2.6	0.7	1.6	0.0	3.7	100.2
2014	92.7	2.8	0.8	1.8	0.0	4.6	102.7
2015	91.9	2.7	0.7	2.0	0.1	4.7	102.0
2016	95.5	2.8	0.6	2.0	0.1	4.5	105.5
2017	93.2	2.9	0.5	2.0	0.1	4.7	103.4
2018	88.8	3.2	0.6	1.9	0.1	4.2	98.8
2019	87.2	3.9	0.6	2.0	0.2	4.0	97.9
2020	97.8	4.2	0.7	2.4	0.2	4.2	107.5
2021	95.5	4.1	0.7	2.2	0.2	4.2	107.0
2022	87.8	3.8	0.7	2.0	0.3	1.9	96.5
2023	84.9	3.8	0.7	2.2	0.3	2.2	94.0
2024	85.0	3.9	0.7	2.2	0.3	2.2	94.2

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, INSTAT.

\*Peshat në tabelë janë llogaritur duke përdorur PBB-në nominale me çmime korrente sipas INSTAT.

<sup>31</sup> Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar. Baza e të dhënave për të gjitha subjektet e sistemit financiar dhe PBB-ja i përkasin tremujorit të parë të vitit 2024, me përjashtim të bankave bilanci i të cilave i referohet tremujorit të dytë të vitit 2024.



## 5.1 SEKTORI BANKAR


### 5.1.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË SEKTORIN BANKAR

Bilanci i sektorit bankar u zgjerua gjatë periudhës dhe rritja vjetore u përshpejtua në krahasim me dy gjashtëmuajt e mëparshëm. Në terma vjetorë, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 7%. Gjatë gjysmës së parë të vitit, vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 36 miliardë lekë (ose 1.8%), duke arritur në rreth 2,000 miliardë lekë në fund të qershorit. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e ka dhënë zgjerimi i aktivitetit kreditues me rreth 52 miliardë lekë dhe i investimeve në tituj me rreth 26 miliardë lekë. Zëri i vetëm që regjistroi rënie gjatë periudhës ishte ai i veprimeve me thesarin dhe ndërbankare, të cilat u pakësuan me 45 miliardë lekë (ose 9%). Ky zë reflektoi kryesisht ecurinë e zërit "marrëdhënie me bankën qendrore", duke evidentuar pakësimin në stokun e llogarive rrjedhëse të bankave në bankën qendrore. Paralelisht, veprimet ndërbankare u shtuan me 18 miliardë lekë (ose 12%), ndikuar nga zgjerimi në nivelin e depozitave me bankat dhe institucionet e tjera financiare, kryesisht jorezidente. Shtimi i fondeve të provigjioneve të sektorit bankar kontriburoi në tkurrjen e aktiveve me rreth 0.6 miliard lekë. Gjatë periudhës, efekti statistikor negativ i mbicimit të Lekut ndaj monedhave të huaja në treguesit e bilancit të sektorit bankar ishte më i zbutur në krahasim me vitin e kaluar.


Bilanci i sektorit bankar u zgjerua gjatë periudhës, dhe në terma vjetorë rritja ishte 7%. Në zgjerimin e aktivitetit të sektorit bankar kontribuuan së bashku, investimet në kredi, ato në tituj dhe veprimet ndërbankare. Efekti statistikor i mbicimit të kursit të këmbimit mbeti negativ për rreth 30 miliardë lekë, por kjo vlerë ka ardhur në rënie gjatë vitit të fundit.

Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit ka shënuar një rënie të lehtë në nivelet 50% dhe 49%, ndërsa pozicioni neto kreditor ndaj jorezidentëve u zgjerua, duke arritur në 19% të aktiveve të bankave. Financimi i veprimtarisë së bankave ka vijuar të mbështetet në depozitat me pakicë dhe fondet e veta.

Grafik 41. Ecuria e aktivitet sipas përbërësve, kontribut në p.p



Grafik 42. Struktura e bilancit të bankave në %




Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit ka shënuar një rënie të lehtë krahasuar me fundin e një viti më parë. Në fund të periudhës, aktivet dhe detyrimet e sektorit bankar në valutë zinin përkatësisht 50% dhe 49% të totalit të bilancit. Në vlerë absolute, bankat raportuan nivele të përafërta të aktiveve dhe detyrimeve në valutë, në vlerat 994 miliardë dhe 976 miliardë lekë, duke paraqitur kështu një pozicion të ekuilibruar të aktivitetit në valutë të sektorit bankar. Nga ana e aktiveve në valutë, zërat me peshën më të madhe janë investimet në kredi dhe ato në titujt e qeverisë. Nga ana e detyrimeve



në valutë, struktura paraqitet më e qëndrueshme në vite dhe mbizotërohet nga depozitat në valutë. Zërat e mësipërm kanë përcaktuar, në masën më të madhe, ndjeshmërinë e kufizuar të sektorit bankar ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit.


Grafik 43. Struktura e aktiveve dhe detyrimeve në valutë, qershor 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma vjetorë, aktivet dhe detyrimet në valutë u rritën me nga 4%, por të korigjuara për efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit, këto norma rritjeje llogariten përkatësisht në 9% dhe 10%. Efekti statistikor i mbiçmimit të kursit të këmbimit të Lekut mbeti negativ, duke e pakësuar me rreth 28 miliardë lekë vlerën e raportuar të bilancit në valutë të sektorit bankar, në krahasim me një vit më parë. Gjatë vitit të fundit, vlera e këtij ndikimi ka ardhur në rënie. Në anën e aktivitetit, forcimi i monedhës vendase ka pasur ndikim më të madh në zërat kryesorë të bilancit si veprimet me titujt, veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare (me rreth 10 miliardë lekë për secilin). Në anën e pasivit, efekti i kursit mbi vlerën e raportuar të depozitave në valutë vlerësohet në rreth 21 miliardë lekë. Efekti pakësues statistikor i kursit të këmbimit është ndjerë edhe për pjesën në valutë të kapitalit të sektorit bankar, me një vlerë rreth 15 miliardë lekë.



Grafik 44 . Efekti i kursit të këmbimit në kundërvlerën në Lek të zërave kryesorë të aktivitetit (majtas) dhe pasivit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Financimi i veprimtarisë së bankave ka vijuar të mbështetet në depozitat me pakicë dhe fondet e veta. Depozitat dhe fondet e veta zënë 92% të totalit të pasivit dhe kjo strukturë ka qenë e qëndrueshme gjatë periudhës. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e ulët e megjithatë për periudhën shënoi rritje, si pasojë e rritjes së detyrimeve të bankave ndaj jorezidentëve. Rritja e detyrimeve me jorezidentët ka ardhur si rezultat i zgjerimit të veprimeve ndërbankare në formën e llogarive rrjedhëse me subjektet jorezidente dhe letrave me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes me institucionet financiare jorezidente. Të dy këta zëra në strukturën e detyrimeve ndaj jorezidentëve zënë një peshë prej përkatësisht 11% dhe 6%. Aktivet e vendosura pranë subjekteve jorezidente u zgjeruan për shkak të rritjes së investimeve ndërbankare në formën e depozitave dhe huave me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare. Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve ishin sa 22% e totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve zinin rreth 3% të totalit të bilancit. Pozicioni kreditor neto ndaj jorezidentëve shënoi rritje ndaj një gjashtëmujori dhe një viti më parë, në terma absolutë dhe relativë.



### 5.1.1.1 Indeksi i shëndetit bankar

Indeksi i shëndetit bankar reflekton një gjendje të mirë të sektorit bankar në fund të periudhës. Indeksi, me një vlerë prej 0.41 njësisish, reflekton një dobësim të notës së përfitueshmërisë, që lidhet me një rritëm relativ më të ulët të rritjes së fitimit të sektorit bankar dhe të treguesve të produktivitetit, në krahasim me periudhën e kaluar. Kjo është një ecuri normale në kushtet e niveleve të larta të fitimit të bankave të realizuara gjatë vitit të kaluar. Në fakt, në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, treguesi i përfitueshmërisë u paraqit me përmirësim të lehtë, ndikuar kryesisht nga rritja e "kthimit nga aktivet" dhe e "marzhit neto nga interesat" Treguesit e eficiencës dhe likuiditetit u dobësuan krahasuar me gjashtë muaj dhe një vit më parë, si rezultat i rritjes



Gjatë periudhës, indeksi i shëndetit bankar tregon një gjendje të mirë financiare të sektorit. Ngadalësimi i ritmeve të fitimit ishte i pritshëm, në kushtet e niveleve të larta të fitimit të realizuar gjatë vitit të kaluar dhe rritjes së shpenzimeve operative. Kjo ecuri u vu re në të gjitha grupet e bankave, por ishte më e dukshme te bankat me kapital të huaj.

Në një horizont më afatgjatë, indeksi tregon përmirësimin e veprimtarisë së sektorit bankar, në terma të cilësisë së aktiveve dhe nivelit të kapitalizimit.




së shpenzimeve të personelit dhe rënies së aktiveve likuide në raport me totalin e aktiveve. Megjithatë, kontributi i këtyre nëntreguesve në shtimin e nivelit të agreguar të rrezikut është më i vogël. Nënindekset e kapitalizimit dhe të cilësisë së aktiveve u shfaqën të qëndrueshëm dhe pa ndryshime të qenësishme.

**Indeksi i shëndetit për grupin e bankave sistemike tregon rritje të lehtë të rrezikut në krahasim me të dy gjashtëmujorët e kaluar.** Ky zhvillim lidhet me ecurinë e nënindekseve të cilësisë së aktiveve, likuiditetit dhe veçanërisht atë të eficiencës, i cili pasqyron rritje më të shpejtë të shpenzimeve në raport me të ardhurat e veprimtarisë.



**Indeksi i shëndetit bankar tregon për një ecuri të përgjithshme më të mirë të bankave me kapital të huaj në krahasim me bankat me kapital shqiptar.** Megjithatë gjatë periudhës, indeksi i shëndetit bankar shfaqti dobësim më të dukshëm për bankat me kapital të huaj në krahasim me ato me kapital vendas. Në krahasim me fundin e vitit 2023, bankat me kapital të huaj paraqitën dobësim të të gjithë treguesve, me përjashtim të cilësisë së aktiveve. Në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, indeksi tregon për situatë të qëndrueshme dhe nuk paraqet ndryshime. Për bankat me kapital vendas vërehet rënie e lehtë e cilësisë së kapitalit, likuiditetit dhe veçanërisht eficiencës, gjatë periudhës. Në krahasim me një vit më parë, indeksi i shëndetit bankar për bankat vendase u përmirësua lehtë, si rezultat i rritjes së përfitueshmërisë dhe cilësisë së aktiveve të bankave.

**Në tërësi, gjatë viteve 2014-2024, indeksi i agreguar i shëndetit bankar flet për përmirësim të shëndetit dhe rritje të qëndrueshmërisë së të gjithë sektorit bankar.** Ky përmirësim lidhet në mënyrë të veçantë me përmirësimin e cilësisë së aktiveve dhe të kapitalit. Në të njëjtën kohë, ndjeshmëria e indeksit ndaj niveleve të përfitueshmërisë është bërë më e rëndësishme që nga tremujori i parë i vitit 2020.







### 5.1.1.2 Kapitalizimi i veprimtarisë

#### MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT


Rritja e aktiveve të peshuara me rrezik të bankave, gjatë periudhës, solli rënien e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin 19.3% nga 19.9% në fund të vitit 2023. Ky tregues për secilën bankë është mbi nivelin minimal të kërkuar prej 12%. Gjatë periudhës, kjo normë ra me 0.7 p.p., ndërsa në terma vjetorë ajo u rrit me 0.3 p.p. Në nivel mesatar, normën më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit e mbajnë bankat me kapital të huaj dhe bankat josistemike. Bankat me kapital shqiptar raportojnë një nivel më të ulët të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, në krahasim me grupet e bankave të tjera, dhe ky nivel gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 ka shënuar rënie.

Në fund të periudhës, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar rezultoi 19.3%. Gjatë periudhës treguesi ra kryesisht për shkak të rritjes së shpejtë të aktiveve të peshuara me rrezik. Në krahasim me një vit më parë, raporti u rrit me 0.3 p.p.




Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, gjatë periudhës, u ndikua pozitivisht nga rritja me 1.3% e kapitalit rregullator dhe negativisht nga rritja me 5% e aktiveve të peshuara me rrezik. Gjatë periudhës, kapitali rregullator i bankave u rrit me rreth 2.5 miliardë lekë, duke u ngjitur në nivelin 195 miliardë lekë. Ecuria e kapitalit rregullator u përcaktua nga rritja e kapitalit të paguar, zgjerimi i fitimit të pashpërndarë si dhe nga zbutja e efektit të diferencave kreditore negative të rivlerësimit. Në terma vjetorë, rritja e kapitalit rregullator ishte më e lartë, e ndikuar kryesisht nga shtimi i kapitalit të paguar dhe rritja e borxhit të varur. Fitimi i pashpërndarë i periudhave të mëparshme ka ndihmuar në rritjen e kapitalit rregullator dhe ky kontribut ka ardhur në rritje.

Në fund të periudhës, aktivet e peshuara me rrezik arritën në 1,010 miliardë lekë, ku kontributin kryesor në rritje e dhanë ato për rrezikun e kredisë, të cilat zënë peshën kryesore në totalin e aktiveve të peshuara me rrezik (me 86%),




ndjekur nga ato për rrezikun e tregut (me 1%) dhe për rrezikun operacional (me 12%). Në raport me totalin e aktiveve, pesha e aktiveve të peshuara me rrezik u rrit në nivelin 51% (nga 49% në fund të vitit 2023), kryesisht si rrjedhojë e rritjes së ekspozimeve me rrezik ndaj shoqërive tregtare (korporatave) dhe ndaj pasurive të paluajtshme të siguruara me kolateral.

Grafik 51. Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit rregullator sipas elementeve përbërëse (në pikë përqindjeje)



Grafik 52. Ecuria e levës financiare, sipas përbërësve




Gjatë periudhës, raporti i levës financiare<sup>32</sup> u rrit me rreth 1 p.p., në nivelin 8.8%. Kjo ecuri erdhi si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të kapitalit të nivelit të parë, krahasuar me rritjen e ekspozimeve totale të llogaritura për efekt të levës financiare. Bankat kanë siguruar një raport të levës financiare mbi nivelin e poshtëm rregullator prej 5.75% në baza individuale. Raporti i levës financiare për sektorin bankar përcaktohet kryesisht nga bankat me rëndësi sistemike. Bankat me kapital të huaj kanë nivelin më të lartë të raportit të levës financiare, gjë që tregon një potencial më të lartë për të financuar vijueshmërinë e aktivitetit. Bankat me kapital shqiptar llogarisin një raport më të ulët të levës financiare krahasuar me grupet e tjera, dhe kjo strukturë financimi kërkon një masë më të lartë të përdorimit të borxhit krahas fondeve të tyre për financimin e veprimtarisë bankare.

### TEPRICA E KAPITALIT DHE PËRMBUSHJA E KËRKESAVE RREGULLATIVE PËR SHITESAT MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT

Në vitin 2023 përfundoi faza tranzitore e zbatimit gradual të kërkesave makroprudenciale të kapitalit, parashikuar në rregulloren nr. 41/2019<sup>33</sup> (më

<sup>32</sup> Në 1 janar 2022 hyri në fuqi rregullorja nr. 63/2020 "Për raportin e levës financiare të bankave" sipas të cilës raporti i levës financiare llogaritet si raport i kapitalit të nivelit të parë të bankës me ekspozimin total të bankës në datën e raportimit.

<sup>33</sup> Rregullorja nr. 41, datë 5.6.2019, "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit".



tej, "rregullorja"). Sipas rregullores, shtesa konservuese e kapitalit u rrit nga 2% në 2.5%, gjatë periudhës. Shtesat makroprudenciale të kapitalit kanë për qëllim përmirësimin e rezistencës së bankave ndaj rreziqeve sistemike, me natyrë ciklike dhe strukturore. Për këtë qëllim, bankat ndërtojnë rezerva kapitali për të përthithur humbjet e mundshme, dhe këto rezerva krijojnë hapësirë për mbështetjen e ekonomisë reale me financim në kohë më të vështira. Në përputhje me rregulloren, bankat janë subjekt i shtesës konservuese të kapitalit (Kons), shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC), shtesës për bankat me rëndësi sistemike (SIST) dhe shtesës për rrezikun sistemik (Struk). Shtesa konservuese e kapitalit për vitin 2024 është 2.5% për të gjitha bankat e sektorit, ndërsa shtesa për bankat sistemike lëviz aktualisht midis vlerave 0.5% - 1.5%, në varësi të rëndësisë sistemike të bankës. Shtesa kundërciklike e kapitalit ishte që prej fillimit të zbatimit të saj në nivelin 0%. Mbështetur në nevojën për të vepruar në mënyrë kundërciklike dhe rritur rezervat, në kushtet e rritjes së shpejtë të kredisë, me vendimin nr. 2852, datë 28.6.2024, Banka e Shqipërisë vendosi për herë të parë rritjen e normës së KUNC në 0.25%. Përbushja e nivelit të KUNC do të raportohet për herë të parë nga bankat në fund të tremujorit të dytë të vitit 2025. Deri në kohën e përgatitjes së këtij raporti, Banka e Shqipërisë nuk ka shpallur shtesë për rrezikun sistemik (STRUK).

*Aktualisht, bankave u kërkohet të përbushin disa kërkesa për nivelet e kapitalit, ku përfshihen shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe ato për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar (MREL).*

*Me qëllim forcimin e pozitive të kapitalit, gjatë periudhës, bankat kanë injektuar kapital, kanë rritur fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur.*

*Sektori bankar në tërësi arriti t'i përbushte kërkesat rregullative për kapital në gjysmën e parë të vitit 2024, sipas kalendarit të përcaktuar, dhe të regjistronte një tepricë kapitali pozitive.*

**Bankat që janë subjekt i kërkesave për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL)<sup>34</sup> kanë vijuar me plotësimin e kërkesave shtesë sipas kalendarit të miratuar.** Kundrejt një viti më parë, shtesa e MREL-it ishte 1.5-1.7 p.p. Këto banka mund ta përbushin shtesën duke rritur kapitalin dhe/ose duke emetuar tituj të borxhit që shërbejnë si detyrime të pranuar. Në varësi të shkallës së përbushjes së kërkesës me emetime të titujve të borxhit si detyrime të pranuar, mundësohet edhe përbushja e njëkohshme e shtesave makroprudenciale të kapitalit. Në tërësi, duke marrë në konsideratë shtesat e mësipërme, si dhe shtesat e tjera të kapitalit në kuadër të procesit mbikëqyrës, të kërkuara për disa banka të sektorit, kufiri i raportit të kërkuar të mjaftueshmërisë së kapitalit lëviz në intervalin 18%-21% për bankat me rëndësi sistemike dhe 15%-18% për bankat e tjera.


**Në fund të periudhës, në tërësi, sektori bankar rezultonte me tepricë pozitive të kapitalit, të mjaftueshme për përbushjen e kërkesave përkatëse rregullative.** Ecuria e tepricës së kapitalit diktohet nga ecuria e fitimit të bankave, sjellja e elementeve të kapitalit rregullator, dhe kërkesat rregullatore që duhet të përbushen (shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe kërkesat e MREL). Në fund të periudhës, teprica e kapitalit mbeti e qëndrueshme në nivelin 46 miliardë lekë (aq sa në fund të vitit 2023), por në krahasim me një vit më parë, ajo u tkurr me rreth 5 miliardë lekë. Ecuria e kapitalit të disponueshëm u

<sup>34</sup> Aktualisht, 5 banka të sektorit janë subjekt i plotësimit të "kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar" (MREL), në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregulloren nr. 78, datë 16.12.2020, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Banka ka detyrimin të plotësojë sipas radhës kërkesat minimale për kapitalin rregullator, kërkesën minimale për MREL dhe shtesat makroprudenciale të kapitalit.




përcaktua nga performanca e treguesve përbërës të kapitalit rregullator<sup>35</sup>. Me qëllim forcimin e vazhdueshëm të pozitive të kapitalit, bankat kanë injektuar kapital, kanë rritur fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur. Bankat me rëndësi sistemike përcaktojnë ecurinë e tepricës së kapitalit të sektorit bankar, pasi ato zotërojnë më shumë kapital në krahasim me bankat e tjera. Në fund të periudhës, teprica e kapitalit për këto banka shënonte 18 miliardë lekë, ose rreth 1 miliardë lekë më shumë se teprica e një gjashtëmujori më parë, dhe zinte 3% të aktiveve të peshuara me rrezik. Bankat e tjera kanë një tepricë kapitali më të lartë sesa bankat sistemike si rezultat i nivelit më të ulët të kërkesave rregullative për t'u përmbushur prej tyre. Në qershor 2024, kjo tepricë ishte rreth 28 miliardë lekë, pa ndryshim nga vlera e dhjetorit 2023 dhe rreth 2 miliardë lekë më shumë se teprica e kapitalit të një viti më parë.

Grafik 53. Teprica e kapitalit për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 54. Struktura e shtesave rregullatore të kapitalit, qershor 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Fitimi i sektorit bankar në fund të muajit qershor ishte pozitiv për 18.6 miliardë lekë dhe ky rezultat ishte rreth 26% më i lartë në krahasim me një vit më parë.

Në këtë ecuri, ndikimin kryesor pozitiv e dhanë të ardhurat neto nga interesat, por rritje kanë shënuar edhe të ardhurat jo nga interesat, që kanë reflektuar një performancë më të mirë të investimeve në instrumentet financiare dhe të ardhura më të larta nga komisionet.


Paralelisht me rritjen e të ardhurave, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve paraqet rritje të shpenzimeve të veprimtarisë dhe rritje të lehtë të shpenzimeve për provigjionet.

Përmirësimi i rezultatit financiar është reflektuar në një shpërndarje më të mirë të vlerave të Kthimit nga Aktivët midis bankave.

### 5.1.1.3 Rezultati financiar

Rezultati neto dhe treguesit e përfitueshmërisë së sektorit bankar kanë shënuar rritje në krahasim me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes në të ardhurat neto nga interesat. Fitimi i sektorit bankar në fund të muajit qershor ishte pozitiv për 18.6 miliardë lekë dhe ky rezultat ishte rreth 26% më i lartë në krahasim me një vit më parë. Rritja e fitimit është pasqyruar në tregues më të lartë mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar, ku kthimi nga aktivet (RoA) rezultoi 1.9% dhe kthimi nga kapitali (RoE) 18.5%, kundrejt përkatësisht 1.6% dhe 15.6% një vit më parë. Sektori bankar ka regjistruar rritje të konsiderueshme në të ardhurat neto nga interesat. Por një ecuri të mirë treguan edhe të ardhurat nga veprimtaritë e tjera, kryesisht si rrjedhojë e kthimit të humbjeve nga instrumentet financiare në vlera pozitive. Të ardhurat nga

<sup>35</sup> Ecuria e kapitalit rregullator në qershor 2024, u përcaktua nga rritja e kapitalit të paguar dhe zgjerimi i fitimeve të pashpërndara.



komisionet vijojnë të jenë një burim i rëndësishëm të ardhurash për sektorin bankar dhe kanë regjistruar rritje gjatë periudhës. Shpenzimet e veprimtarisë dhe shpenzimet neto për provigjione kanë shënuar rritje, por kjo rritje ishte më e vogël sesa rritja në të ardhurat.

Të ardhurat neto nga interesat, u rritën me 4.2 miliardë lekë kundrejt një viti më parë, duke u ngjitur në nivelin 37.4 miliardë lekë. Ky rezultat reflekton rritjen shumë më të shpejtë të të ardhurave nga interesat (me rreth 7 miliardë lekë, në nivelin 46.5 miliardë lekë) kundrejt shpenzimeve për interesa që u shtuan me rreth 3 miliardë lekë. Rreth 85% e kontributit në rritjen e rezultatit neto nga interesat lidhet me aktivitetin në monedhën vendase. Shtimi i të ardhurave nga interesi u pasqyrua edhe në rritjen e marzhit neto nga interesat në 4.4% nga 4.2% një vit më parë. Të ardhurat jo nga interesat të arkëtuara nga bankat gjatë periudhës u rritën me 3.1 miliardë lekë, në nivelin 10.7 miliardë lekë. Në këtë rritje kontribuuan fitimi nga instrumentet financiare, me rreth 2 miliardë lekë dhe të ardhurat nga komisionet me 1 miliardë lekë.


Tabelë 7. Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për qershor 2023-2024 (mld lekë)

	Qershor 2024			Qershor 2023
	Në lekë	Në valutë	Total	Total
<b>Të ardhura nga interesat</b>	25.6	20.9	46.5	39.5
<b>Shpenzime për interesat</b>	5.7	3.5	9.1	6.3
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>	20.0	17.4	37.4	33.2
<b>Të ardhura jo nga interesat</b>	6.2	3.9	10.7	7.6
<i>gjaba dhe komisione</i>	4.7	3.8	8.6	7.7
<i>humbje ose fitim nga instrumentet financiare</i>	1.0	0.0	1.0	-0.9
<b>Shpenzime jo për interesa</b>	18.8	4.9	23.8	21.4
<b>Provigjione (neto)</b>	2.2	0.4	2.6	2.1
<i>për kreditë</i>	2.3	0.5	2.8	2.9
<i>për mjete të tjera financiare</i>	-0.1	-0.1	-0.2	-0.8
<b>Zëra të jashtëzakonshëm</b>	-0.4	-0.1	-0.5	-0.1
<b>Taksa mbi të ardhurat</b>	3.1	0.0	3.1	2.5
<b>Rezultati neto</b>	2.5	16.1	18.6	14.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Niveli i mbulimit të kostove të veprimtarisë nga të ardhurat e bankave është përmirësuar, pasi rritja në shpenzimet e veprimtarisë ishte shumë më e vogël në krahasim me rritjen e të ardhurave. Në krahasim me vitin e kaluar, shpenzimet e veprimtarisë u rritën me 2.4 miliardë lekë, në rreth 23.8 miliardë lekë. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave u ul ndjeshëm gjatë periudhës, në 49% nga 53% në fund të vitit 2023. Shpenzimet për provigjione për kredi gjatë gjashtëmujorit të parë 2024 u raportuan thajse të pandryshuara kundrejt një viti më parë, në rreth 2.8 miliardë lekë. Në të njëjtën kohë, sektori bankar vazhdoi të raportojë rimarrje të shpenzimeve për

Grafik 55. Përbërësit e rezultatit financiar





Burimi: Banka e Shqipërisë.



provigjionimin e mjeteve të tjera financiare, por në një masë më të vogël se vitin e kaluar. Në përfundim, shpenzimet totale për provigjione u rritën lehtë me 0.4 miliardë lekë, duke arritur në 2.6 miliardë lekë në fund të kësaj periudhe.

Përmirësimi i rezultatit financiar është reflektuar në një shpërndarje më të mirë të vlerave të Kthimit nga Aktivet (RoA). Aktualisht, bankat që kanë një RoA midis 2% dhe 3%, zotërojnë 40% të aktiveve të sektorit bankar (nga rreth 16% në të njëjtat periudha në vitet 2018-2023), ato me një RoA midis 1% dhe 2% zënë një peshë prej 40% të sektorit bankar, dhe ato që kanë një RoA midis 0% dhe 1% zënë 20% të aktiveve të sektorit bankar.



Kredia bankare ka shënuar rritje të ndjeshme gjatë periudhës. Në terma vjetorë, kredia u zgjerua me 11.1%, ndërsa në krahasim me fundin e vitit 2023, ajo u rrit me 7.1%.

Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht rritja e fortë e kredisë në Lek, rritja e kredisë afatgjatë dhe rritja e kredisë për bizneset. Edhe kredia për jorezidentët u rrit gjatë periudhës, por mbeti pranë niveleve të një viti më parë. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e kredisë rezulton 14%.


Ristrukturimet e kredive dhe largimet nga bilanci të kredive të humbura kanë vijuar gjatë periudhës. Vëllimet e ristrukturimeve janë pakësuar, ndërsa ato të fshirjeve ishin të krahasueshme me periudhën e kaluar.

### 5.1.1.4 Kredia

Stoku i kredisë<sup>36</sup> së dhënë nga bankat është zgjeruar me ritme të shpejta, gjatë periudhës dhe në terma vjetorë. Teprica e kredisë në bilancin e sektorit bankar arriti në 792 miliardë lekë në fund të periudhës, duke qenë përkatësisht 7.1% dhe 11.1% më e lartë se gjashtë muaj dhe një vit më parë. Ndikimin kryesor në zgjerimin e stokut të kredisë gjatë periudhës e ka dhënë shtesa e kredisë së re, cila ishte rreth 30% më e madhe në krahasim me kredinë e re të regjistruar për të njëjtën periudhë një vit më parë. Rritja e kredisë është regjistruar për të gjitha subjektet, maturitetet dhe monedhat, por kontributin më të madh gjatë periudhës e ka dhënë kredia e akorduar në monedhën vendase (me 5 p.p.), kredia për bizneset (4.1 p.p.) dhe kredia afatgjatë (4 p.p.).

Rritja e tepricës së kredisë është mbështetur në një masë të madhe nga ecuria e portofolit të kredisë në Lek. Kredia në Lek është zgjeruar me ritme


<sup>36</sup> Ky përkufizim përfshin të gjitha kreditë e dhëna nga bankat vendase për subjekte rezidente dhe jorezidente.



veçanërisht të shpejta dhe ndryshimi vjetor në qershor 2024 arriti në 19%. Rritja vjetore e kredisë në valutë rezultoi 2.7%, por duke përjashtuar efektin statistikor të kursit të këmbimit, i cili ishte negativ për rreth 19 miliardë lekë, rritja vjetore e kredisë në valutë do të ishte 8.1%, ndërsa rritja e tepricës së kredisë do të ishte 13.7%. Në terma vjetorë, kredia për individët u zgjerua me 12.5%, ndërsa ajo për bizneset u rrit me 10.7%, por kontributi i kredisë dhënë bizneseve në rritjen e kredisë së përgjithshme është më i madh dhe ky kontribut është rreth 2 herë më i lartë se vlera e regjistruar në fund të gjashtëmuajorit të kaluar.


**Vëllimi i kredive të ristrukturuara ishte më i ulët, ndërsa fshirjet e kredive të humbura ishin në vlera të krahasueshme me periudhën e kaluar.** Kredia e ristrukturuar gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2024 ishte rreth 2 miliardë lekë ose sa 1% e fluksit të kredisë së re të periudhës dhe sa 5.2% e stokut të kredive me probleme. Portofolet e prekura nga ristrukturimi i kredisë lidhen kryesisht me kreditë në Lek dhe valutë për sektorin e biznesit. Forma kryesore e ristrukturimit e kërkuar nga klientët dhe e miratuar nga bankat ishte zgjatja e afatit të maturimit. Fluksi vjetor i kredisë së ristrukturuar është zvogëluar gjatë viteve të fundit. Kështu, vlera e kredisë së ristrukturuar gjatë gjashtëmuajorit të parë 2024 është sa 35% e vlerës së kredisë së ristrukturuar në të njëjtin gjashtëmuajor të vitit 2021. Procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilanci të bankave ka vijuar edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 dhe vlera e kredive të fshira nga bilanci ishte rreth 1.4 miliardë lekë. Gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit janë fshirë rreth 3 miliardë lekë kredi të humbura dhe rreth 63% e këtij vëllimi lidhet me kredi të marra nga bizneset. Vlera e kredive të fshira në periudhën e fundit ishte sa 4% e tepricës së përgjithshme të kredive me probleme në portofolin e bankave, dhe kjo vlerë ishte e njëjtë me vlerën relative të fshirjeve gjatë gjashtëmuajorit të kaluar.

Grafik 58. Rritja vjetore e kredisë sipas valutës




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 59. Ndryshimi në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse



Burimi: Banka e Shqipërisë.



## KREDIA PËR SUBJEKTET JOREZIDENTE

Kredia për jorezidentët u rrit gjatë periudhës, por pesha e saj ndaj kredisë së përgjithshme të sektorit bankar mbetet e ulët. Stoku i kredisë për subjektet jorezidente u rrit me rreth 18% gjatë periudhës, por ishte pothuajse i njëjtë me nivelin e raportuar nga bankat një vit më parë. Në fund të periudhës, kredia për jorezidentët ishte rreth 34 miliardë lekë ose sa 4% e tepricës së kredisë së sektorit bankar.

## KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

Teprica e kredisë së pambrojtur në valutë ka shënuar rënie si në terma gjashtëmujorë, ashtu edhe në krahasim me një vit më parë. Rënia vërehet në vlerë absolute dhe relative, por e korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, kjo kredi do të shënonte rritje gjatë periudhës.

Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë rënia në kredinë e pambrojtur në valutë për individët. Kredia e pambrojtur në valutë për bizneset nuk ka ndryshuar gjatë periudhës. Cilësia e kësaj kredie mbetet mjaft e mirë.

Në tërësi, kjo ecuri përfaqëson një zhvillim pozitiv si në drejtim të mbrojtjes së huamarrësve, ashtu edhe në drejtim të qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Kredia e pambrojtur në valutë e shprehur në Lek është tkurrur lehtë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, si rezultat i efektit të kursit të këmbimit.

Gjatë periudhës, stoku i kredisë së pambrojtur në valutë ra me më pak se 1 miliard lekë ose me 1%, ndërsa rënia në terma vjetorë ishte 5.7%. Nëse korrigjohet për efektin e kursit të këmbimit, kredia e pambrojtur në valutë do të tregonte një rritje prej 2.1% gjatë periudhës. Pesha e kredisë së pambrojtur ndaj tepricës së kredisë në valutë ra në nivelin 24%, nga 26% gjashtëmujorin e kaluar, si pasojë e efektit të kombinuar të rënies së stokut të kredisë së pambrojtur dhe të rritjes së stokut të kredisë në valutë. Në raport me tepricën e përgjithshme të kredisë, kjo peshë ka rënë në nivelin 11% nga 12% gjashtë muaj më parë. Rënia absolute dhe relative e kredisë së pambrojtur në valutë tregon një rënie të ekspozimit të sektorit bankar ndaj efektit të tërthortë të kursit të këmbimit, dhe përfaqëson një zhvillim pozitiv si në drejtim të mbrojtjes së huamarrësve, ashtu edhe në drejtim të qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Rënia vjetore në tepricën e kredisë së pambrojtur në valutë lidhet tërësisht me kredinë akorduar individëve, e cila u tkurr me 11.4%. Pjesa kryesore e tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë përbëhet nga kredia në Euro (mbi 90%) dhe stoku i këtij portofoli nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Gjysma e stokut të kredisë së pambrojtur zihet nga kredia për bizneset, e cila gjatë periudhës nuk tregoi ndryshime. Sipas sektorëve të ekonomisë, peshën kryesore në këtë kredi e zë "pasuria e paluajtshme" me rreth 60%, e ndjekur nga "tregtia" me 15%.

Kredia e pambrojtur për individët e akorduar për blerje pasurish të paluajtshme vazhdon të përbëjë rreth 60% të tepricës së kredisë së pambrojtur, të dhënë për blerje dhe zhvillim të pasurive të paluajtshme. Teprica e përgjithshme e kredisë së dhënë për këtë qëllim ra lehtë, me rreth 2% gjatë periudhës, dhe rënia erdhi nga tkurrja e kredisë për sektorin e individëve. Raporti i kredive me probleme për kreditë e pambrojtura nga kursi i këmbimit ishte 4.3% në fund të vitit, duke qenë i krahasueshëm me raportin e përgjithshëm të kredive me probleme. I njëjti raport vetëm për kreditë për pasuri të paluajtshme shënonte 3.3%.





## KREDIA E RE

Kredia e re e dhënë nga bankat gjatë periudhës ishte rreth 182 miliardë lekë, e krahasueshme me periudhën e kaluar, por rreth 30% më shumë se një vit më parë. Krahasuar me fluksin e gjysmës së dytë të vitit 2023, rritja ishte rreth 2%, duke treguar që rritja ka qenë e qëndrueshme gjatë 12 muajve të fundit. Sipas raportimeve të bankave, numri i aplikimeve për kredi u rrit gjatë periudhës, si nga ndërmarrjet ashtu edhe nga individët. Paralelisht me të u rrit edhe numri i refuzimeve nga ana e bankave. Kjo rritje e refuzimeve u drejtua pothuaj tërësisht drejt individëve, dhe ishte e përqendruar kryesisht tek bankat me kapital të huaj.

*Kredia e re e dhënë gjatë periudhës u rrit lehtë në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, por ishte ndjeshëm më e lartë se ajo e një viti më parë. Në terma vjetorë, kjo ecuri lidhet me një performancë më të mirë të kredisë në Lek, ndërsa fluksi i kredisë në Euro është rritur shumë lehtë.*


Në terma vjetorë, kredia për sektorin e bizneseve kontribuoi me rreth 83% të vlerës së fluksit të kredisë së re. Gjatë periudhës, kjo kredi ishte rreth 130 miliardë lekë, rreth 3 miliardë lekë më pak se në gjashtëmujorin e mëparshëm dhe 36 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë një vit më parë. Mbi 60% e kredisë së marrë nga bizneset ka formën e kredisë – kufi dhe për kapital qarkullues, ndërsa pjesa tjetër e kredisë së re ka shkuar për blerje pajisjesh dhe pasurish të paluajtshme. Sipas monedhës, rritja në fluksin e kredisë së re lidhet thuhajse tërësisht me kreditë e reja në Lek, ndërkohë që fluksi i kredisë së re në Euro dhe USD, i shprehur në Lek, tregon rritje shumë të lehta në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor një vit më parë. Në krahasim me gjysmën e dytë të vitit të kaluar, kredia e re në Lek ishte disi më e vogël, ndërsa ajo në monedhat Euro dhe USD e shprehur në monedhën vendase regjistroi një fluks më të lartë.

*Në rritjen e lehtë të kredisë së re gjatë periudhës, kontributin e vetëm pozitiv e ka dhënë kredia për individët. Kjo kredi ka shkuar kryesisht për blerjen e pasurive të paluajtshme.*

*Norma e peshuar e interesit për të gjitha kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës mbeti pothuajse e pandryshuar, në 6.5%. Normat e interesit për kreditë e reja në Lek shfaqen disi më të larta se ato në Euro, ndërkohë që të dyja kanë treguar shumë pak luhajtje në periudhat e fundit.*

Në terma gjashtëmujorë, rritja e fluksit të kredisë së re gjatë periudhës lidhet tërësisht me kredinë e akorduar sektorit të individëve. Kjo kredi u rrit me 13.5% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe 16% ndaj një viti më parë. Rritja vjetore ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së fluksit të kredisë së re të marrë nga individët për blerje pasurish të paluajtshme. Mesatarisht, kjo lloj kredie përfaqëson rreth 52% të fluksit të përgjithshëm të kredisë së re për individët.


Grafik 60. Kredia e re për bizneset dhe individët sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Grafik 61. Ecuria e normave të interesit të kredisë së re




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e peshuar e interesit për të gjitha kreditë e reja të akorduara gjatë periudhës mbeti e pandryshuar në 6.5%. Vlera mesatare e periudhës për normën për kreditë në monedhën vendase arriti në 6.7%, duke shënuar një rritje shumë të lehtë ndaj periudhës së kaluar. Norma e interesit për kreditë e reja në Lek filloi të rritej kryesisht gjatë tremujorit të dytë të vitit. Norma e interesit për kreditë e reja të akorduara në Euro mbeti thuajse e pandryshuar në 6.3%. Në tërësi, normat e kredive të reja të akorduara në monedhën vendase dhe në Euro shfaqin rritje të lehta nga viti 2022 dhe kanë treguar luhatshmëri të ulët që nga kjo periudhë.

### HAPËSIRË INFORMUESE 3. ECURIA E NUMRIT TË APLIKIMEVE PËR KREDI DHE ANALIZA E NORMËS SË REFUZIMIT NGA BANKAT NË VEND PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2024


Gjatë gjashtëmujorit të parë 2024 (periudha 1 janar - 30 qershor 2024), bankat raportojnë se kanë marrë në shqyrtim gjithsej 72,418 aplikime për kredi, nga të cilat 10% i përkasin “ndërmarrjeve” (5.7% ose 4,093 aplikime nga “ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” dhe 3.6% ose 2,596 aplikime nga “ndërmarrje të tjera”) dhe 91% (ose 65,729 aplikime) i përkasin sektorit të “individëve”. Kjo shpërndarje ka shënuar një zhvendosje të lehtë në favor të ndërmarrjeve, si krahasuar me periudhën e kaluar, ashtu edhe krahasuar me një vit më parë.

Grafik 62. Ecuria e numrit të aplikimeve të marra në shqyrtim dhe norma e refuzimit të kredive



Burimi: Banka e Shqipërisë.






Numri total i aplikimeve për kredi të shqyrtuara nga bankat u rrit me 7.5% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 11.4% krahasuar me një vit më parë. Në të dyja periudhat, rritja ka ardhur nga të tre segmentet e klientelës, por ka qenë më e dukshme në grupin e “ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” (rritje respektivisht 29% dhe 37%) dhe në sektorin e “individëve” (rritje respektivisht me 6.4% dhe 10.4%).

Në totalin e aplikimeve të marra në shqyrtim gjatë periudhës, rezultojnë se rreth 25% e tyre janë refuzuar nga bankat. Kjo normë ka shënuar rritje, duke rezultuar 4.3 pikë përqindjeje më e lartë se gjashtë muaj më parë, dhe 2.7 pikë përqindjeje më e lartë se një vit më parë. Rritja e refuzimeve të bankave në gjysmën e parë të vitit 2024 ka qenë vetëm kundrejt kategorisë së “individëve”, ndërkohë që ky tregues ka rezultuar në rënie për të dyja kategoritë e bizneseve, si në terma gjashtëmujorë, edhe në terma vjetorë.

Norma totale e refuzimit ka rezultuar në rënie për bankat me kapital vendas, por në rritje tek ato me kapital të huaj. Vihet re se gjatë periudhës, dy grupet bankare kanë shfaqur qëndrime të kundërta ndaj kërkesave për kredi të “bizneseve të vogla e të mesme” dhe ndaj kategorisë së “individëve”, pasi bankat vendase kanë shfaqur prirje lehtësuese, duke refuzuar përkatësisht vetëm 4% dhe 6% të tyre, ndërkohë që bankat e huaja kanë rritur normën e refuzimit përkatësisht në 7% dhe 34%. Në të njëjtën kohë, të dy grupet e bankave duket se kanë preferencë të ngjashme ndaj bizneseve të mëdha, duke refuzuar vetëm 3% të kërkesave të tyre.

Në përgjithësi, nga analiza e mësipërme, mund të arrihet në përfundimin se ecuria e aplikimeve të shqyrtuara nga bankat gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, tregon për një rritje graduale të kërkesës për kredi, e drejtuar kryesisht nga sektori i individëve dhe ai i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe një qëndrim relativisht përzgjedhës i bankave veçanërisht në drejtim të kredidhënies së individëve.



### 5.1.1.5 Depozitat

Në fund të periudhës, depozitat e mbajtura në sektorin bankar arritën vlerën 1,610 miliardë lekë. Këto depozita u rritën gjatë periudhës me 0.4%, duke reflektuar kryesisht zgjerimin e depozitave me afat, të depozitave të individëve dhe atyre në Lek. Llogaritë rrjedhëse dhe ato pa afat ranë lehtë.

Në terma vjetorë, depozitat u zgjeruan me 7%; depozitat në Lek dhe valutë u zgjeruan me 8% dhe 6%. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë rezultoi rreth 12%.


Rritja e depozitave në Lek lidhet me zgjerimin e llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat të individëve, ndërsa rritja vjetore e depozitave në valutë pasqyron rritjen e depozitave me afat të dy sektorëve.

Normat e interesit të depozitave të reja vijuan të rriten, ndërsa flukset e depozitave të reja ishin më të ulëta se ato të gjashtëmuajorit të mëparshëm, por të krahasueshme me ato të gjysmës së parë të 2023.

Depozitat e mbajtura në sektorin bankar u rritën me 0.4% gjatë periudhës. Kjo rritje reflektoi zgjerimin e lehtë të depozitave me afat, depozitave të individëve dhe depozitave në monedhën vendase, ndërkohë që kategoritë e tjera të depozitave regjistruan rënie të lehtë. Nëse ndryshimi në stokun e depozitave korrigohet për efektin e kursit të këmbimit, rritja gjashtëmuajore vlerësohet në rreth 2%. Struktura e depozitave nuk tregoi ndryshime të qenësishme. Vëllimi i depozitave sipas afatit është i shpërndarë në mënyrë pothuajse të barabartë midis llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat që zënë përkatësisht 44% dhe 43% të totalit, ndërsa depozitat e individëve dhe depozitat në valutë zënë përkatësisht 79% dhe 53% të stokut të përgjithshëm të depozitave.


Në terma vjetorë, rritja e depozitave ishte rreth 7% dhe në fund të muajit qershor, depozitat arritën në 1,610 miliardë lekë. Depozitat e individëve kontribuuan me rreth 5 p.p. në rritjen vjetore të stokut të depozitave. Sipas afatit dhe monedhës, kontributi ka qenë i gjerë dhe ka ardhur nga depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse, si edhe nga depozitat në Lek dhe ato në valutë. Gjatë gjysmës së parë të vitit, depozitat e bizneseve u tkurrën me 11 miliardë lekë ose me 4%, por krahasuar me një vit më parë, ato u shtuan me rreth 9%. Sipas monedhës, depozitat në Lek u rritën me vetëm 1.8% dhe ato në valutë u tkurrën me 0.9%. Në terma vjetorë, depozitat në Lek dhe valutë u zgjeruan me përkatësisht 57 dhe me 48 miliardë lekë, ose me 8% dhe 6%. Nëse korrigohej për efektin statistikor të kursit të këmbimit<sup>37</sup> baza e depozitave dhe depozitat në valutë rezultojnë të jenë rritur me 10-12% në krahasim me nivelet e një viti më parë.

Grafik 64. Rritja vjetore e depozitave sipas afatit dhe monedhës, në monedhë origjinale



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 65. Rritja vjetore e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontribut, p.p.)





Burimi: Banka e Shqipërisë

<sup>37</sup> Efekti statistikor i ndryshimit të kursit të këmbimit në kundërvlerën në Lek të depozitave në valutë llogaritet në -27 miliardë lekë për gjashtëmuajin e parë të 2024 dhe me -48 miliardë lekë për 12 muajt e fundit.



Sipas afatit të maturimit, rritja e depozitave ishte më e dukshme tek depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse. Kështu, depozitat me afat u zgjeruan me rreth 9% në terma vjetorë dhe kanë vijuar të japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen e depozitave të përgjithshme. Llogaritë rrjedhëse treguan gjithashtu rënie të lehtë gjatë periudhës, por në terma vjetorë u zgjeruan me 7.3%. Ndërsa, stoku i depozitave pa afat ra lehtë gjatë periudhës dhe ndaj një viti më parë. Që prej gjysmës së parë të vitit 2022 evidentohet një rritje e preferencës së depozituesve për depozitat me afat, dhe kjo periudhë është karakterizuar njëkohësisht edhe nga një rritje relativisht më e shpejtë e normave të interesit.

Rritja vjetore e depozitave në Lek ishte 8% dhe pasqyron kryesisht zgjerimin e llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat të individëve. Në fund të periudhës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat të individëve në monedhën Lek shënonin përkatësisht 210 dhe 340 miliardë lekë, duke qenë 11% dhe 4% mbi nivelin e një viti më parë. Depozitat pa afat në Lek u zgjeruan shumë lehtë gjatë periudhës dhe një viti më parë, ndërsa depozitat me afat u rritën me 1% gjatë periudhës dhe me 5% në terma vjetorë. Pothuajse i gjithë stoku prej 350 miliardë lekësh i depozitave me afat në Lek përfaqësohet nga depozitat e individëve, të cilat në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë u zgjeruan me rreth 3-4%.




Rritja vjetore e depozitave në monedhën Euro ishte 13%. Depozitat me afat të bizneseve dhe individëve në Euro në fund të periudhës ishin përkatësisht 30% dhe 20% më të larta në krahasim me nivelin e një viti më parë, ndërsa ndryshimi vjetor në depozitat e përgjithshme në Euro të secilit sektor ishte 11% dhe 14%. Në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, rritja e depozitave gjatë periudhës ishte dukshëm më e ngadaltë, pasi depozitat në Euro të individëve u shtuan me rreth 240 milionë euro, ndërsa ato të bizneseve nuk shfaqën ndryshime. Gjatë së njëjtës periudhë një vit më parë, shtesat përkatëse ishin 230 dhe 110 milionë euro. Në linjë me ecurinë sezonale të depozitave,




tremujori i dytë i viteve të fundit ka regjistruar vlera më të larta në krahasim me tremujorin e parë, veçanërisht për depozitat e individëve.

Grafik 68. Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në Lek për individët



Grafik 69. Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në euro për individët



Me gjithë rritjen e normave të interesit të depozitave për të dy sektorët dhe për të tri monedhat kryesore, depozitat e reja ishin në vlera më të ulëta se në gjashtëmujorin e mëparshëm. Flukset mesatare mujore të depozitave të reja të individëve gjatë periudhës ishin përkatësisht 18 miliardë lekë (për depozitat në Lek) dhe 180 milionë euro (për depozitat e reja në euro), nga 23 miliardë lekë dhe 250 milionë euro në gjashtëmujorin paraardhës. Nga ana tjetër, ecuria e depozitave të reja gjatë periudhës ishte e krahasueshme me atë të regjistruar gjatë së njëjtës periudhë një vit më parë. Normat mesatare të peshuara të interesit gjatë periudhës për depozitat e reja të bizneseve dhe individëve në Lek ishin përkatësisht 2.8% dhe 1.9%, ndërsa normat për depozitat e reja me afat në monedhën Euro, për bizneset dhe individët arritën në 1.9% dhe 1.1%. Për depozitat e individëve me afat mbi dy vjet në Lek, kjo normë është rritur, duke arritur rreth 3% në fund të periudhës, dhe për depozitat e individëve me afat mbi dy vjet në Euro norma e peshuar e interesit arriti në 1.7% (nga 1.3% një vit më parë).



## 5.1.2 RREZIQET E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT BANKAR

### 5.1.2.1 Rreziku i kredisë

Raporti i kredive me probleme (RKP) u përmirësua lehtë gjatë periudhës, dhe në fund të periudhës ai shënonte 4.7%. Kjo ecuri reflektoi rritjen më të shpejtë të tepricës së kredisë në krahasim me zgjerimin e stokut të kredive me probleme. Stoku i kredive me probleme u rrit me rreth 2 miliardë lekë ose 6%, dhe në fund të qershorit shënonte rreth 37 miliardë lekë. Brenda këtij stoku, kreditë me probleme të klasifikuara “të humbura” u tkurrën me 1.8 miliardë lekë, kryesisht si rezultat i shlyerjeve të detyrimeve nga klientët dhe i fshirjeve të tyre nga portofoli i bankave. Në krahasim me një vit më parë, stoku i kredive me probleme nuk shfaqti ndryshime, dhe RKP-ja ka rënë me rreth 0.5 p.p..

Në rritjen e kredive me probleme gjatë periudhës kanë ndikuar kreditë me maturitet afatshkurtër, kreditë për bizneset dhe kreditë në Lek. Brenda portofolit të kredive me probleme, bankat kanë raportuar rritje të tepricës për klasën e kredive të dyshimta, që tashmë zënë 23% të kredive me probleme, nga 15% në dhjetor 2023. Peshën kryesore në portofolin e kredive me probleme vijojnë ta mbajnë kreditë e humbura me 49% (nga 57% në fund të vitit 2023).

Gjatë 12 muajve të fundit, vlera e kredive të fshira nga bilanci e sektorit bankar ishte rreth 3 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e kredive të fshira ishin kredi në monedhën vendase të mbajtura nga sektori i biznesit. Në periudhën janar 2015 – qershor 2024, bankat kanë fshirë nga bilanci e tyre rreth 80 miliardë lekë kredi të humbura.

Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta, rreth 75%, por gjatë periudhës ky raport ra me 5 p.p. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë 45% të tepricës së kredisë ose rreth 61% të kredisë së kolateralizuar. Stoku i kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme është zvogëluar me 4% në krahasim me një vit më parë si rezultat i tkurrjes së kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme komerciale, ndërkohë që portofolet e kredive të kolateralizuara me kolateral tjetër kanë shënuar rritje.

Mbulimi me provigjione i kredive me probleme, zbriti në nivelin 67%. Ky nivel ishte 0.4 p.p. më i ulët se ai i fundit të vitit 2023, por 0.3 p.p. më i lartë se ai i një viti më parë. Në rënien e raportit gjatë periudhës ndikoi rritja më e shpejtë e stokut të kredive me probleme në krahasim me shtimin e fondit të provigjioneve.


*Kredia me probleme shënoi rritje me rreth 6% gjatë periudhës, duke u ngjitur në nivelin 37 miliardë lekë. Rritja e stokut të kredive me probleme është vënë re kryesisht në portofolin e kredisë në monedhën vendase, në kredinë afatshkurtër dhe në kredinë për bizneset. Në krahasim me një vit më parë, vlera e stokut të kredive me probleme nuk ka ndryshuar.*

*Për shkak të rritjes më të shpejtë të tepricës totale të kredisë, raporti i kredive me probleme (RKP) zbriti në 4.7% në fund të periudhës, duke shënuar një përmirësim të lehtë të cilësisë së kredisë. Ulje të RKP-së kanë shënuar edhe kredia për investime në pasuri të paluajtshme, kredia për konsum dhe kredia e pambrojtur nga kursi i këmbimit. Në fund të periudhës, portofolet e kredisë me vlerën më të lartë të RKP ishin kredia afatmesme (6.5%), ajo për biznese (5.9%), kredia për tregti (5.4%), si dhe kredia në Lek (5.3%).*


*Në krahasim me një vit më parë, cilësia e kredisë shënon përmirësim më të dukshëm dhe RKP ka rënë me 0.5 p.p.*

*Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta, rreth 75%, por gjatë periudhës ky raport ra me 5 p.p.. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë 45% të tepricës së kredisë ose rreth 61% të kredisë së kolateralizuar.*

*Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme zbriti me 0.4 p.p. gjatë periudhës, në 67%. Kundrejt një viti më parë, ky tregues u rrit me 0.3 p.p..*




Grafik 70. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione dhe kolateral



Burimi: Banka e Shqipërisë


Grafik 71. Kontributi në ndryshimin tremujor të stokut të kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë


Sipas qëllimit të përdorimit, cilësia e kredisë ka shënuar përmirësim për portofolin e kredisë për investime në pasuri të paluajtshme dhe atë për konsum. Raporti i kredive me probleme i këtyre kategorive ra përkatësisht në nivelet 3.9% dhe 5.4% në qershor 2024, nga 4.3% dhe 5.7% në dhjetor 2023. Rënie e cilësisë së portofolit për periudhën u evidentua në kredinë dhënë për tregti, duke qenë se raporti i kredive me probleme për këtë kategori u ngjiti në 5.4%, nga 4.8 në dhjetor 2023. Portofolet e kredisë me vlerën më të lartë të raportit të kredive me probleme janë kredia afatmesme, ajo për biznese, si dhe kredia në Lek. Në fund të qershorit 2024, raportet e kredive me probleme për këto lloje kredish ishin përkatësisht 6.5%, 5.9% dhe 5.3%.

Grafik 72. RKP-ja për kredinë sipas qëllimit të përdorimit




Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 73. Treguesit e vlerësimit të rrezikut të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë





Treguesi i normës së prurjeve të kredive me probleme<sup>38</sup> dhe ai i kredive me probleme të rikuperuara<sup>39</sup> sugjerojnë se gjatë një viti, sektori bankar ka regjistruar më pak kredi të reja me probleme. Në qershor 2024, fluksi vjetor i kredive të reja me probleme ishte sa 1.8% e kredive të rregullta, nga 1.9% dhe 2.2% një gjashtëmuajor dhe një vit më parë. Kjo ecuri u përcaktua nga zgjerimi i tepricës së kredive të rregullta. Norma e rikuperimit të kredive me probleme u rrit në 13%, nga 10% një vit më parë. Kjo ecuri tregon rritje të aftësisë së bankave për të rikuperuar kreditë me probleme. Nga ana tjetër, norma e dështimit<sup>40</sup> që tregon shpejtësinë me të cilën akumulohen kreditë e humbura në krahasim me portofolin e përgjithshëm të kredisë, ka rënë në 1.1% nga 1.4% dhe 1.2% një gjashtëmuajor dhe një vit më parë, ndikuar nga zgjerimi i tepricës së përgjithshme të kredisë dhe tkurrja e huave të humbura. Rënia e normës së dështimit gjatë 12 muajve të fundit sinjalizon një rrezik më të ulët të aktivitetit kreditues, megjithatë zgjerimi i portofolit të kredisë mund të materializohet në një shtim të prurjeve të kredive me probleme në të ardhmen.

Cilësia e kredisë në valutë të pambrojtur nga luhatjet në kursin e këmbimit mbeti e pandryshuar në krahasim me fundin e gjashtëmuajorit të kaluar dhe ka rënë lehtë në krahasim me një vit më parë. Raporti i kredive me probleme (RKP) për këtë portofol të kredisë shënoi 4.3% në fund të qershorit 2024 nga 4.4% një vit më parë. Në këtë ecuri ka ndikuar tkurrja në stokun e kredive me probleme të kredisë dhënë bizneseve për zhvillimin e pasurive të paluajtshme (rezidenciale) dhe kredisë konsumatore. Peshën kryesore, me rreth 45%, në tepricën e kredive me probleme të pambrojtur nga luhatjet e kursit të këmbimit vijon ta mbajë kredia për investime në pasuri të paluajtshme, por RKP-ja për këtë kategori kredie ra në rreth 3.3%, nga 4.8% një vit më parë.

### 5.1.2.2 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit në aktivitetin e sektorit bankar mbetet i kontrolluar. Treguesit kryesorë të likuiditetit për monedhën vendase dhe ato të huaja paraqiten në rënie gjatë periudhës, por ato vijojnë të jenë dukshëm mbi kufijtë minimalë të përcaktuar nga aktet rregullative. Gjatë gjysmës së parë të vitit, pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar u ndikua nga tkurrja më e shpejtë e aktiveve likuide në krahasim me detyrimet afatshkurtra, veçanërisht për monedhën Lek. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, treguesi kryesor i likuiditetit paraqitet i përmirësuar vetëm për aktivitetin në valutë.

Gjatë periudhës, bankat kanë raportuar zgjerim të hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet deri në 3 muaj. Në tërësi, hendeku i përgjithshëm midis aktiveve dhe pasiveve ka mbetur pothuajse i pandryshuar,

<sup>38</sup> Fluksi i ri i kredive me probleme gjatë një viti ndaj tepricës së kredive të rregullta në fund të periudhës.

<sup>39</sup> Fluksi i ri i kredive me probleme që kanë kaluar në klasat performuese gjatë një viti ndaj tepricës së kredive me probleme në fund të periudhës.

<sup>40</sup> Fluksi i ri i kredive të humbura gjatë një viti ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë (me përfshirje të kredive të humbura) në fund të periudhës.

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivele të mira dhe treguesit e likuiditetit vijojnë të qëndrojnë dukshëm mbi kufijtë rregullativë.

Në krahasim me 6 muaj dhe 1 vit më parë, bankat kanë një vëllim disi më të ulët aktiveve likuide në raport me aktivet e përgjithshme dhe detyrimet afatshkurtra.

Gjatë periudhës, bankat kanë raportuar zgjerim të hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet deri në 3 muaj.

Diferenca midis afatit mesatar të maturimit të aktiveve dhe të detyrimeve është rritur lehtë. Prej disa gjashtëmuajorësh, sektori bankar nuk ka raportuar linja financimi nga grupet bankare zotëruese.




në rreth 5% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Diferenca midis maturitetit mesatar të mbetur të aktiveve dhe pasiveve u zgjerua lehtë, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së maturitetit mesatar të mbetur të aktiveve. E njëjta diferencë midis maturiteteve të mbetura të kredive dhe depozitave ka qëndruar thuajse e pandryshuar.

**Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues të bankave mbeten depozitat, që mbulojnë rreth dy herë vëllimin e kredive të sektorit.** Në fund të periudhës, raporti "hua/depozita" ishte 49% nga 46% gjashtë muaj më parë, ndikuar nga rritja më e fortë e tepricës së kredisë në krahasim me atë të bazës së depozitave. Niveli i këtij treguesi është më i ulët se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ndjeshëm më i ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian. Sipas monedhave, gjatë periudhës ky raport u rrit në 57% (nga 53%) për Lekun dhe në 42% (nga 40%) për valutën.


**Në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, bankat kanë një vëllim më të ulët të aktiveve likuide në raport me aktivet e përgjithshme dhe detyrimet afatshkurtra.** Në fund të periudhës, bankat zotëronin një vëllim aktivesh likuide prej rreth 570 miliardë lekësh, ku pjesa mbizotëruese e tyre (rreth 56%) lidhen me investime në tituj borxhi të Qeverisë Shqiptare. Aktivet likuide përfaqësojnë rreth 28.4% të totalit të aktiveve në bilancet e bankave dhe raporti është ulur lehtë në krahasim me gjashtë muaj më parë, si pasojë e efektit të kombinuar të rënies së aktiveve likuide dhe rritjes së aktiveve të përgjithshme. Treguesi i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ka rënë lehtë në nivelin 41.2% (nga 43.4% gjashtë muaj më parë), por qëndron ndjeshëm mbi kufirin minimal rregullator<sup>41</sup>. Treguesi ka rënë si për Lekun ashtu edhe për Euron, kryesisht si rezultat i rënies së aktiveve likuide në këto monedha.

Grafik 74. Diferenca në maturimin mesatar të mbetur midis aktive-pasive dhe kredi-depozita




Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 75. Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve



Burimi: Banka e Shqipërisë

<sup>41</sup> Bankat duhet të mbajnë mjete likuide për mbulimin e 15% të detyrimeve afatshkurtra për Lekun, 20% për valutën, dhe me një kërkesë totale prej 20%.



Gjatë periudhës, në bilancet e bankave është regjistruar tkurrje e aktiveve me afat kontraktual të mbetur deri në tre muaj, ndërkohë që detyrimet e tyre për të njëjtën shportë thuhet nuk kanë ndryshuar. Kjo ecuri bëri që hendeku negativ midis aktiveve dhe detyrimeve për këtë shportë<sup>42</sup> të zgjerohej në 24% të aktiveve të përgjithshme, nga 17% gjashtë muaj më parë. Ky hendek vijon të jetë hendeku më i madh negativ për të gjithë horizontin e maturiteteve. Në të njëjtën kohë, hendeku për maturitetin 3 muaj deri në 1 vit është rikthyer në vlera neutrale, pas vlerës negative prej 5% gjashtëmuajorin e kaluar. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, në raport me aktivet e përgjithshme madhësia e hendekut të përgjithshëm midis aktiveve dhe detyrimeve vijon të mbetet e kufizuar pranë një vlere mesatare prej 5%. Hendeku i përgjithshëm për të gjitha maturitetet vijon të jetë pozitiv dhe nuk ka shënuar ndryshime të dukshme ndaj periudhave të mëparshme, për shkak të qëndrueshmërisë në pozicionet pozitive për maturitetet më afatgjata.

Diferenca midis maturimit mesatar të aktiveve dhe detyrimeve është rritur në 22.7 muaj (nga 21.1 muaj), pasi maturiteti i mbetur mesatar i aktiveve është zgjeruar, ndërsa ai i pasiveve nuk ka ndryshuar. Nga ana tjetër, diferenca midis maturitetit mesatar të mbetur të huave dhe depozitave mbeti pothuajse e pandryshuar, në 45.1 muaj (nga 45.4 muaj), për shkak se maturitetet mesatare të mbetura të huave dhe depozitave janë rritur në të njëjtën masë. Prej disa gjashtëmuajorësh, sektori bankar nuk ka raportuar linja financimi nga grupet zotëruese.

### 5.1.2.3 Rreziqet e tregut

#### RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Gjatë periudhës, pozicioni i hapur valutor neto i sektorit bankar mbeti “në blerje”, por ishte në vlera më të ulëta në krahasim me fundin e vitit të kaluar dhe një vit më parë. Niveli i këtij pozicioni rezultoi 4.6% e kapitalit rregullator, përkatësisht 1.6 p.p. dhe 0.9 p.p. nën nivelin e regjistruar gjashtë muaj dhe një vit më parë, dhe dukshëm nën kufirin maksimal rregullator prej 30%. Ky pozicion është luhatur rreth vlerave 5-6% gjatë gjysmës së parë të vitit, nga një mesatare prej 7% të regjistruar për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023.

Ecuria e treguesit të përgjithshëm përcaktohet kryesisht nga ecuria e treguesit për bankat me rëndësi sistemike, për të cilat pozicioni i hapur neto valutor “në blerje” ishte sa 6.4% e vlerës së kapitalit rregullator të tyre. Bankat josistemike në përgjithësi paraqesin ekspozim të ulët dhe të qëndrueshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Pozicioni i hapur neto i bankave josistemike ishte “në blerje” në nivelin 0.3% të kapitalit rregullator, ose 0.6 p.p. më i ulët në krahasim me gjashtë muaj më parë. Pavarësisht ndryshimit të herëpashershëm të kahut të pozicionit të hapur neto, “në blerje” ose “në shitje”, ekspozimi i bankave josistemike nuk e tejkalon nivelin prej 2% të kapitalit rregullator të tyre.


Gjatë periudhës, pozicioni i hapur valutor neto i sektorit bankar rezultoi “në blerje” dhe sa 4.6% e kapitalit rregullator. Kjo ishte vlera më e ulët e treguesit përgjatë vitit të fundit, dhe është dukshëm nën kufirin maksimal rregullator prej 30%.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur nga treguesi i mospërputhjes valutore, u rrit lehtë gjatë periudhës, si rezultat i zgjerimit të kredisë për rezidentët në valutë, por mbetet pranë nivelit të minimumit historik.

<sup>42</sup> I llogaritur si raporti i “diferencave midis aktiveve dhe pasiveve” ndaj “totalit të aktiveve” për secilën shportë të maturitetit të mbetur. Në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.




Grafik 76. Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin bankar dhe grupet




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 77. Ecuria e përbërësve të indeksit të mospërputhjes valutore për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 78. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur me treguesin e mospërputhjes valutore u rrit lehtë gjatë periudhës, por mbeti në nivele të ulëta krahasuar me mesataren historike. Në fund të periudhës, treguesi ishte sa 14.8% e aktiveve të sektorit bankar, në rritje me 0.4 p.p. nga niveli i minimumit historik të regjistruar gjashtë muaj më parë, e megjithatë qëndroi 0.6 p.p. poshtë nivelit të regjistruar në të njëjtën periudhë një vit më parë, dhe nën nivelin e mesatares së 5 viteve të fundit (prej 15.7%). Pasivet dhe aktivet në valutë u rritën me ritme të ngjashme, duke u zgjeruar me rreth 1% gjatë periudhës, ndërsa kredia për rezidentët në valutë u rrit me rreth 3.5%, duke dhënë kontributin kryesor në ecurinë e treguesit të përgjithshëm. Treguesi për bankat sistemike reflekton një ekspozim më të ulët në krahasim me

sektorin bankar në tërësi. Për këtë grup bankash, treguesi qëndroi pranë nivelit prej 11.4% të gjashtë muajve më parë dhe ishte rreth 1.1 pikë përqindjeje më i ulët se një vit më parë. Grupi i bankave josistemike shënon vlera më të larta të indeksit të mospërputhjes valutore, i cili në fund të periudhës ishte 1.1 p.p. më i lartë duke arritur nivelin prej 21.2% nga 20.1% gjashtë muaj më parë dhe duke ndikuar rritjen e treguesit të përgjithshëm për sektorin bankar. Në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, treguesi nuk regjistroi ndryshime të qenësishme.



## RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të luhatjes së normave të interesit mbetet i ulët dhe dukshëm nën kufirin maksimal rregullator prej 20%. Pozicioni total neto i peshuar i ekspozimeve ndaj normave të interesit në librin e bankës, në fund të periudhës, ishte sa 2.4% e vlerës së kapitalit rregullator, ose 1.7 p.p. dhe 0.2 p.p. më i lartë në krahasim me nivelin e regjistruar gjashtë muaj dhe një vit më parë. Kufiri maksimal i lejuar rregullator për këtë tregues është 20% e kapitalit rregullator. Kjo ecuri u ndikua nga veprimi i njëkohshëm i tkurrjes së pozicionit negativ të aktiveve dhe pasiveve me normë interesi fikse (FIR) me 1.2 p.p. (në -0.1% të kapitalit rregullator), dhe zgjerimi i pozicionit pozitiv të aktiveve dhe pasiveve me norma të ndryshueshme të interesit (VIR) me 0.5 p.p. (në 2.5% të kapitalit rregullator). Diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë të ndryshueshme interesi (VIR) përbën peshën kryesore në pozicionin total neto. Gjithashtu, vlen të përmendet që një vit më parë, diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë fikse interesi (FIR) ishte pozitive në nivelin 0.2% të kapitalit rregullator të sektorit bankar.

*Treguesi që mat ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të normës së interesit ka shënuar rritje gjatë periudhës, megjithatë mbetet ndjeshëm nën kufirin e sipërm rregullator.*

*Sektorit bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit për pozicionet në Lek, ato me normë interesi të ndryshueshme dhe për maturitetin afatgjatë.*

*Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit, i matur me treguesin e spread-it, ka shënuar rritje gjatë periudhës, por mbetet pranë mesatares afatgjatë.*

Treguesi i ekspozimit për bankat sistemike u rrit në nivelin 3.1% të kapitalit rregullator, nga 0% dhe 2.5% gjashtë muaj dhe një vit më parë. Ky ekspozim ishte i tëri në instrumente me normë të ndryshueshme interesi (VIR), në kushtet kur ekspozimi në instrumente me normë fikse të interesit (FIR) për periudhën ishte 0%. Për bankat josistemike, pozicioni total neto i peshuar i ekspozimeve ndaj normave të interesit në librin e bankës shënoi 1.3% të kapitalit rregullator të tyre ose diçka më pak në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Pasivet me normë fikse të interesit ishin më të larta në krahasim me aktivet, dhe ekspozimi për instrumentet me normë fikse të interesit (FIR) ishte negativ në nivelin 0.3% të kapitalit rregullator<sup>43</sup>. Ekspozimi ndaj luhatjes së normës së interesit për instrumentet me normë të ndryshueshme të interesit (VIR), mbeti pothuajse i pandryshuar dhe sa 1.5% e kapitalit rregullator të bankave josistemike.

Grafik 79. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator




Kontributin kryesor në ekspozimin e bankave ndaj luhatjeve të normave të interesit vijon ta japë pozicioni neto në monedhën vendase. Gjatë periudhës, zgjerimi i pozicionit të përgjithshëm u ndikua nga efekti i kombinuar i zgjerimit të pozicionit të hapur në Lek dhe tkurrja e pozicionit negativ në Euro. Vlera e pozicionit neto në monedhën Lek shënoi 3.4% të kapitalit rregullator ose 0.6 p.p. dhe 1.2 p.p. mbi nivelin e llogaritur gjashtë muaj dhe një vit më parë. Për monedhën

<sup>43</sup> Gjashtë muaj dhe një vit më parë ky tregues mbante vlera pozitive (aktivet më të larta se sa pasivet me norma fikse të interesit) në nivelet 0.8% dhe 0.3% të kapitalit rregullator të bankave josistemike.



evropiane, pasivet vijojnë të regjistrojnë vlera më të larta në krahasim me aktivet e ndjeshme ndaj luhatjes së normës së interesit, por kjo diferencë ra me 0.7 p.p. në krahasim me periudhën paraardhëse në nivelin 1.5% të kapitalit rregullator.

**Në terma të maturiteteve në pozicionin e bankave, gjatë 12 muajve të fundit, vihet re rritje e ekspozimit për instrumentet me maturitet afatshkurtër dhe afatgjatë.** Në krahasim me gjashtë muaj më parë, ekspozimi për instrumentet afatshkurtra regjistroi rritje me 1.0 p.p. në nivelin 1.6% të kapitalit rregullator, por ra lehtë ndaj nivelit prej 2.5% të një viti më parë. Treguesi i pozicionit neto të peshuar për ekspozimet me maturitet afatmesëm vijon të jetë negativ; ai ishte sa 7.0% e kapitalit rregullator dhe është tkurrur lehtë gjatë periudhës dhe në krahasim me një vit më parë. Ekspozimi nga shporta me maturim afatgjatë, përfaqëson ekspozimin më të madh dhe mbetet pozitiv, duke qenë se vlera e aktiveve me maturitet afatgjatë është më e madhe sesa vlera e detyrimeve afatgjata të bankave. Treguesi përkatës është sa 7.8% e kapitalit rregullator dhe u rrit me 0.4 p.p., në krahasim me gjashtë muaj më parë, por mbetet në nivel të krahasueshëm me një vit më parë.



Treguesi i rrezikut të tërthortë<sup>44</sup> ndaj ndryshimit të normave të interesit sinjalizon rritje të rrezikut në krahasim me gjashtë muaj më parë. Gjatë periudhës, diferenca midis normave të interesit të kredive dhe depozitave të reja<sup>45</sup> u luhet në vlerat 4.2-5.2% dhe në muajin qershor, ajo regjistroi 4.9%, ose

<sup>44</sup> Ky rrezik i referohet ndikimit që ndryshimi në normën e interesit jep te klientët e bankave. Për shembull, pavarësisht se rritja e normës së interesit mund të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin e bankës (për shkak të vlerës pozitive të pozicionit neto mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit), kjo rritje do të ketë efekt negativ te aftësia paguese e huamarrësve të bankës, kur kredia është dhënë me normë interesi të ndryshueshme (rreziku i tërthortë). Megjithatë, ky efekt supozohet që kompensohet në masën më të madhe nëse në krahun tjetër, kemi një rritje të normës së interesit për depozitat.


<sup>45</sup> Nga ky raport e në vijim, do t'iu referohemi të dhënave të statistikave të normave të interesit sipas standardit të ri metodologjik për statistikave të harmonizuara të normave të interesit të institucioneve monetare financiare, bazuar në rregulloren "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit" me vendim nr. 48, datë 0.9.2017.



0.8 p.p. më shumë në krahasim me gjashtë muaj më parë. Kjo ecuri u diktua nga rritja më e madhe e normës së interesit të kredisë (me 1.2 p.p.), në krahasim me atë të depozitave (me 0.4 p.p.). Pavarësisht luhatjeve të regjistruara gjatë periudhës, spread-i i normave të interesit është luhatur pranë vlerës mesatare vjetore prej 5.0%. Në krahasim me një vit më parë, spread-i i normave të interesit ra me 0.7 p.p., si rezultat i rritjes së normës së interesit të depozitave me 0.8 p.p., ndërkohë që norma e interesit të kredisë nuk regjistroi ndryshime.


**Spread-et për monedhat Lek dhe Euro u zgjeruan, si rezultat i ecurisë së normave të interesit të kredisë për këto monedha gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit.** Spread-i për monedhën vendase regjistroi 4.9% ose 0.9 p.p. mbi nivelin e gjashtë muajve më parë, si rezultat i rritjes më të lartë të normës së interesit për kreditë e reja (me 1.4 p.p.) në nivelin 7.0%, në krahasim me rritjen në normën e depozitave (me 0.4 p.p.) në nivelin 2.2%. Norma e interesit për kreditë e reja në Euro u rrit me 1.0 p.p. (në 6.3%), ndërsa ajo e depozitave në Euro me 0.6 p.p. (1.7%), duke rezultuar në zgjerim të spread-it në krahasim me gjashtë muaj më parë me 0.5 p.p. në nivelin 4.7%. Në krahasim me një vit më parë, spread-et e monedhave Lek dhe Euro u ngushtuan me përkatësisht 0.7 dhe 0.9 p.p., si rezultat i rritjes së normës së interesit të depozitave gjatë vitit.

Grafik 81. Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave dhe spread-i i normave të interesit, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 82. Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në p.p.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kushtet kur pozicioni neto i peshuar i bankave vijon të dominohet nga pozicioni në instrumente me normë të ndryshueshme interesi, luhatshmëria e normave të interesit do të ketë ndikim në cilësinë e kredisë. Lëvizja e normave të interesit shoqërohet me rritjen e luhatshmërisë së spread-eve dhe mund të sjellë ndryshime në pozicionin e peshuar neto të bankave për maturitete, monedha dhe lloje të caktuara instrumentesh. Për këtë arsye, në varësi të skenarëve, nevojitet rritja e vëmendjes së bankave ndaj ndikimit të këtyre faktorëve mbi aftësinë paguese të huamarrësve me kredi me norma interesi të ndryshueshme, veçanërisht për segmente ku ekspozimet janë më të mëdha ose po rriten më shpejt.



### 5.1.3 REZISTENCA E SEKTORIT BANKAR

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës së aftësisë paguese tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike të supozuara ndaj skenarëve të rrezikut për periudhën 2024-2026.


Ndjeshmëria e sektorit bankar është përmirësuar në krahasim me një vit më parë, pasi numri i bankave që do të kishin nevojë për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit dhe vlera e nevojshme e kapitalit, në skenarët më pak të favorshëm, kanë rënë.

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike dhe se ndjeshmëria e tij ndaj zhvillimeve të pafavorshme është zbutur kundrejt një viti më parë. Gjithsesi, një numër i kufizuar bankash paraqet ndjeshmëri të shtuar ndaj supozimeve më ekstreme.

Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit tregon shkallën e qëndrueshmërisë së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë aftësinë e sektorit në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike dhe papunësinë, ecurinë e kursit të këmbimit, volumet dhe cilësinë e portofolit të kredisë, nivelin e normave të interesit dhe ecurinë e çmimeve të aktiveve jofinanciare.

Ushtrimi ndërtohet mbi tre skenarë - skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe atë të rënduar - dhe periudha ushtrimore shtrihet deri në fund të vitit 2026. Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive gjatë këtij harku kohor, e cila shoqërohet me një rritje pozitive të kreditimit, mbiçmim të monedhës vendase dhe rënie të papunësisë. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike mbetet në territor pozitiv gjatë periudhës ushtrimore, por norma e rritjes është më e ulët kundrejt skenarit bazë. Ndërsa, në skenarin e rënduar, duke filluar që nga tremujori i tretë i vitit të dytë (2025), norma e rritjes ekonomike supozohet të jetë negative.

Në skenarin e moderuar dhe atë të rënduar, shtohen edhe supozimet për nënçmimin e kursit të këmbimit, rritjen e normave të interesit dhe ngadalësimin e ritmit të kreditimit, duke kaluar në një ndalim përgjatë vitit të fundit ushtrimor (2026). Këto zhvillime reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë, si për individët ashtu edhe për bizneset. Ky përkeqësim paraqitet më i ndjeshëm për portofolin e biznesit në rastin e bankave me rëndësi sistematike dhe për portofolin e individëve në rastin e bankave të tjera.





Tregues të tjerë makroekonomikë të përfshirë në ushtrim, në skenarët më të pafavorshëm supozojnë një rënie të çmimeve të banesave dhe rritje të papunësisë deri në fund të periudhës. Këto supozime ndikojnë në nivelin e kapitalizimit të bankave të veçanta dhe të sektorit bankar në tërësi, kryesisht gjatë vitit 2026.


Në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës tregojnë se:

- në skenarin bazë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar vlerësohet në rreth 21%, deri në fund të vitit 2026. Këto zhvillime tregojnë një qëndrueshmëri dhe nivele të mira të kapitalizimit të të gjithë sektorit bankar. Numri i bankave që kanë nevojë për injektim kapitali është vetëm dy. Këto banka zënë një peshë prej rreth 3.2% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 0.6 miliard lekë, ose sa rreth 0.06% e PBB-së;
- në skenarin e moderuar, RMK-ja për sektorin bankar bie në rreth 19% në fund të vitit 2026, duke vijuar të ruajë nivele të mira përgjatë gjithë periudhës ushtrimore. Vetëm tre banka, me aktive sa rreth 19% e aktiveve të sektorit, kanë nevojë për injektim kapitali në këtë skenar. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 8 miliard lekë ose sa rreth 0.44% e PBB-së;
- në skenarin e rënduar, sektori bankar vijon të jetë i mirëkapitalizuar deri në fund të vitit 2026, me një RMK prej rreth 15%. Numri i bankave që kanë nevojë për injektim kapitali në këtë skenar është gjashtë dhe pesha e aktiveve të tyre në aktivet e sektorit bankar arrin në rreth 40%. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 29 miliardë lekë ose sa 1.23% e PBB-së.

Në këtë skenar, për bankat me rëndësi sistemike dhe ato josistemike, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit arrin në përkatesisht 14.2% dhe 15%. Grupi i bankave me kapital të huaj paraqet një nivel kapitalizimi prej rreth 18%, duke mbetur i mirëkapitalizuar, ndërsa grupi i bankave me kapital vendas ka një RMK të ulët prej rreth 9%. Kontribut kryesor në rënie të kapitalizimit në skenarin e rënduar në fund të vitit 2026 e jep zëri "Humbja nga huatë" dhe rënia e "Të ardhurave të tjera".

**Rezultatet tregojnë se, pavarësisht zhvillimeve në banka të veçanta, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike dhe qëndrueshmëria e tij ndaj zhvillimeve të pafavorshme është më e fortë sesa një vit më**


Grafik 84. Vlerat e RMK-së përgjatë harkut kohor ushtrimor



Burimi: Banka e Shqipërisë.



**parë.** Numri i bankave që paraqet nevojë për shtim kapitali në skenarin më ekstrem është gjashtë kundrejt tetë bankave që rezultojnë një vit më parë. Për rrjedhojë, edhe nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë përgjysmuar në rreth 1.2% të PBB-së.



#### 5.1.4 PERCEPTIMI I SEKTORIT BANKAR PËR RREZIQET SISTEMIKE

Vrojtimi me bankat për perceptimin prej tyre të rreziqeve sistematike tregon një zbutje të perceptimit të rreziqeve nga faktorë të brendshëm dhe rritjes së rrezikut nga goditjet e jashtme.

Bankat kanë vlerësuar "rrezikun e goditjeve nga jashtë" si rrezikun kryesor sistematik të periudhës dhe vlerësimi për të ka mbetur i pandryshuar krahasuar me periudhën paraardhëse.


Rreziku kibernetik renditet në vendin e dytë, dhe nota e rrezikut është rritur krahasuar me periudhën paraardhëse.


Perceptimi i bankave mbi rrezikun e inflacionit është zbutur ndjeshëm gjatë periudhës.

Mundësia e materializimit të një/ose disa prej rreziqeve të rëndësishme sistematike në të ardhmen afatshkurtër vlerësohet e ulët, por ajo paraqitet disi më e lartë kur diskutohet për një horizont më të gjatë kohor.

Rezultatet e vërtetimit mbi perceptimin e rreziqeve sistematike në vend nga industria bankare, kanë paraqitur një panoramë disi të ndryshuar të llojeve të rreziqeve kryesore sistematike dhe të vlerësimit të tyre, gjatë gjysmës së parë të vitit 2024.

Sektori bankar ka vijuar të konsiderojë "rrezikun e goditjeve nga jashtë" si rrezikun kryesor sistematik dhe perceptimi mbi rëndësinë e tij nuk ka ndryshuar. Pavarësisht zhvillimeve pozitive globale lidhur me inflacionin dhe kushtet e financimit në tregje, faktorë të tjerë si tensionet e larta gjeopolitike (veçanërisht konflikti në Rripin e Gazës dhe mundësia e përshkallëzimit të tij në vendet fqinje, si edhe vijimi i luftës në Ukrainë), duket se kanë mbajtur të lartë shqetësimin e bankave në vend mbi rrezikun e transferimit të goditjeve të mundshme negative nga jashtë, duke e klasifikuar atë si rrezikun sistematik më të rëndësishëm të periudhës. "Rreziku nga sulmet kibernetike" ka vijuar të renditet i dyti në listën e rreziqeve më të rëndësishme dhe perceptimi mbi të është rritur gjatë periudhës. Shtimi i episodeve të sulmeve kibernetike në dy vitet e fundit, ka rritur ndërgjegjësimin e bankave mbi këtë rrezik dhe pasojat e mundshme në mbarëvajtjen e aktivitetit, ndaj një pjesë e tyre deklarojnë se kanë ndërmarrë tashmë masa konkrete për përmirësimin e sistemeve të mbrojtjes. Luhatjet kryesive në kahun mbiçmues të Lekut në raport me Euron dhe Dollarin gjatë periudhës evidentojnë ndikimin e kursit të këmbimit mbi qëndrueshmërinë e portofoleve të bankave. Për këtë arsye, ato e kanë zgjedhur këtë tregues midis pesë zhvillimeve që ka nevojë të monitorohet me vëmendje, ndonëse niveli i kontributit në rrezik konsiderohet i ulët.





Ndonëse vijon të mbetet në grupin e rreziqeve kryesore sistemike, perceptimi i bankave mbi “rrezikun e inflacionit” në vend është zbutur ndjeshëm. Në këtë vlerësim ka ndikuar rënia e qëndrueshme e tij dhe stabilizimi brenda kufijve të synuar. “Rreziku i përkeqësimit të ekonomisë së brendshme”, si rezultat i përcjelljes së efektit të politikave shtrënguese të brendshme dhe të jashtme, apo materializimit të goditjeve të ndryshme, duket se vijon të mbetet i pranishëm, por perceptimi i sektorit bankar për të ka vijuar të bjerë. Së fundi, sektori bankar ka perceptuar si një rrezik të ri atë të “paqëndrueshmërisë së vlerave të pasurive të paluajtshme”, por vlerësimi për të ka mbetur i pandryshuar gjatë periudhës dhe ky rrezik nuk renditet midis pesë rreziqeve kryesore sistemike të identifikuara nga bankat.

Në terma të përgjithshëm, bankat perceptojnë se mundësia e materializimit të një (ose disa) prej rreziqeve të lartpërmendura në të ardhmen afatshkurtër (deri në një vit), është e ulët, por rritet disi kur diskutohet për një horizont më të gjatë kohor (1-3 vjet), ndikuar nga pasiguria që rrethon zhvillimet e ardhshme. Pavarësisht sfidave të momentit, situata e mirë e kapitalizimit dhe likuiditetit të sektorit ka bërë që besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar në të ardhmen të mbetet i pandryshuar.

## 5.2 SEKTORI JOBANKAR

### 5.2.1 ECURIA E SEKTORIT JOBANKAR

Krahas sektorit bankar, edhe segmentet e tjera të sistemit financiar kanë regjistruar rritje të aktivitetit gjatë gjysmës së parë të vitit<sup>46</sup>. Kontributin kryesor e kanë dhënë institucionet financiare jobanka dhe fondet e investimit që kanë edhe peshën kryesore në veprimtarinë e sektorit jobankar. Në raport me totalin

<sup>46</sup> Baza e të dhënave të subjekteve të sektorit jobankar i përket tremujorit të parë të vitit 2024.


Gjatë gjysmës së parë të vitit, segmentet e tjera të sistemit financiar kanë regjistruar zgjerim të aktivitetit.

Institucionet financiare të ndryshme nga bankat vijojnë të mbeten të mirëkapitalizuara. Tek institucionet kredituese, cilësia e portofolit të kredisë paraqitet e mirë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, ndonëse ka shënuar një rritje të lehtë gjatë periudhës, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë, por nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës.



Grafik 87. Struktura e sektorit jobankar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

e aktiveve të sistemit financiar, sektori jobankar ka rritur me 1 p.p. peshën e tij, ndërkohë që peshë e aktiveve të tij ndaj PBB-së së vendit mbeti e pandryshuar në nivelin 9%. Struktura e sektorit jobankar vijon të dominohet nga institucionet financiare jobanka që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, të ndjekura nga fondet e investimit dhe shoqëritë e sigurimit që licencohen dhe mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Aktualisht, në tregun financiar operojnë 40 IFJB, nga të cilat: 25 subjekte janë institucione të kredisë, mikrokredisë, faktoringut, qirasë financiare, blerjes së kredive me probleme etj.; 5 subjekte janë institucione pagesash; dhe 10 janë institucione të parasë elektronike. Aktivitet

kryesor i IFJB-ve është ai kreditues (37%), ndjekur nga shërbimet e pagesave dhe transfertave (31%), si edhe paraja elektronike (20%). Në sistemin financiar operojnë gjithashtu 16 shoqëri të kursim-kreditit (SHKK) dhe një Union, 12 shoqëri sigurimi, 16 fonde investimi dhe 6 fonde pensioni. Peshën kryesore në veprimtarinë e sektorit jobankar e zë aktiviteti i institucioneve financiare jobanka, ndjekur nga fondet e investimit.

**Institucionet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e kreditimit<sup>47</sup> raportuan zgjerim të aktivitetit, performancë të mirë financiare dhe nivel të mirë të kapitalizimit.** Totali i aktiveve të tyre u shtua me rreth 4 miliardë lekë, duke u ngjitur në nivelin 68 miliardë lekë. Sipas sektorëve të ekonomisë, sektori i aktiviteteve të tjera të shërbimit dhe ai i tregtisë me shumicë dhe pakicë janë sektorët më të financuar prej tyre (me nga rreth 22% dhe 18% të totalit të stokut për bizneset), ndjekur nga ndërtimi (10%). Kredia dhënë individëve zë 52% të totalit të kredisë dhe pjesa tjetër u takon bizneseve. Cilësia e kredisë shënoi rritje gjatë periudhës, dhe RKP ra në nivelin 12.8% nga 13.3% një vit më parë. IFJB-të e mbyllën periudhën me një rezultat financiar pozitiv (rreth 1 miliardë lekë), megjithatë më të ulët se niveli i fitimit të raportuar një vit më parë (1.8 miliardë lekë). Kapitalizimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve vijon të mbetet i lartë. Rreth 76% e kapitalit të paguar të institucioneve jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e kreditimit është me kapital vendas.

**Institucionet e pagesave dhe parasë elektronike (IPE) ruajtën nivelin e aktiveve të fundit të një viti më parë prej 36 miliardë lekësh.** Aktualisht, numërohen 5 subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e pagesave dhe 10 subjekte që ushtrojnë aktivitetin e parasë elektronike. Aktivitetet e IPE-ve zënë rreth 35% të totalit të aktiveve të IFJB-ve, ndërsa pjesa tjetër i përket institucioneve që



<sup>47</sup> Të gjitha format e kredihënies, mikrokredi, qira financiare, faktoring, blerje kredi me probleme.



ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit. Peshën kryesore në aktivitetin e tyre e zënë investimet në banka në formën e llogarive rrjedhëse dhe të garancisë (29%), ndjekur nga shërbimet e pagesave me klientët (27%) dhe investimet në letrat me vlerë me të ardhura të ndryshueshme në formën e aksioneve (15%). Performanca financiare e IPE-ve ishte pozitive, duke raportuar një fitim financiar prej 0.3 miliardë lekësh.

**Shoqëritë e kursim-kreditit shënuan rritje të vëllimit të aktiveve.** Ky segment ka shënuar rënie në cilësinë e portofolit të kredisë krahasuar me një vit më parë, me RKP në nivelin 5.1%. Në portofolin e investimeve të SHKK-ve, peshën kryesore e zënë investimet në kredi (74%) dhe investimet në banka në formën e llogarive rrjedhëse (14%). Sektori që ka tërhequr pjesën më të madhe të financimit është sektori i bujqësisë (21%), i ndjekur nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (16%). SHKK-të e mbyllën periudhën me një fitim neto pozitiv.

Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit zgjeruan aktivitetin e tyre, si rrjedhojë e rritjes së primeve të shkruara bruto dhe investimeve në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë.



Sektori jobankar vijon të mbajë një pozicion të balancuar të aktiveve dhe detyrimeve financiare<sup>48</sup>. Aktivët kryesorë janë huatë dhe letrat me vlerë të borxhit, ndërsa detyrimet përfaqësohen nga kapitali dhe aksionet në fondet e investimit dhe huatë. Sektori jobankar ka ngushtuar pozicionin neto kreditor në raport me fundin e një viti më parë, ndikuar nga shtimi i detyrimeve të ndërmjetësve të tjerë financiarë (jobanka, SHKK) në formën e kapitalit dhe aksionet në fondet e investimeve. Brenda sektorit jobankar, fondet e investimit dhe shoqëritë e sigurimit me fondet e pensionit kanë një pozicion neto negativ (debitor), ndërsa ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobankat dhe SHKK-të) kanë

<sup>48</sup> Analiza për aktivet dhe detyrimet e sektorit jobankar është mbështetur në të dhënat e llogarive financiare për tremujorin e parë të vitit 2024.



një pozicion neto pozitiv (kreditor). Për nënsektorët e fondeve të investimit dhe shoqërive të sigurimit me fondet e pensionit, pozicioni debitor në fund të tremujorit të parë të vitit 2024 ishte sa 6% e totalit të aktiveve të sektorit jobankar.

**Kredia dhe letrat me vlerë të borxhit vijojnë të zënë peshën kryesore në aktivet e subjekteve financiare të ndryshme nga bankat.** Letrat me vlerë të borxhit zënë 26% të aktiveve financiare të sektorit jobankar, ndërsa huatë dhe


monedhat e depozitat zënë respektivisht 28% dhe 21%; megjithatë këto raporte janë të ndryshme për subjektet e këtij sektori. Për fondet e investimit, letrat me vlerë të borxhit përfaqësojnë rreth 82% të aktiveve të tyre, ndërkohë që për ndërmjetësit e tjerë financiarë peshën më të madhe e zënë huatë me rreth 52%. Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit të marra së bashku kanë shpërndarjen më heterogjene të aktiveve, të cilat janë të vendosura në monedha dhe depozita (34%), letra me vlerë të borxhit (26%), sigurime dhe skema pensionesh (14%), si dhe në kapital dhe aksione në fonde investimi (15%). Sipas instrumenteve, sektori jobankar ka një pozicion neto debitor për kapitalin dhe aksionet në fondet e investimit, në sigurime dhe skema pensionesh, dhe një pozicion neto kreditor për letrat me vlerë të borxhit, huatë dhe monedha e depozita.

Grafik 91. Ndërlidhja e sektorit jobankar me sektorin bankar, mars 2024




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 90. Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas instrumenteve në vite




Burimi: Banka e Shqipërisë.



## 5.2.2 RREZIQET DHE EKSPOZIMET MIDIS SEKTORIT BANKAR DHE JOBANKAR

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, por ka shënuar një rritje të lehtë në terma vjetorë. Në krahun e aktivitetit të bankave, ekspozimi ndaj sektorit jobankar përfaqësohet kryesisht nga huatë akorduar institucioneve financiare jobankare. Ndërmjetësit financiarë (jobankat dhe SHKK-të) janë segmentet më të financuara nga sektori bankar me një stok kredie prej 21.5 miliardë lekësh, ndjekur nga kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit me kredi në vlera mjaft të ulëta. Stoku total i financuar nga sektori bankar është rreth 22 miliardë lekë dhe zë 1.1% të vlerës së bilancit të sektorit bankar, nga 0.94% një vit më parë.

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe e qëndrueshme. Pretendimet e sektorit jobankar ndaj bankave janë në formën e vendosjeve (llogari rrjedhëse, depozita me apo pa afat). Stoku i fondeve të vendosura pranë bankave deri në fund të tremujorit të parë ishte rreth 59 miliardë lekë, ose sa 29% e aktiveve të sektorit jobankar. Vendosjet më të mëdha pranë sektorit bankar, ose 59% të totalit, i kanë ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobanka, SHKK), dhe këto vendosje janë rritur krahasuar me fundin e një viti më parë. Në raport me aktivitetin e tyre, shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit kanë ekspozimin më të madh ndaj sektorit bankar, pasi vendosjet e tyre në banka përbëjnë rreth 34% të aktiveve të tyre. Sektori jobankar ka ngushtuar pozicionin e tij kreditor neto me bankat në nivelin 37 miliardë lekë, nga 43 miliardë lekë në fund të dhjetorit 2023. Ngushtimi i pozicionit neto zbut ndjeshmërinë e sektorit jobankar ndaj ecurisë së aktivitetit të sektorit bankar. Pozicionin neto kreditor më të lartë e kanë shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit, duke qenë se kanë më shumë pretendime në sektorin bankar krahasuar me detyrimet, ndjekur nga ndërmjetësit e tjerë financiarë. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj sektorit bankar monitorohet rregullisht nga Banka e Shqipërisë, në kuadrin e vlerësimit periodik të rreziqeve sistematike dhe monitorimit të përmbushjes së objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale.



## ANEKS 1. TREGUESIT E SHËNDETIT FINANCIAR

në përqindje	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	06/2024	
Treguesit me bazë kapitalin																			
Kapitali rregulator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.1	17.2	16.2	15.4	15.6	16.2	18.0	16.8	15.7	16.0	17.0	18.7	18.5	18.7	18.5	18.8	19.9	19.3	
Kapitali nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	16.0	16.3	15.3	14.5	14.3	14.6	14.9	13.8	13.5	14.1	15.5	17.4	17.3	17.6	17.4	17.5	18.2	17.7	
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.6	8.6	9.6	9.4	8.7	8.6	8.4	8.6	9.5	9.7	10.2	10.1	10.5	10.4	9.9	9.8	9.9	10.3	
Cilësia e aktiveve																			
Huave me probleme neto ndaj kapitalit rregulator	10.1	21.7	28.2	35.9	52.0	55.6	40.2	38.3	24.3	23.1	15.7	15.5	13.6	11.3	7.1	7.3	5.5	6.3	
Huave me probleme (bruto) ndaj huave totale	3.4	6.6	10.5	14.0	18.8	22.5	23.5	22.8	18.2	18.3	13.2	11.1	8.4	8.1	5.6	5.0	4.7	4.7	
Përfutshmëria																			
Klirimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	20.7	11.4	4.6	7.6	0.8	3.8	6.4	10.5	13.2	7.2	15.7	13.0	13.5	10.7	12.9	12.3	17.3	18.5	
Klirimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	1.6	0.9	0.4	0.7	0.1	0.3	0.5	0.9	1.2	0.7	1.5	1.3	1.4	1.1	1.3	1.2	1.7	1.9	
Pozicioni i hapur neto në valute të huaj ndaj kapitalit																			
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregulator	1.7	4.3	3.9	5.0	3.9	4.0	4.1	8.5	7.7	7.0	6.7	7.8	7.4	8.4	9.2	5.0	6.1	4.6	
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të nivelit të parë	1.8	4.5	4.1	5.3	4.3	4.4	4.9	10.4	9.0	8.0	7.3	8.4	8.0	9.0	9.8	5.4	6.7	5.0	
Treguesit me bazë aktivet																			
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.8	42.8	27.6	25.9	26.5	29.4	27.6	31.9	32.3	31.3	30.2	34.2	35.7	34.8	33.3	29.6	30.8	28.4	
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	74.0	64.9	32.6	30.6	33.1	36.7	34.7	40.4	41.4	40.6	40.8	46.2	49.4	47.4	45.4	41.1	43.4	41.2	
Depozita të klienteve ndaj totalit të huave	215.5	162.6	154.3	166.4	163.2	171.6	180.8	180.2	187.8	192.8	194.0	203.2	207.2	211.3	213.6	212.4	217.1	203.5	

